



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | Dhjetor 2024

POLITICS | ECONOMY | BUSINESS | TECHNOLOGY | EDUCATION | SCIENCE | CULTURE

KOSOVA SHKRUAN HISTORI: **REKTORI HAJRIZI** NDEROHET ME DY ÇMIME NDËRKOMBËTARE PËR LIDERSHIP NË CILËSI DHE EDUKIM



TRIPLE E AWARDS

SCIMAGO

POSITIVE IMPACT
RATING EDICION 2024

EFQM

GREENMETRIC WORLD
UNIVERSITY RANKING

TIMES HIGHER
EDUCATION

WEBOMETRICS

THE IMPACT
RANKINGS

WURI 2024

UBT - model i inovacionit dhe transformimit të arsimit të lartë në Kosovë dhe rajon



Në një epokë ku inovacioni dhe qëndrueshmëria janë sfidat kryesore të shoqërisë globale, UBT në Kosovë po vazhdon të dëshmohej si një institucion udhëheqës në fushën e arsimit të lartë.

Me arritje të jashtëzakonshme në fushën e inovacionit, cilësisë dhe përkushtimit ndaj qëndrueshmërisë mjedisore, UBT është shndërruar në një model të transformimit dhe zhvillimit në Kosovë dhe rajon.

Një nga arritjet më të shquara të UBT-së është renditja në mesin e Top 200 Universiteteve më të mira në botë për luftën ndaj Ndryshimeve Klimatike nga GreenMetric World University Ranking 2023. Kjo vërteton përkushtimin e UBT-së në promovimin e kampuseve të gjelbra dhe praktikave të qëndrueshme mjedisore, duke u bërë një model për institucionet e arsimit të lartë në nivel global.

Krahas universiteteve më prestigjioze në botë, UBT është ranguar për inovacion dhe për revolucionin e katërt industrial në WURI. Këtë vit, ranglista botërore e universiteteve prestigjioze, SCImago, ka ranguar UBT-në si institucionin më të mirë dhe të vetmin në arsimit të lartë privat në mbarë trojet shqiptare.

UBT është në vazhdimësi në kërkim të një inovacioni të qëndrueshëm, të cilin e përmirëson përmes investimeve në teknologji dhe përmes projekteve inovative të cilat ofrojnë zgjidhje për sfidat bashkëkohore.

Renditja e UBT-së si institucioni i dytë në Kosovë dhe i treti në trojet shqiptare për numrin e citimeve të publikimeve të stafit në platformën "Webometrics" dëshmon për cilësinë e lartë të kërkimit shkencor dhe kontributin e UBT-së në fushën e dijes dhe inovacionit. Përveç kësaj, ngritja prej 3 mijë vende në renditjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë për vitin 2024 dhe renditja e UBT-së në mesin e nëntë kompanive më të mira në botë për cilësi nga EFQM tregon nivelin e lartë të performancës dhe cilësisë së institucionit.

Duke u krahasuar me kompanitë globale të njohura, UBT ka dëshmuar nivelin e saj të lartë të cilësisë dhe përkushtimit ndaj standardeve të larta. UBT është dëshmuar edhe në fushën e sipërmarrësisë dhe inovacionit, duke fituar çmimin "European Young Entrepreneurial University of the Year" nga Triple E Awards në Barcelona të Spanjës. Ky çmim vërteton përkushtimin e UBT-

së në promovimin e sipërmarrësisë dhe inovacionit si pjesë integrale e përparimit të shoqërisë dhe zhvillimit të ekonomisë.

UBT është vlerësuar edhe për impaktin e saj pozitiv në shoqëri, duke u renditur në nivel të lartë në Edicionin e Vlerësimit të Ndikimit Pozitiv 2021 dhe duke u ranguar në mesin e universiteteve më të mira në botë nga Times Higher Education. Kjo tregon se UBT nuk është vetëm një institucion i arsimit të lartë, por një shtyllë kryesore e ndryshimit dhe inovacionit në shoqërinë kosovare dhe mbarë rajonin.

Me këto arritje të jashtëzakonshme dhe përkushtimin e vazhdueshëm ndaj inovacionit, cilësisë dhe qëndrueshmërisë, UBT vazhdon të shkëlqejë si një institucion i cili bën dallimin në botën e arsimit të lartë dhe është një burim frymëzimi për të gjithë bashkësitë e arsimit të lartë në Kosovë dhe mbarë rajonin.

UBT është më shumë se një institucion arsimor; është një mision, një vizion për të ardhmen e arsimit dhe shoqërisë në tërësi.





24 YEARS
LEADERSHIP and INNOVATION

Education | Research | Training | Consulting

2001/2025

IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve

Botues: Edmond Hajrizi

Numrin e përgatiti: Media Grupi i UBT-së

Adresa: www.ubt-uni.net

Tel: 038 541 400, 044 541 400

Përgatitje grafike: Albert Zuka

Intervistë e rektorit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi

UBT - shtyllë kyçe për zhvillimin akademik dhe profesional në Kosovë

UBT, si institucioni lider në arsimin e lartë në Kosovë, ka dëshmuar përkushtim të palëkundur në ngritjen e cilësisë së arsimit dhe fuqizimin e vazhdueshëm të kapaciteteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Me një histori të pasur suksesi, ky institucion ka qenë shtyllë kyçe për zhvillimin akademik dhe profesional në Kosovë, duke kontribuar jo vetëm në edukimin e studentëve, por edhe në përfaqësimin e denjë të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë. Në një intervistë ekskluzive me Rektorin e UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, do të ndjekim rrugëtimin e këtij institucioni drejt përsosmërisë, duke hedhur dritë mbi arritjet mbresëlënëse, çmimet e fituara, rritjen e numrit të studentëve dhe kontributin e UBT-së në forcimin e imazhit të Kosovës në botë. Një histori inspiruese që dëshmon pse UBT është sinonim i inovacionit, cilësisë dhe lidershit në arsim.

MODELI I UBT-SË SOT ËSHTË I PRANUAR NË MBARË BOTËN

Viti 2024 ka sjellë një rritje të dukshme në numrin e studentëve në programet bachelor dhe master. Çfarë ka ndikuar në këtë interes në rritje për UBT-në?


Rektori Hajrizi: Mendoj se kjo është një kënaqësi e veçantë. Që prej themelimit, UBT ka pasur një rritje të vazhdueshme të numrit të studentëve. Është një ndjenjë e mirë dhe një pritje, tash të themi, e jona që të kemi gjithmonë rritje, bazuar në parimet e përgjithshme dhe në punën që është bërë. Puna, angazhimi, fokusi te studenti, te suksesi i tij, te edukimi, diplomimi, punësimi, cilësia e infrastrukturës, inovacioni i programeve të studimit, ndërlidhja dhe ndërkombëtarizimi i edukimit, njohjet ndërkombëtare, profesorët më të mirë dhe ndërlidhja me praktikën – janë shumë parametra që bëjnë që studentët të gjejnë përpunshmëri me nevojat dhe kërkesat e tyre, edhe me UBT-në, duke u krijuar një ndërlidhje e fortë që ata të vijin tek ne.

Mendoj që shumë familje, që kanë pasur studentë të mëparshëm në UBT, sjellin vazhdimisht të tjerë sepse tashmë na njohin më mirë, e dinë seriozitetin tonë, cilësinë tonë dhe fokusin për edukimin cilësor. Besojmë se kemi konfirmuar për më shumë se 20 vite se UBT është institucioni më inovativ dhe gjithmonë pranë ofrimit të zgjidhjeve, qoftë për kompetenca, qoftë për dije të reja apo aftësi që kërkohen nga tregu i punës – jo vetëm në Kosovë, por edhe në atë ndërkombëtar. Besueshmëria jonë ka ardhur duke u rritur dhe, mbi këtë bazë, kemi pasur një rritje të vazhdueshme.

Përkundër rrethanave, mendimeve të ndryshme apo sfidave, kemi arritur një rritje të qëndrueshme, duke konfirmuar një pjekuri për të bërë analiza të mirëfillta dhe për të zgjedhur institucionin dhe programet e duhura. Oferta dhe modeli i UBT-së sot është i pranuar në mbarë botën, dhe këtë model e kemi krijuar për rininë tonë, në mënyrë që ata ta përjetojnë këtu atë që ndoshta nuk do ta gjenin diku tjetër. Vetë zgjedhja e tyre dhe ndërlidhja me procesin e studimeve në UBT ka bërë që të kemi rritje të kërkesave, si në nivel lokal ashtu edhe nga studentë ndërkombëtarë apo nga regjioni. Po ashtu, kemi rritje të profesorëve dhe universiteteve partnere, të cilat e vlerësojnë cilësinë që UBT ofron dhe për të cilën angazhohemi vazhdimisht.

Si po arrin UBT të tërheqë studentë të rinj në një kohë kur sfidat e migrimit janë të theksuara?

Rektori Hajrizi: Pjesa demografike për momentin nuk është shumë e lakmueshme, dhe trendet në përgjithësi nuk janë të favorshme. Ka një rënie të natalitetit, lëvizje të popullatës dhe rrethana të ndryshme. Mirëpo, misioni ynë



– edhe i imi personal – ka qenë që të konfirmojmë të kundërtën: nëse si qytetar ke një edukim dhe dije cilësore që i përgjigjet tregut të punës, atëherë jeta dhe puna në Kosovë janë me perspektivë. Mund ta glesh veten, të zhvillohesh dhe të ndërlidhesh në nivel global, duke pasur vendin tënd si bazë ku ndihesh më mirë, si individ në familje dhe në rrethin ku ke lindur.

Ne po mundohemi vazhdimisht ta promovojmë këtë qëndrim. Kur krahasojmë programet tona studimore, çmimin, koston, cilësinë dhe rangimin, kuptojmë që nuk ka nevojë për të vazhduar diku tjetër. Unë mendoj se shërbimet dhe studimet që ofron UBT, me koston, cilësinë dhe infrastrukturën, janë ndër më të mirat jo vetëm në Kosovë, por edhe në shumë universitete evropiane. Kemi shumë kërkesa edhe nga studentë dhe universitete ndërkombëtare për të ardhur dhe studiuar në UBT.

Cilat programe të reja apo reforma në kurikulum kanë luajtur rol në këtë sukses?

Rektori Hajrizi: Sa i përket kurrikulave, mendoj që gjithmonë kemi bërë një punë pioniere dhe inovative. Që nga viti 2003, kur kemi krijuar programin e parë, International Engineering Management, kemi vazhduar të dizajnojmë kurrikula të reja bazuar në praktikën më të mirë evropiane dhe amerikane. Kurrikulat tona, lëndët dhe përmbajtjet janë ndër më të fundit dhe moderne, të harmonizuara me kërkesat lokale dhe ndërkombëtare. Këto programe nuk janë vetëm kopje të universiteteve të tjera, por janë përshtatur për të përmbushur edhe kërkesat e së ardhmes.

Diplomat tona njihen automatikisht nga shumë vende, dhe shumë prej tyre janë të dyfishta, duke ofruar mundësi të shumta për studentët tanë. Gjithashtu, jemi aktivë në zhvillimin e kurrikulave në fusha të ndryshme si ndryshimet klimatike, shëndetësia, teknologjitë e fundit, inteligjenca artificiale, energjia e ripërtëritshme, ekonomia e qëndrueshme dhe tranzicionet e gjelbra. Kemi punuar shumë

dhe vazhdojmë të punojmë për të pozicionuar programe të studimit që janë të qëndrueshme, inovative dhe interdisiplinare.

“EUROPEAN QUALITY LEADER FIRST FINALIST”, NJË NGA ÇMIMET E JETËS

Si u ndjetë kur u nderuat me çmimin prestigjioz “European Quality Leader First Finalist” në Kongresin e 65-të të European Quality Congress në Francë?

Rektori Hajrizi: Me thënë të drejtën, ky është një nga çmimet e jetës. Një çmim që çdokush e ëndërron, veçanërisht në fushën time, ku merrem me cilësinë, praktikën e mira të menaxhimit dhe standardet e larta evropiane. Ky është çmimi që u ndahet personaliteteve në Evropë për ndikimin e tyre në zhvillimin e cilësisë. Është një shoqatë evropiane që vlerëson kontributin e individëve në botë. Jam shumë i lumtur dhe krenar që këtë vit jam përzgjedhur për këtë çmim, duke marrë parasysh se përfaqësojmë një vend ku ende ka shumë për të bërë në zhvillimin dhe transformimin e sistemeve tona me praktika dhe standarde botërore. Në të njëjtën kohë, kemi arritur të dëshmojmë se edhe në vende në tranzicion mund të bëjmë gjëra të mira, t'i zhvillojmë ato dhe të nxjerrim rezultate duke u bërë një model për të tjerët.

Ky çmim është i veçantë, pasi ndahet për pak individë në vit, dhe është hera e parë që jepet një personi nga rajoni ynë. Kjo e bën këtë çmim edhe më të veçantë. Personalisht, kam punuar shumë për çështjen e cilësisë. Përmes universitetit, programeve dhe aktiviteteve të tjera, gjithmonë kam promovuar mesazhin që suksesi arrihet përmes cilësisë. Cilësia është një parakusht i domosdoshëm për sukses, dhe kur lidhet me vlerat humane, suksesi është i garantuar.

Në këtë drejtim, kam bërë shumë publikime shkencore, kam ndërtuar organizata, kam anëtarësuar Kosovën në organizata botërore

dhe kam ligjruar për vite me radhë në fushën e menaxhimit të cilësisë. Kam ndërtuar sisteme që kanë sjellë rezultate konkrete dhe kanë marrë çmime të rëndësishme, si Çmimi i Ekselencës. Jam diplomuar dhe specializuar në këtë fushë, duke arritur nivelet më të larta të njohura ndërkombëtarisht, jo vetëm si profesor, por edhe si ekzaminer, editor dhe trajner i certifikuar.

Juria ka gjetur mjaft komponentë që përmbushin kriteret për këtë çmim. Ndjenja lidhet me Kosovën – me faktin që ajo bën gjëra të bukura, të mira dhe inovative. Kemi mësuar dhe jemi inspiruar nga kulturat cilësore ndërkombëtare. Që nga paslufta, veprimet dhe mesazhet e mia kryesore kanë qenë të lidhura me cilësinë – jo vetëm në edukim dhe shkencë, por edhe në politikën publike, standardet e jetesës dhe praktikën në kompani. Kam ndihmuar qeverinë për ligje dhe standardizim, kam trajnuar organizata dhe kam krijuar Shoqatën “Quality Kosova”, duke e anëtarësuar atë në organizata evropiane dhe botërore.

Kjo ka qenë një sfidë, por kemi ndërtuar sisteme që konfirmojnë vlerat dhe rezultatet që promovojmë. UBT është shembulli i këtyre praktikave, një mesazh për të gjithë aktorët e tjerë se gjërat e mira janë të mundshme dhe të vlefshme. Ky çmim, i konfirmuar nga Evropa, është motivim për ne dhe një mesazh që do të na ndihmojë të vazhdojmë më tutje.

SUKSESI I UBT-SË NË RANGIMET NDERKOMBËTARE

UBT është renditur si lider në inovacion dhe inteligjencë artificiale. Cilat janë faktorët kryesorë që kanë kontribuar në këto arritje?

Rektori Hajrizi: Kjo lidhet me atë që shpreha më parë: gjithmonë kemi qenë pionierë në fushat dhe trendet më të fundit në botë. Nuk kemi vepruar me vonesë në raport me zhvillimet shkencore dhe inovative. Kemi qenë gjithmonë të pranishëm

që nga dita e parë. Shpejtësia dhe ndërmarrësia jonë na kanë bërë që të pozicionohemi ndër më të mirët në botë.

Jemi shumë aktivë në inteligjencën artificiale – kemi pasur programe studimi për këtë fushë që nga viti 2000. Unë vetë kam doktoruar në këtë fushë. Për ne, kjo nuk është e re, sepse kemi publikuar dhe dizajnuar modele për inteligjencën artificiale që nga vitet '90. Për këtë arsye, kur filluan rangimet, ne tashmë veçse ishim në pozita të avancuara.

Për teknologjitë e mençura, si Smart City, Smart Agriculture dhe Smart Factory, kemi punuar prej 20 vitesh. Kemi folur për këto tema dhe kemi sjellë inovacione që atëherë. Rangimet dhe pozicionimet tona ndërkombëtare konfirmojnë përvojën tonë. UBT është një nga universitetet më të mira në botë për Revolucionin e Katërt Industrial, duke u pozicionuar në vendin e gjashtë nga 59 universitete në botë.

Kjo është një arritje e madhe, duke qenë të parët në rajon për këtë fushë. Sivjet, për shembull, jemi në vendin e 26-të në botë për ndikimin në inteligjencën artificiale gjenerative. Në mesin e qindra universiteteve, ky është një pozicion i jashtëzakonshëm për një institucion nga Kosova. Kjo na motivon të vazhdojmë më tutje dhe të rrisim pozicionet tona.

Cilat janë projektet më inovative që UBT ka zhvilluar në këto fusha?

Rektori Hajrizi: Po, ne kemi kryesisht shumë projekte inovative në këtë pjesë. Kemi dhjetëra projekte që trajtojnë përdorimin e Inteligjencës Artificiale në fusha të ndryshme, si mjekësia, gjuha, parandalimi i rreziqeve natyrore, e kështu me radhë. Kemi projekte të shumta në fushën e Smart City, që është një projekt dhe program inovativ i UBT-së. Ky program paraqet një model se si duhet të duken qytetet e së ardhmes – të mençura dhe të qëndrueshme – dhe tashmë është një rol model i pranuar nga të gjitha forumet botërore. Për këtë arsye, po ftohemi nga shumë vende për ta prezantuar këtë model. Vetëm këtë vit, unë kam qenë në mbi 50 vende për të prezantuar modelin e UBT-së. Kam qenë i ftuar në Amerikë, në qendrat më të mira dhe universitetet më prestigjioze amerikane, si dhe në forume të ndryshme në Evropë, për të prezantuar këtë model.

Duke u ndalur tek tematika specifike të fushave të ndryshme, ndoshta nuk do të përmendja veçmas ndonjë projekt të një departamenti, qendre apo laboratorit, për të mos krijuar prioritizime mes tyre. Në UBT kemi 30 qendra inovative që janë pjesë e një ekosistemi të veçantë. Pothuajse nuk ka organizata në botë me një ndërlidhje të tillë të sistemeve inovative. Me këto 30 qendra, me rreth 300 laboratorë modernë dhe 80 funksione industriale, kemi krijuar një ekosistem që çdo ditë zhvillon projekte, prototipe dhe aktivitete në fusha të ndryshme të jetës.



UBT - MODEL I INOVACIONIT DHE TRANSFORMIMIT TË ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË DHE RAJON

Na tregoni më shumë për konceptin e "Ekosistemit të UBT-së" dhe si po ndikon në edukim dhe inovacion?

Rektori Hajrizi: Siç e përmenda më herët, ne jemi një model i pranuar globalisht për atë që quhet smart, që ndan sisteme të mençura dhe të qëndrueshme. Ky model i ndërtuar nga UBT ka treguar që një ekosistem inovativ mund të sjellë më shumë rritje ekonomike, investitorë të huaj, vende pune, aftësi dhe kompetenca të duhura për tregun e punës. Po ashtu, ky model ndikon në rritjen e projekteve dhe rezultateve shkencore, dhe promovon zhvillimin e qëndrueshëm të bazuar në ekonominë rrethore dhe tranzicionin e gjelbër.

Modeli i UBT-së përbëhet nga funksione fizike të një qyteti – si infrastrukturë moderne, fabrika, biznese, media, komuniteti social, shëndetësia, hulumtimet shkencore – dhe të gjitha këto elemente e bëjnë të plotë këtë ekosistem. Për këtë arsye, kemi një rritje të vazhdueshme të studiuveve dhe studentëve që vijnë për ta studiuar këtë model.

Misioni ynë kryesor është që studentët tanë, para se të dalin në tregun e punës, të mbyllin një cikël të plotë kompetencash që i përgjigjen nevojave të kohës. Arsimi i sotëm kërkon një model të ri, prandaj UBT ka krijuar konceptin 5S, i cili i përgjigjet kërkesave globale për kompetenca dhe dije.

Në bazë të këtij modeli, ne po marrim rezultate të jashtëzakonshme dhe tashmë po e eksportojmë këtë koncept në vende të tjera si Britani, Austri, Slloveni, Shqipëri, Emirate, etj. Nuk jemi më vetëm bartës të dijes, por po eksportojmë modelet dhe konceptet tona.

Dimë që UBT ofron edhe shkollimin fillor dhe të mesëm. Çka mendoni se ju veçon nga institucionet e tjera të arsimit në vendin tonë?

Rektori Hajrizi: Në ndërtimin e

qytetit të mençur dhe ekosistemit inovativ, të gjitha moshat dhe gjeneratat janë pjesë e tij. Përveç studentëve dhe stafit, kemi përfshirë edhe moshat parauniversitare dhe çerdhet, duke ndërtuar një zinxhir të plotë nga lindja deri te shkollimi universitar dhe procesi i të mësuarit gjatë gjithë jetës.

E veçanta e shkollimit tonë është që nxënësit përfitojnë nga një ekosistem inovativ me mbi 300 laboratorë modernë, të cilët asnjë shkollë tjetër nuk mund t'i ofrojë. Kjo i mundëson nxënësvë të përjetojnë praktikisht atë që mësojnë nga librat, duke zhvilluar aftësi analitike, mendim kritik dhe kompetenca të tjera të rëndësishme.

Për më tepër, ky ekosistem përfshin të gjitha gjeneratat që kontribuojnë dhe përfitojnë nga ai. Të rinjtë zhvillojnë talentet e tyre në art, teknologji apo fusha të tjera, ndërsa moshat e shtyra përfitojnë nga shërbimet shëndetësore, rehabilitimi dhe mirëqenia. Ky bashkëpunim ndërmjet brezave është një ndër arsye që modeli ynë mbetet i veçantë dhe i suksesshëm.

Çfarë planesh afatgjata ka UBT për të vazhduar të qëndrojë lider në edukim dhe teknologji?

Rektori Hajrizi: Gjithmonë suksesi nuk është një destinacion që e mbërrin, e plotëson dhe e përfundon. Ai është një rrugëtim i vazhdueshëm, për të cilin gjithmonë duhet të kesh kujdes, të bësh strategji, të kesh mision të qarta, vizione të qarta për çfarë më tutje. Ne kemi strategjitë tona për vitet 2027, 2030, madje edhe 2040 dhe 2050. Kemi vendosur linjat e rrugëtimit tonë që na bëjnë të jemi modernë dhe të ofrojmë vlera të nevojshme për shoqërinë, jo vetëm në Kosovë. Tani kemi një aktivitet ndërkombëtar, jemi aktivë në shumë kontinente të botës, dhe kjo është ajo çka përfaqëson momentumin tonë. Synimi ynë është që të jemi një institucion lider në Ballkan dhe të konfirmohemi vazhdimisht me punë inovative, me transformime të reja të nevojshme, duke rritur ndërkombëtaritetin dhe bashkëpunimet globale.

Aktualisht, jemi në një fazë ku

ndikimi ynë është në lidhje me sfidat botërore, dhe jo vetëm me ato lokale në Kosovë, siç ka ndodhur për një kohë të gjatë. Projektet tona dhe fokusi ynë tani janë bashkëpunimet ndërkombëtare për sfida globale. Kemi krijuar një slogan: Global Partnership for Global Challenges dhe, mbi këtë bazë, kemi ndërtuar bashkëpunime të ndryshme për të krijuar politika të rëndësishme botërore që lidhen me planetin, demografinë, shëndetin global, teknologjinë, edukimin, dhe formatin e ri të edukimit. Në këto fusha kemi realizuar partneritete dhe jemi duke punuar me institucione të konfirmuara botërore.

Një prej projekteve tona, të realizuar në bashkëpunim me Universitetin e Cambridge, përmes Public Policy Simulation Lab, përfaqëson një model për ndërtimin e politikave botërore që lidhen me reziliencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Po ashtu, kemi projekte në fushën e shëndetësisë, duke ndihmuar në ndërtimin e spitaleve apo shërbimeve spitalore që të sigurojnë qasje për çdo qytetar të botës, edhe në vendet më të vështira. Ky është një projekt global, ku bashkëpunojmë me universitete amerikane dhe italiane.

Ne jemi nënshkrues të shumë iniciativave të Kombeve të Bashkuara që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm, barazinë gjinore, dhe përkrahjen e grave. Po ashtu, jemi anëtarë të mekanizmave botërorë ku kontribuojmë aktivisht dhe jemi të respektuar për angazhimet tona.

Si e shihni UBT-në në një horizont dhjetëvjeçar?

Rektori Hajrizi: Vizioni, misioni dhe strategjia jonë janë gjithmonë të adaptueshme, duke u bazuar në inovacion dhe zhvillime pozitive në funksion të njeriut, planetit dhe parimeve humane, si demokracia, paqja, dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës. Fokusi ynë është të krijojmë rritje të vazhdueshme përmes edukimit, shkencës, inovacionit dhe kontributeve ndërmarrëse.

E shoh UBT-në si një model për vitet e ardhshme, si një institucion që promovon praktikën më të mira në fusha të ndryshme. Besoj se UBT-ja do të ketë një rritje të

konsiderueshme, me më shumë studentë ndërkombëtarë dhe më shumë pjesëmarrje në mekanizma botërorë. Synojmë të vazhdojmë të ndërtojmë një ekosistem të fuqishëm, që përfshin mijëra profesionistë dhe staf që do të përfitojnë nga ky bashkëpunim.

Gjithashtu, rritja jonë është e ndërlidhur me mbështetjen e qeverive vendore dhe qendrore, si dhe me bizneset që ndihmojmë për zhvillimin ekonomik dhe punësimin. Objektivi ynë është të arrijmë nivele më të larta shkencore dhe të pozicionohemi edhe më mirë në rangimet ndërkombëtare, duke vazhduar rritjen organike që kemi ndjekur gjatë këtyre 23 viteve.

Shohim vazhdimisht të rinj, nxënës të shkollave të mesme që akoma pa e përfunduar atë cikël, veçse kanë vendosur të studiojnë në UBT. Çfarë mesazhi do të përcillnit ju për të rinjtë të cilët aspirojnë të jenë pjesë e UBT-së?

Rektori Hajrizi: Kur flasim për këtë ekosistem, më shtohet edhe mua dëshira për t'u kthyer në shkollë dhe për t'i përjetuar mundësitë e shumta që ofron UBT. Ky është një sistem unik, i ndërtuar për të kontribuar në zhvillimin e Kosovës dhe të rinjve të saj. Mesazhi im për ta është të bëjnë një zgjedhje të mirinformuar, duke krahasuar dhe analizuar opsionet e tyre, por gjithmonë duke e konsideruar UBT-në si një nga opsionet më të mira.

UBT-ja ka një sistem modern dhe të vërtetuar ndërkombëtarisht, i cili gjithmonë synon të përmirësohet. Ky model është një shembull i konfirmuar ndër vite dhe është ftuar të zbatohet edhe në vende të tjera. Prandaj, i ftoj të rinjtë të përfitojnë nga këto mundësi unike dhe të jenë pjesë e një ekosistemi që u ndihmon të realizojnë aspiratat e tyre.

Meqë ju personalisht me UBT-në keni ndikuar jashtëzakonisht shumë në zhvillimin e shtetit dhe lartësimin e emrit të tij në aspektin e dijes dhe akademisë në nivel ndërkombëtarë, çfarë këshille do t'u jepnit atyre që duan të kontribuojnë në zhvillimin e Kosovës përmes dijes dhe përmes teknologjisë?

Rektori Hajrizi: Ne kemi kontribuar

në edukim, jemi shumë të lumtur dhe të plotësuar kur shohim që ata që përfundojnë studimet gjejnë hapësirat e tyre dhe rrisin cilësinë e jetës në Kosovë dhe jashtë saj. Jemi shumë të lumtur që gjenerojmë dhe jemi ndër gjeneruesit më të mëdhenj të punësimit në Kosovë. Gjithashtu, jemi të lumtur që kontribuojmë financiarisht në mbështetjen e buxhetit të Kosovës në mënyrë të vazhdueshme.

Ne jemi të lumtur që japim mbështetje dhe nuk kërkojmë, që e përfaqësojmë denjësisht Kosovën në mekanizma ndërkombëtarë, që ndihmojmë dhe jemi të gatshëm të ndihmojmë njerëz në nevojë dhe institucione të ndryshme. Kemi kënaqësinë të bashkëpunojmë me palët e interesit në Kosovë, pa dallime, duke qenë gjithmonë neutralë dhe miqësorë. Bashkëpunimin e kemi parë si një domosdoshmëri, duke vlerësuar diversitetin si një forcë që na bashkon.

Mesazhi im është që të jemi më të hapur, më bashkëpunues dhe të kujdesemi për njëri-tjetrin. Duke pasur parasysh që Kosova është një vend me resurse të kufizuara, është e domosdoshme që këto resurse të shfrytëzohen në mënyrë më optimale, duke siguruar bashkëveprim dhe koordinim të mirë. Vetëm përmes kësaj qasjeje mund të ndërtojmë inovacion dhe zhvillim. Përndryshe, produktiviteti dhe efikasiteti bien, ndërsa problemet dhe pengesat rriten, duke shkaktuar stagnim.

Stagnimi nuk është opsion për ne dhe nuk duhet as ta mendojmë, sepse kemi kaluar dhe jemi në faza të rëndësishme të stabilitetit tonë. Duhet të falënderojmë Zotin dhe partnerët tanë për ndihmën dhe përfshirjen tonë në zhvillimet demokratike. Por ne kemi përgjegjësinë të kontribuojmë personalisht dhe institucionalisht për të ndihmuar vendin tonë. Në këtë fazë janë ndërtuar shumë sisteme, politika, ligje dhe infrastrukturë. Na mbetet të bashkëveprojmë dhe të bashkëpunojmë më shumë.

Mesazhi im për të ardhmen është të shmagim burokracinë dhe pengesat, duke u fokusuar në hapje dhe bashkëpunim për cilësinë dhe vlerat që i njej shoqëria si të tilla. UBT-ja ka qenë dhe mbetet e angazhuar për këtë mision dhe do të vazhdojë të kontribuojë me përgjegjësi.

Për ta përmbyllur këtë intervistë e cila pati shumë informacione pozitive rreth suksesit dhe zhvillimit, një urim për vitin e ri 2025 për gjithë ata që do ta lexojnë?

Rektori Hajrizi: Natyrisht, intervista e fundvitit është gjithmonë edhe një reflektim mbi vitin që lamë pas. Jemi shumë falënderues dhe të lumtur për zhvillimet e mira të UBT-ja. Kemi arritur të realizojmë shumë suksese, të marrim çmime dhe të zhvillojmë aktivitete të shumta. Dua të falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar në këto arritje, veçanërisht për akreditimin pesëvjeçar të institucionit tonë, i cili është një sukses i madh.

Falënderoj stafin, partnerët, institucionet e Kosovës, familjet, nxënësit dhe studentët tanë për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre. Për vitin 2025 uroj shëndet, lumturi dhe suksese për të gjithë. Le të jetë një vit ku plotësohen dëshirat dhe realizohen objektivat për një të ardhme më të mirë.

Shënohet edhe një sukses të radhës në arenën ndërkombëtare UBT renditet në mesin e Top 200 Universiteteve më të mira në botë për luftën ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe Qëndrueshmërisë Mjedisore

Renditja Botërore e Universiteteve në GreenMetric është një renditje e universiteteve që investojnë dhe fokusohen në Kampuset e Gjelbëra dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Nëpërmjet 39 treguesve në 6 kategori, UI GreenMetric World University Rankings përcakton nivelin e angazhimit dhe renditjen e universiteteve sipas performances së tyre në raport me nismat mjedisore

UBT po vazhdon të merr vlerësime të rëndësishme dhe njohje të kontributit në arenën ndërkombëtare.

Kështu, pas çmimeve prestigjioze ndërkombëtare si "European Young Entrepreneurial University of the Year", renditja në vendin e 6-të në botë për sa i përket aplikimeve të Revolucionit të Katërt Industrial si dhe renditjes në mesin e top 100 universiteteve më të mira në botë për Impakt Real – WURI, në këtë fillimvit UBT është renditur në mesin e Top 200 Universiteteve më të mira në botë për luftën ndaj Ndryshimeve Klimatike nga GreenMetric World University Ranking 2023.

Renditja Botërore e Universiteteve në GreenMetric është një renditje e universiteteve që investojnë dhe fokusohen në Kampuset e Gjelbëra dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Nëpërmjet 39 treguesve në 6 kategori, UI GreenMetric World University Rankings përcakton nivelin e angazhimit dhe renditjen e universi-



teteve sipas performances së tyre në raport me nismat mjedisore.

Kjo renditje vlerëson universitetet bazuar në kontributet e tyre të prekshme në luftimin e ndryshimeve klimatike dhe promovimin e qëndrueshmërisë përmes ideve dhe iniciativave inovative në lidhje

me shfrytëzimin eficient të energjisë dhe përdorimit të energjisë së ripërtëritshme, shfrytëzimin eficient të ujit dhe trajtimin e ujërave të zeza, riciklimi i mbeturinave, hapësirat e gjelbëra brenda kampusit, mobiliteti dhe transporti i gjelbër, etj.

Renditja i kushton gjithashtu rëndësi

edhe nxitjes së ndryshimit të sjelljes brenda komunitetit universitar si dhe adresimit të sfidave ekonomike dhe sociale që lidhen me qëndrueshmërinë.

Ndërsa Kategoria Energjia dhe Ndryshimet Klimatike, në të cilën UBT është renditur në mesin e Top

200 universiteteve në botë- përkatësisht në vendin e 175-të përbën kategorinë me peshën më të lartë nga të gjitha 6 kategoritë e renditjes.

Në këtë kategori universitetet vlerësohen për iniciativa, masa dhe veprime konkrete në raport me luftën ndaj Ndryshimeve Klimatike. Në këtë kontekst, universitetet vlerësohen për hartimin e politikave, strategjive dhe iniciativave konkrete në këtë fushë, duke përfshirë masat dhe projektet konkrete në shfrytëzimin e energjisë së ripërtëritshme, ndërtesat e gjelbëra, masat për maksimalizim të efikasitetit në energji, masat për reduktimin e emetimit të CO2 etj.

UBT tashmë ka Strategjinë Institucionale për Universitetin të Gjelbër dhe Neutral Ndaj Carbonit, si dhe Strategjinë Institucionale për Promovimin dhe Implementimin e SDG-ve. Ndërsa institucioni tashmë ka pranuar disa njohje të rëndësishme ndërkombëtare të kontributit të tij në këtë fushë.

UBT rangohet si institucioni i vetëm i arsimit të lartë privat në mbarë trojet shqiptare në SCImago



Ranglista botërore e universiteteve prestigjioze, SCImago, ka ranguar UBT-në si institucionin më të mirë dhe të vetmin në arsimit të lartë privat në mbarë trojet shqiptare.

UBT ka qenë gjithmonë institucion model i cili ka kontribuar fuqishëm në imazhin e Kosovës gjithandëj botës, kësaj radhe krahas shumë universiteteve prestigjioze në botë, UBT është institucioni i vetëm jopublik në mbarë trojet shqiptare që është ranguar në mesin e universiteteve në klasifikimin e universiteteve në SCImago, duke u bërë institucioni më i suksesshëm në rajon, por edhe duke e ngritur nivelin e përfaqësimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka thënë se kjo arritje tregon për cilësinë dhe modelin më të mirë të institucionit arsimor që ka ndërtonuar UBT ndër vite. "Ne kemi arritur të ndërtojmë një ekosistem i cili ndërthurë në vete të gjitha fushat. Për ndërthurjen e të gjitha fushave, nga teknologjia e deri te shkencat sociale, UBT është ranguar dhe renditur në organizata e institucione prestigjioze ndërkombëtare. Rangimi i UBT-së në Scimago dëshmon angazhimin tonë të përbashkët drejt transformimit të arsimit në Kosovë dhe rajon. Fakti që UBT është i vetmi institucion i arsimit të lartë privat në Kosovë, Shqipëri, dhe më gjerë, i renditur në Scimago, tregon për cilësinë dhe modelin më të mirë të institucionit arsimor që ka ndërtonuar UBT ndër vite", ka thënë Rektori Hajrizi. UBT krahas kësaj ka shënuar suksese të tjera të jashtëzakonshme në fushën e hulumtimeve dhe kërkimeve shkencore. Vlen të përmendet që UBT është ranguar krahas universiteteve prestigjioze në WURI, GreenMetric World University Ranking, Webometrics, EFQM, si dhe është nderuar me çmime prestigjioze si "European Young Entrepreneurial University of the Year".

UBT i vetmi institucion në Kosovë që ofron 'Double Degree' me Sapienza University of Rome



Cilësi, inovacion dhe ndërkombëtarizim, UBT shënon një hap të rëndësishëm drejt arsimit të lartë me një lajm të rëndësishëm për studentët e saj. Duke qenë zgjedhja e parë e studentëve, UBT bëhet institucioni i vetëm në Kosovë që ofron mundësinë e marrjes së një 'Double Degree' me një nga universitetet më prestigjioze në Evropë, Sapienza University of Rome.

Në një bashkëpunim të ndritur, UBT dhe Sapienza University of Rome sjellin një marrëveshje inovative që hap dyert e studimeve për studentët kosovarë. Me një histori të ndritur që fillon qysh në vitin 1303, Sapienza është një nga institucionet më të vjetra dhe më të mëdha në Evropë. Tani, studentët e UBT-së do të kenë mundësinë e një eksperience të studimit në këtë universitet të shquar

me një kosto të përballeshme.

Me një reputacion të lartë në arenën ndërkombëtare, Sapienza University of Rome shquhet në top-listat e universiteteve më të mira në botë. Ajo renditet nën 150 universitetet më të mira sipas QS World University Rankings, #181 sipas Times Higher Education – World University Rankings, dhe në 101 universitetet e para sipas Academic Rankings of World Universities.

Në thelb të kësaj marrëveshjeje është mundësia e fituar për studentët e Inxhinierisë së Agrikulturës dhe Mjedisit për të marrë dy diplomate e njohura nga dy institucione të shquara. Regjistrimet janë në prag të hapjes, kështu që studentët janë ftuar të mos humbasin këtë mundësi të rrallë për të filluar rrugëtimin e tyre të arsimit të lartë në Romë!

Kjo përvojë e jashtëzakonshme ofron jo vetëm një rritje në njohuritë akademike, por edhe një ekspozim ndërkombëtar të pasur, duke hapur horizonte të reja për të ardhmen e studentëve të UBT-së. Së bashku me Sapienza University of Rome, UBT vazhdon të përforcojë qëllimin e saj për të siguruar një arsim të lartë të përshtatshëm me kërkesat dhe mundësitë e botës së sotme.

UBT renditet në mesin e top 100 universiteteve në botë në fushën e arkitekturës dhe inxhinierisë civile

UBT po vazhdon të merr vlerësime të rëndësishme dhe njohje të kontributit në arenën ndërkombëtare. UBT falë kontributit dhe punës së studentëve dhe stafit akademik është renditur si i vetmi institucion i arsimit të lartë privat në mbarë trojet shqiptare në mesin e top 100 universiteteve botërore në fushën e arkitekturës dhe inxhinierisë civile në INSPIRELI AWARDS.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka vlerësuar lartë kontributin e secilit student dhe stafit akademik për këtë arritje, e cila dëshmon edhe njëherë se UBT vazhdon rrugën me hapa të sigurt drejt përsosmërisë akademike dhe profesionale. Ai theksoi se ky sukses është rezultat i punës së palodhshme dhe përkushtimit të gjithanshëm për të ofruar një arsim cilësor dhe për të



inkurajuar inovacionin dhe krijimtarinë në fushën e arkitekturës dhe inxhinierisë civile. "Jemi krenarë për këtë arritje të madhe dhe për reputacionin që kemi ndërtonuar në

arenën ndërkombëtare. Ky sukses nuk është vetëm një reflektim i punës sonë të palodhshme, por edhe një nxitje për të vazhduar të investojmë në cilësinë e arsimit

dhe kërkimit shkencor", tha Rektori Hajrizi. Renditja e UBT-së në INSPIRELI AWARDS njeh veçanërisht mbështetjen e institucionit për të motivuar studentët për të marrë pjesë në konkurs, gjë që është vendimtare për përgatitjen e tyre për suksesin e ardhshëm profesional. Përveç pjesëmarrjes në konkurs, performanca e studentëve individualë vlerësohet edhe në bazë të projekteve të tyre akademike.


Çdo finalist apo fitues i këtij konkursi konsiderohet kështu një talent i padiskutueshëm me potencial për t'u bërë një krijues i suksesshëm i së ardhmes së qyteteve botërore.

UBT - lider i arsimit privat në Kosovë dhe rajon për nga renditja në Webometrics

Platforma "Webometrics", e cila është një projekt i Cybermetrics Lab, pjesë e Këshillit Kombëtar Kërkimor të Spanjës, ofron një vlerësim të gjerë të institucioneve të arsimit të lartë në mbarë botën, duke përdorur një sërë kriteresh, përfshirë numrin e citimeve në "Google Scholar"

UBT është renditur sërish institucioni i parë i arsimit të lartë privat në rangimin e fundit të universiteteve sipas numrit të citimeve të publikimeve të stafit, bazuar në profilet e tyre në "Google Scholar" nga platforma "Webometrics". Ky sukses dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të UBT-së për të promovuar cilësinë akademike dhe kërkimore në Kosovë dhe më gjerë.

Në këtë ranglistë, UBT renditet menjëherë pas Universitetit të Prishtinës (UP) për nga numri i citimeve të publikimeve të stafit akademik. Ky është një rezultat i jashtëzakonshëm që konfirmon pozitën udhëheqëse të UBT-së në sektorin privat të arsimit të lartë. Në periudhën janar – korrik 2024, UBT ka shënuar një rritje të konsiderueshme prej 1465 citimesh.



Ky rezultat është një dëshmi e përkushtimit të stafit akademik të UBT-së ndaj kërkimit shkencor dhe publikimeve cilësore. Citimet janë një tregues i rëndësishëm i ndikimit të punës kërkimore, dhe rritja e numrit të citimeve reflekton cilësinë dhe rëndësinë e punimeve të publikuara nga akademikët e UBT-së.

Platforma "Webometrics", e cila është një projekt i Cybermetrics Lab, pjesë e Këshillit Kombëtar Kërkimor të Spanjës, ofron një vlerësim të gjerë të institucioneve të arsimit të lartë në mbarë botën, duke përdorur një sërë kriteresh, përfshirë numrin e citimeve në "Google Scholar". Modeli i ndjekur për kategorinë e transparencës bazohet në mbledhjen e citimeve nga 310 profilet publike të autorëve më të cituar, duke përfshirë 20

të parët. Kjo metodë siguron një përfaqësim të drejtë dhe të balancuar të ndikimit akademik të institucioneve të ndryshme.

UBT vazhdon të investojë në zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe në mbështetjen e stafit akademik për të publikuar punime shkencore në revista të njohura ndërkombëtare.

UBT mbetet e përkushtuar për të avancuar më tej në renditjen ndërkombëtare dhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe kërkimit në Kosovë dhe rajon. Me angazhimin e vazhdueshëm të stafit dhe studentëve, UBT synon të vazhdojë të jetë një qendër ekselence akademike dhe kërkimore, duke kontribuar në zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës dhe më gjerë.

UBT i bën Kosovës një dhuratë të veçantë në Ditën e Çlirimit:

Rangohet në mesin e më të mirëve në Times Higher Education Impact Ranking

Times Higher Education ka publikuar sot rangimin e vitit 2024 të universiteteve në kategorinë Impact Ranking. Në këtë rangim ndërkombëtar i cili matë dhe vlerëson punën dhe angazhimin e universiteteve në raport me zhvillimin e qëndrueshëm në përgjithësi dhe në raport me adresimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së në veçanti, UBT është ranguar në mesin e 300-400 universiteteve me impaktin më të madh në një sërë kategorish.

Në këtë mënyrë, UBT është ranguar në mesin e Top 300-400 universiteteve në botë në SDG 1 – Luftimi i

Varfërisë; SDG 2 – Politikat Kundër Urisë; SDG 6 – Në politikat për ujë të pastër dhe trajtim të ujërave të zeza, ndërsa është ranguar në mesin e Top 400-600 universiteteve me impaktin më të madh në SDG 9 – Fushën e Inovacionit Industrial dhe Infrastrukturës, e po ashtu edhe në mesin e 400-600 universiteteve me impaktin më të madh në SDG 11 – Për Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme.

Në secilën kategori tjetër të adresimit të SDG-ve, UBT është ranguar në mesin e top universiteteve botërore, duke dëshmuar kështu rëndësinë që u jep përmesues së



objektivave globale për zhvillim të qëndrueshëm.

Ky rangim i radhës i UBT-së përveç që vazhdon ta avancojë emrin e Republikës së Kosovës në instancat më prestigjioze të rangimeve ndërkombëtare, ai njëkohësisht dëshmon përkushtimin dhe konsistencën e institucionit në krijimin e një ambienti të qëndrueshëm shkencor, ekonomik, mjedisor, infrastrukturor dhe inovativ duke adresuar dhe promovuar të gjitha dimensionet dhe fushat e zhvillimit të qëndrueshëm të gjithmbarshëm.

UBT më i miri në rajon sipas rangimeve WURI 2024



UBT është ranguar sërish si më i miri në rajon në disa kategori të veçanta nga World University Rankings for Innovation (WURI 2024).

Në vendin e 5-të për kategorinë "Support for Global Resilience", në vendin e 26-të për kategorinë "Generative AI Application" dhe në vendin e 29-të për kategorinë "Crisis Management".

Kjo renditje ka bërë që UBT të jetë në mesin e 300 universiteteve më të mira në botë në kategorinë e përgjithshme, duke vazhduar të përfaqësojë nivelin e lartë të cilësisë dhe ndikimit të tij në nivel global. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka thënë se ky rezultat tregon për ngritjen e institucionit në nivel ndërkombëtar dhe botëror, por edhe e vendos Kosovën në hartën e universiteteve

më prestigjioze në botë.

"UBT po dëshmon se ka filluar të pozicionohet në pjesën e krahasimit me institucionet e tjera nëpër botë dhe jemi shumë kërenar që sot kemi rezultate shumë të mira në rangimet në disa kategori të WURI, duke e vendosur kështu Kosovën në hartën e universiteteve më prestigjioze në botë", ka thënë Rektori Hajrizi.

UBT është renditur në vendin e 5-të për kategorinë "Support for Global Resilience", e cila tregon angazhimin e institucionit në promovimin e qëndrueshmërisë globale dhe përkrahjen e iniciativave të projekteve dhe programeve që kontribuojnë në reziliencën globale. Në këtë kategori, UBT është vlerësuar për bashkimin me iniciativat globale të universiteteve për të kontribuar në zbutjen

e ndikimit të luftës në Ukrainë. Në këtë kontekst, UBT përmes Media Group ka ndihmuar në informimin e drejtë dhe të paanshëm, ka ndarë bursa për studentët ukrainas që dëshirojnë të studiojnë në UBT, ka mirëpritur në takim gazetarët ukrainas të strehuar në Kosovë, si dhe ka mbajtur diskutime e panele të hapura për të adresuar këtë temë. Vendin e 26-të, UBT e ka nxënë në kategorinë për "Generative AI Application", përmes së cilës dëshmon se është institucioni lider për integrimin e teknologjisë gjeneruese AI dhe AVR. UBT nxit inovacionin me laboratorët e AI-së dhe të Sigurisë Kibernetike, qendrat e shumta dhe një ekip profesionistësh të sigurisë kibernetike. AI gjeneruese përmirëson mësimin, administrimin dhe kërkimin, duke u fokusuar në ndërveprim dhe etikë.

Në mesin e universiteteve më prestigjioze në botë, UBT është ranguar në vendin e 29-të për kategorinë "Crisis Management", për të cilën dëshmon se është përqendruar një politikë për rritjen e qëndrueshmërisë, energjinë e rinovueshme dhe eficiencën, ndërtimin e gjelbër dhe të mençur, si dhe zhvillimin e përgjithshëm duke adresuar çështjen e ndryshimeve klimatike.

UBT mbetet institucioni lider i arsimit të lartë privat në mbarë trojet shqiptare në "Webometrics"



UBT ka shënuar ngritje prej 3 mijë vende në renditjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë për vitin 2024 për nga numri i citimeve të publikimeve të stafit në platformën "Webometrics", duke u renditur institucioni i dytë në Kosovë dhe i treti në trojet shqiptare.

Cybermetrics Lab, pjesë e Këshillit Kombëtar të Kërkimit Spanjoll, ka publikuar edicionin e tyre të vitit 2024 për renditjen e mbi 30,000 Institucioneve të Arsimit të Lartë në nivel global.


Ky sukses thekson një standard të lartë cilësie dhe zhvillimin e shkencës në kuadër të institucionit arsimor, shndërruar kështu në një pikë referimi për avancimin e njohurive shkencore në vend.

UBT vazhdimisht punon në aspektin e rritjes së standardeve të larta në arsim dhe hulumtim, duke kontribuar në rritjen e nivelit të njohurive shkencore në Kosovë dhe përtej saj.

Nga Franca për Kosovën

Rektori i UBT-së nderohet me çmimin “European Quality Leader First Finalist” nga Organizata Evropiane për Cilësi

“Për mua dhe për vendin tim, marrja e këtij çmimi është një arritje e veçantë dhe e paharrueshme. Ky çmim nuk është thjesht një nderim personal, por një njohje për gjithë punën që kemi bërë në avancimin e cilësisë dhe në përmirësimin e standardeve të jetesës”, u shpreh Rektori Hajrizi



“Për mua dhe për vendin tim, marrja e këtij çmimi është një arritje e veçantë dhe e paharrueshme. Ky çmim nuk është thjesht një nderim personal, por një njohje për gjithë punën që kemi bërë në avancimin e cilësisë dhe në përmirësimin e standardeve të jetesës”, u shpreh Rektori Hajrizi.

Çmimi i dhënë nga EOQ vlerëson individët që kanë udhëhequr me sukses organizata dhe kanë kontribuar në mënyrë të jashtëzakonshme për përmirësimin e cilësisë dhe menaxhimin e saj, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.

Ky çmim është një dëshmi për përkushtimin e Rektorit Hajrizi ndaj cilësisë, inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke krijuar mundësi për rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorëve të ndryshëm që lidhen me

nderim i madh për Kosovën. Ai e konsideroi këtë çmim si një arritje të përbashkët dhe ia dedikoi atë Kosovës, kolegëve dhe familjes.

“Ky çmim është një nderim që ia dedikoj Kosovës, stafit tim, kolegëve dhe familjes time. Motivimi më i madh për mua është ta prezantoj këtë arritje si një sukses të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ky çmim konfirmon se Kosova ka kaluar fazën e tranzicionit dhe ka hyrë në zhvillimin e saj të qëndrueshëm,” theksoi Rektori Hajrizi.

Organizata Evropiane për Cilësi (EOQ) përfshin më shumë se 70,000 anëtarë dhe 500,000 kompani brenda organizatave anëtare dhe partnere të saj në Evropë dhe në mbarë botën.

Çmimi “European Quality Leader First Finalist” jepet çdo vit nga



Në Kongresin e 65-të të European Quality Congress, i cili u mbajt në Francë, themeluesi dhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, është nderuar me çmimin European Quality Leader First Finalist nga Organizata Evropiane

për Cilësi (EOQ). Në mesin e personaliteteve të shumta nga Evropa, ShBA, Kina, India, Kanada dhe shumë shtete të tjera, Rektori Hajrizi u nderua për kontributin e jashtëzakonshëm në avancimin dhe promovimin e menaxhimit të

cilësisë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në nivel global. Ky çmim është një vlerësim për përkushtimin dhe punën e tij të gjatë në fushën e cilësisë dhe përpjekjet që kanë ndikuar në ngritjen e standardeve të cilësisë dhe zhvillimin e shoqërisë.

menaxhimin e cilësisë. Rektori Hajrizi është personaliteti i parë në mbarë trojet shqiptare, dhe ndër personalitetet e pakta në Evropë, që është nderuar me çmim të tillë. Në fjalën e tij, Rektori Hajrizi theksoi se ky çmim është një

EOQ për personalitete të njohura që kanë arritur të udhëheqin organizatat e tyre drejt suksesit, si dhe për ata që kushtojnë kohën, energjinë dhe njohuritë e tyre duke ndarë bindjet për të mirën e shoqërisë evropiane!

Sipas Renditjes Kombëtare të H-indeksit për tremujorin e katërt të vitit 2024

UBT udhëheq arsimin e lartë privat në Kosovë për kërkimet shkencore

Ky sukses i UBT-së në renditjen e H-indeksit shërben si një shembull frymëzues për komunitetin akademik dhe kërkimor në Kosovë, duke e vendosur institucionin si një pikë referimi për cilësinë dhe qëndrueshmërinë në fushën e kërkimeve shkencore

UBT është renditur përsëri në pozitën kryesore në Renditjen Kombëtare të H-indeksit për Kosovën, duke dëshmuar përkushtimin e tij në zhvillimin e shkencës dhe kërkimeve në vend. Kjo renditje, e cila vlerëson performancën e institucioneve të arsimit të lartë bazuar në indeksin H të platformave si Scopus, Web of Science dhe Google Scholar, e pozicionon UBT-në si një nga institucionet më të rëndësishme që kontribuon në avancimin e njohurive shkencore në Kosovë.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr.

Edmond Hajrizi, ka theksuar rëndësinë e një mjedisi që mbështet zhvillimin e talenteve dhe inovacionit.

“Në UBT, ne jemi të përkushtuar për të krijuar një hapësirë ku talenti dhe inovacioni takohen për të nxitur shkencën dhe kulturën e kërkimit. Ky rezultat i lartë në Renditjen Kombëtare të H-indeksit është dëshmi e përkushtimit tonë të vazhdueshëm për të kontribuar në përparimin e dijes dhe zhvillimin shkencor jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë”, deklaroi Rektori Hajrizi.

Ky sukses i UBT-së në renditjen e



H-indeksit shërben si një shembull frymëzues për komunitetin akademik dhe kërkimor në Kosovë, duke e vendosur institucionin si një pikë referimi për cilësinë dhe qëndrueshmërinë në fushën e kërkimeve shkencore. Përmes këtij angazhimi, UBT po ndihmon në vendosjen e standardeve dhe përcaktimin e prioritetëve për zhvillimin e kërkimeve në vend, duke kontribuar në ngritjen e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare të shkencës.

UBT dhe Italia bashkojnë forcat për inovacion dhe zhvillim ekonomik

Hapet Qendra “Hub Revolution Your Start Up”

Ambasadori i Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, vlerësoi iniciativën për themelimin e kësaj qendre, teksa nënvizoi se përmes këtij projekti, do të forcohet inovacioni dhe sipërmarrësia në rajon, duke sjellë një të ardhme më të zhvilluar dhe të shëndoshë

Në Qytetin e Mençur të UBT-së në Lipjan, u bë inaugurimi i Zyrës “Hub Revolution Your Start Up”. Kjo ngjarje përfaqësoi një hap të rëndësishëm në mbështetje dhe zhvillim të inovacionit, teknologjisë, dhe sipërmarrjes në rajon, duke krijuar një ambient frymëzues për të rinjtë dhe profesionistët që dëshirojnë të realizojnë idetë e tyre dhe të ndërtojnë të ardhmen.

Inaugurimi kishte për qëllim jo vetëm promovimin e vizionit të Hub Revolution Your Start Up si një qendër inovacioni dhe zhvillimi profesional, por edhe nxitjen e dialogut mes botës akademike dhe asaj të biznesit. Kjo është një mundësi për të krijuar ura bashkëpunimi që do të mundësojnë transferimin e njohurive, burimeve dhe aftësive ndërmjet këtyre dy sektorëve.

Ambasadori i Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, vlerësoi iniciativën për themelimin e kësaj qendre, teksa nënvizoi se përmes këtij projekti, do të forcohet inovacioni dhe sipërmarrësia në rajon, duke sjellë një të ardhme më të zhvilluar dhe të shëndoshë.

“Kosova ka një popullatë të re dhe sektorë të rëndësishëm për zhvillim. UBT ka kapacitete të mjaftueshme për të edukuar në këtë nivel”, tha De Riu. Ai gjithashtu vuri në dukje kontributin e diasporës, e cila ka sjellë zhvillim dhe eksperiencë të vlefshme në vend.

Ambasadori theksoi se disa organizata janë të gatshme të ndihmojnë në zhvillimin e start-up-ëve dhe se është e rëndësishme të kërkohet zhvillimi përmes inovacioneve të reja dhe granteve nga Qeveria. Ai përmendi gjithashtu rëndësinë e sektorëve si agrobizneset dhe energjia e ripërtëritshme, duke ofruar zgjidhje për ndërmarrësinë.

Në përfundim, Ambasadori De Riu shprehur besimin se kjo qendër në



UBT do të krijojë mundësi të reja për Kosovën dhe do të avokojë për start-up-et në Bashkimin Evropian. Kjo iniciativë ka potencialin për të transformuar peizazhin ekonomik të rajonit dhe për të inkurajuar inovacionin dhe sipërmarrjen në çdo nivel.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e inaugurimit të Zyrës “Hub Revolution Your Start Up” duke shprehur se “kjo është një ngjarje e rëndësishme sepse krijojmë një pikë të re në Kosovë, ku dëshirojmë të forcojmë bashkëpunimin me Italinë”. Ai theksoi se UBT ka ndërtuar një ekosistem inovativ me një hapësirë të shkëlqyer fizike dhe akademike, së bashku me infrastrukurë shtesë që mbështet këto partneritete.

Rektori Hajrizi vazhdoi duke theksuar se “ideja që kemi është se ka ende hapësirë për të mbështetur këtë bashkëpunim dhe për të rritur kom-

petencat në gjenerimin e lidhjeve me fondet për zhvillim”. Ai theksoi se bashkimi i forcave do të krijojë një qendër revolucionare, duke argumentuar se kjo është një mundësi e rëndësishme për të avancuar më tej. Ai po ashtu theksoi rritjen e bashkëpunimeve me institucionet italiane, duke përmendur diplomatë e përbashkëta dhe mobilitete të ndryshme që kanë kontribuar në ngjitjen e bashkëpunimit me industrinë italiane. “Kemi arritur ta bëjmë gjuhën italiane gjuhë zyrtare në UBT, duke e shndërruar institucionin tonë në një qendër proaktive për lidhjet e bizneseve”, përfundoi ai, duke shprehur optimizëm për të ardhmen e bashkëpunimit me Italinë.

Massimiliano Adilardi nga d’Impresa, theksoi se “perspektiva e ndërmarrësisë në Kosovë është shumë e rëndësishme dhe çdo sipërmarrës duhet ta marrë parasysh këtë mundësi”. Ai vuri në dukje se ka

shumë kapacitete të studentët e rinj dhe shprehu dëshirën për të kontribuar në këtë aspekt.

Adilardi, me një përvojë 40-vjeçare si ekspert në politikën fiskale, shprehu angazhimin e tij për të ofruar asistencë për kapacitetet që gjenden në Kosovë. “Do ta përdorim këtë si një pikë mbështetje për Universitetin UBT dhe do ta përcjellim këtë mbështetje te studentët, duke promovuar gjithashtu bashkëpunimin eurokosovar”, shtoi ai.

Ai përfundoi me një thirrje për të gjithë që të angazhohen në zhvillimin e demokracisë dhe ekonomisë në Kosovë, duke theksuar rëndësinë e këtij angazhimi për të ardhmen e vendit.

Flavio Boccia nga Flavio Boccia & Partners, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në projektin e ri, duke falënderuar të gjithë partnerët që kanë kontribuar me praninë e tyre. “Ne jemi këtu për t’u

shndërruar në një motor të ndërmjetësimit të fondeve evropiane dhe për të zhvilluar hartën e veprimtarisë në Ballkan”, deklaroi ai. Ai e theksoi përkushtimin e kompanisë për të mbështetur zhvillimin ekonomik në rajon.

Në vijim, Paolo Stern, përfaqësues i Nexumstp – Your Next Step nga Roma, theksoi rolin e rëndësishëm të biznesit në këtë proces. “Është e rëndësishme që bizneset të jenë krijuese dhe të eksplorojnë interesat e tyre”, tha ai. “Ne ofrojmë asistencë për të gjithë anëtarët tanë dhe do të angazhohet ekspertët tanë për të fokusuar zhvillimin ekonomik të Kosovës, duke bashkëpunuar me partnerët tanë”. Ai gjithashtu theksoi rëndësinë e ofrimit të trajnimeve për studentët, duke theksuar se “duhet të punojmë së bashku për të kontribuar në Evropë, duke marrë parasysh edhe Kosovën”.

Në këtë ngjarje, e cila u moderua nga gazetari i njohur Artur Nura, morën pjesë edhe personalitete të tjera të shquara nga fusha e politikës, biznesit dhe ekonomisë, ndër të tjera folën edhe ish-kryetari i Komunitetit të Presheves, tashmë nënkryetar në këtë Komunitet, Prof. Ragmi Mustafa, Kryetari i Rrjetit Global të Bizneseve të Diasporës Shqiptare, Omer Nura, Kryetari i Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, Xhelal Mehmeti, si dhe Francesca Mondello nga ICE – Italian Trade Agency.

Gjithashtu në këtë ngjarje, fjalën e mori edhe generali Giuseppe Morabito, i cili diskutoi mbi rëndësinë e rinisë në Kosovë dhe rolin e UBT-së në mbështetje të saj. Ai theksoi se rinia përbën një potencial të madh për zhvillimin e vendit dhe se universitetet si UBT-ja luajnë një rol kyç në formimin e liderëve të ardhshëm.

Në UBT hap Qendra për Njohuritë e Gjuhës Italiane

Instituti i Gjuhëve të Huaja në UBT, në bashkëpunim me Ambasadën Italiane në Kosovë, organizoi një event të veçantë në kuadër të Javës së Gjuhës Italiane. Kjo ngjarje shënoi inaugurimin e Qendrës për Njohuritë e Gjuhës Italiane, një arritje e rëndësishme për përhapjen e studimit të kësaj gjuhe në vend.

Ceremonia u zhvillua në një atmosferë festive, duke sjellë së bashku studentë, profesorë dhe përfaqësues të Ambasadës Italiane, të gjithë të angazhuar për të thelluar lidhjet kulturore mes Kosovës dhe Italisë.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, përshëndeti të pranishmit në këtë ngjarje të rëndësishme. Ai theksoi se hapja e Qendrës për Njohuritë e Gjuhës Italiane është një arritje e madhe për institucionin dhe për të rinjtë e Kosovës, duke e konsideruar këtë bashkëpunim me Ambasadën Italiane një hap të rëndësishëm për forcimin e lidhjeve kulturore mes dy vendeve.

Gjuha italiane, sipas rektorit Hajrizi, nuk është thjesht një mjet komunikimi, por një pasuri kulturore dhe historike që na lidh me trashëgiminë e pasur të Italisë. Dhe se ajo na ofron mundësinë të kuptojmë më mirë kulturën dhe traditat italiane, dhe



të forcojmë marrëdhëniet tona kulturore dhe ekonomike.

“Njohja e gjuhës italiane është një investim në arsimimin e studentëve, duke u ofruar atyre mundësi për të zhvilluar karrierat e tyre në një treg gjithnjë e më global”, u shpreh rektori Hajrizi. Ai e përfundoi fjalimin duke shprehur besimin se njohja e gjuhës italiane do t’i ndihmojë studentët në zhvillimin e karrierave të tyre dhe do të forcojë lidhjet kulturore mes Kosovës dhe Italisë.

Pas fjalës së rektorit, Ambasadori i Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, mori fjalën dhe shprehu përkushtimin e thellë të ambasadës për të mbështetur iniciativën që promovoj-

një kulturën italiane. Ai theksoi se aktivitetet si ky event janë thelbësore për ndërtimin e urave të komunikimit dhe miqësisë midis popujve të Kosovës dhe Italisë.

Ambasadori De Riu inkurajoi studentët dhe të pranishmit të përfitojnë nga mundësitë që ofrohen për të njohur më mirë kulturën italiane, duke e parë atë si një mundësi për rritje personale dhe profesionale. “Le të shfrytëzojmë këtë mundësi për të thelluar njohuritë tona dhe për të forcuar lidhjet mes dy vendeve tona”, përfundoi ai, duke inkurajuar gjithashtu një angazhim të vazhdueshëm në promovimin e kulturës italiane.



Më pas, Media Grupi i UBT-së prezantoi një video të veçantë, e cila ishte përgatitur në gjuhën italiane me titra shqip nga profesorë dhe studentë që kanë studiuar dhe vepruar në Itali, duke ndarë eksperiencën e tyre dhe duke vënë në theks se sa e rëndësishme është gjuha italiane për ta. Kjo video shërbeu si një pasqyrë e angazhimeve dhe përvojave të tyre në këtë vend, duke ilustruar mundësitë e shumta që ofron gjuha italiane.

Më pas, event i vazhdoi me shfaqjen e filmit “Perfetti Sconsciuti” të Paolo Genovese (2016), një komedi-dramë që trajton temat e marrëdhënieve dhe miqësisë. Filmi u

shfaq në italisht me titra në anglisht, duke ofruar një mundësi për studentët të përmirësojnë njohuritë e tyre gjuhësore në një atmosferë argëtimit.

Ky aktivitet jo vetëm që festoi kulturën italiane, por gjithashtu forcoi lidhjet ndërkulturore mes Kosovës dhe Italisë, duke promovuar bashkëpunimin dhe miqësinë ndërmjet popujve. Inaugurimi i Qendrës për Njohuritë e Gjuhës Italiane është një hap i rëndësishëm drejt avancimit të edukimit dhe ofrimit të mundësive të reja për të rinjtë kosovarë, duke e bërë italishten një pjesë të rëndësishme të arsimit të tyre.

Historike

Kosova pranohet në elitën botërore të mjekësisë sportive

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ishte i pranishëm për të paraqitur prezantimin dhe për ta bërë këtë kërkesë historike. Ai falënderoi delegatët për kontributin e tyre në këtë proces dhe e vlerësoi Komitetin Ekzekutiv për pranimin e vendimit në Këshillin e Përgjithshëm të Delegatëve

Kosova hyn fuqishëm në historinë ndërkombëtare, duke u bërë pjesë e Federatës Ndërkombëtare për Mjekësinë Sportive (FIMS) si anëtare e rregullt. Ky vendim, u mor në mbledhjen e Këshillit të Delegatëve në Dubai të shtunën më 26 tetor.

Përveç një abstenimi nga Gjeorgjia, të gjitha vendet e pranishme votuan unanimitet për anëtarësimin e Kosovës, duke pranuar me entuziazëm projektin e Asociacionit të Kosovës për Mjekësi Sportive (KASEM), një iniciativë që u themelua nën iniciativën e UBT-së.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ishte i pranishëm për të paraqitur prezantimin dhe për ta bërë këtë kërkesë historike. Ai falënderoi delegatët për kontributin e tyre në këtë proces dhe e vlerësoi Komitetin Ekzekutiv për pranimin e vendimit në Këshillin e Përgjithshëm të Delegatëve. Një falënderim i veçantë shkoi për Profesor Norbert Bachl, i



cili ka qenë një mbështetje e vazhdueshme për Kosovën në ndihmën e ndërtimit të strukturave të nevojshme për anëtarësim, si dhe Presidentin e FIMS, Prof. Fabio Pigozzi. Rektori Hajrizi theksoi se Kosova do të jetë një anëtare e angazhuar dhe e përgjegjshme, e gatshme për të kon-

tribuar në zhvillimin e mjekësisë sportive në nivele të reja ndërkombëtare. Ky anëtarësim përfaqëson jo vetëm një sukses të madh për Kosovën, por edhe një mundësi për të promovuar dhe zhvilluar edhe më shumë mjekësinë sportive me standarde ndërkombëtare.

Në këtë kontekst, Kosova përfundimisht po krijon një rrugë të re për sportistët dhe profesionistët e mjekësisë sportive, duke bërë një hap të rëndësishëm drejt një të ardhme më të ndritur. Anëtarësimi në FIMS është një dëshmi e angazhimit dhe përkushtimit të Kosovës për të avan-

cuar këtë disiplinë në nivel botëror, duke u bërë një model frymëzues për vendet e tjera.

Në këtë ngjarje të rëndësishme, përveç anëtarësimin, Rektori Hajrizi mori pjesë në Kongres, vizitoi parrin e teknologjisë në mjekësinë sportive dhe zhvilloi biseda me kompani për bashkëpunim me UBT dhe Kosovën. Rektori Hajrizi gjithashtu realizoi një sërë takimesh të ndryshme me delegatë dhe ekspertë nga vende të ndryshme, duke përfshirë përfaqësues të komiteteve olimpikë të botës.

Gjatë vizitës në Universitetin e Dubai për Mjekësi, ai gjithashtu mori pjesë në një konferencë paralele për ortopedi dhe pati një takim me Prof. Filippo Parisi nga Italia, udhëheqës i Shoulder Academy, me të cilin do të vazhdojë bashkëpunimi për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor.

UBT vendos Kosovën të parën në rajon në garën botërore të robotikës në Athinë



Kosova ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm në garën botërore të robotikës që u mbajt në Athinë, duke u renditur si ekipi i parë nga rajoni. Ekipi kosovar i përgatitur dhe udhëhequr nga UBT, FIRST Global Kosova, arriti të jetë në vendin e 65 nga 180 ekipe që morën pjesë, duke e kaluar me sukses Slloveninë, Kroacinë, Serbinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.

Roboti i dizajnuar nga ekipi kosovar, nën udhëheqjen e mentores Elita Hajrizi, u vlerësua për performancën e tij të shkëlqyer. Ai ishte stabil, pa defekte dhe shumë produktiv, çka tregon për nivelin e lartë të aftësive dhe profesionalizmit të ekipit. Kjo performancë e shkëlqyer është një dëshmi e punës së palodhur dhe përkushtimit të ekipit, që ka punuar me intensitet për të arritur këtë rezultat.

Mentorja Elita Hajrizi dhe anëtarja e ekipit, Harisa Haziri, u intervistuan nga televizioni grek, ERT News, ku theksuan rëndësinë e pjesëmarrjes në këtë garë ndërkombëtare.

Ekipi i Kosovës ka fituar poashtu dy çmime globale për promovimin e STEAM dhe Robotics: Njëri për Video Story Telling dhe çmimi i dytë për kontributin në Social Media. Zyra përfaqësuese e Kosovës ishte e pranishme gjatë gjithë ngjarjes, duke marrë pjesë në ceremoninë e hapjes dhe përfundimit të garës, duke e bërë të qartë angazhimin e Kosovës në promovimin e shkencës dhe teknologjisë.

Në përfundim të ngjarjes, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, është takuar Presidenti i FIRST Global Challenge, Dean Kamen, të cilit i ka bërë një kërkesë zyrtare për të organizuar këtë garë në vendin tonë në të ardhmen, duke synuar që të inkurajojë dhe mbështesë më tej zhvillimin e talenteve në fushën e robotikës. Ky hap do të ishte një mundësi e shkëlqyer për të nxitur pasionin e të rinjve për teknologjinë dhe inovacionin.

UBT ri-konfirmon liderhipin në ndërmarrësi dhe inovacion - fiton dy çmime prestigjioze nga Triple E Awards



Në një ceremoni të veçantë në Lisbona të Portugalisë, të organizuar nga ACEEU, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka ri-konfirmuar liderhipin duke fituar çmimin "Entrepreneurship Educator of the Year" nga prestigjiozi Triple E Awards. Në këtë ngjarje, UBT ka zënë vendin e dytë për çmimin "Young Entrepreneurial University of the Year", duke u vendosur në mesin e institucioneve më të njohura globale, dhe duke u

bërë pionier në Kosovë dhe rajon në arritjen e sukseseve kaq të larta. Ky vlerësim vjen për të dytin vit radhazi dhe është një dëshmi për inovacionet e shkëlqyera dhe strategjitë që UBT ka implementuar. UBT po kontribuon në krijimin e një ambienti arsimor që ndihmon në zhvillimin e liderëve të rinj dhe nxitjen e ideve të reja, duke ndikuar pozitivisht në shoqëri dhe duke transformuar të ardhmen e arsimit në Kosovë.

Në Prizren u bë inaugurimi i UBT Start Up School

Në Prizren, në mesin e përfaqësuesve të institucioneve publike dhe private, ndërmarrësve, profesorëve, studentëve dhe nxënësve, u bë inaugurimi i shkollës së ndërmarrësisë, UBT Start Up School. Quality Kosova me mbështetjen e ITP-së përmes GIZ-it Gjerman ka themeluar UBT Start-Up School, një iniciativë e cila ka për qëllim rritjen e aftësive dhe talentit të të rinjve në fushën e biznesit dhe inovacionit në Kosovë.

Në ceremoninë e inaugurimit, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, drejtor i Quality Kosova dhe themelues i UBT Start Up School, në fjalimin e tij shprehu synimin e shkollës për të promovuar njohuritë dhe aftësitë e rinisë në sipërmarrje. "Shkolla e Ndërmarrësisë është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të Kosovës, duke ofruar trajnim praktik dhe mentorim profesional për të rinjtë tanë. Ne besojmë se investimi në ta është investimi në të ardhmen tonë," tha Hajrizi. Hanns – Juergen Cassens, Drejtor i ITP-së, theksoi rëndësinë e kësaj shkolle në përgatitjen e të rinjve për sfidat dhe mundësitë e botës së biznesit dhe teknologjisë, duke shtuar se ky është një hap i madh drejt një shoqërie më të fuqishme dhe inovative.

Kryetari i Komunitetit të Prizrenit, Shaqir Totaj, përdori fjalë të rëndësishme dhe kësaj nisme për qytetin dhe komunitetin, shprehu vlerësimin e tij për projek-



tin, duke e cilësuar atë si një mundësi për të zhvilluar talentet dhe aftësitë ndërmarrëse të të rinjve të Kosovës. Besnik Skenderi, menaxher i projektit, shtoi se UBT Start Up School është një investim në të ardhmen e Kosovës, duke ofruar një platformë të nevojshme për zhvillimin e potencialit sipërmarrës tek të rinjtë dhe studentët e universitetit. Ceremonia e inaugurimit përfundoi me një sesion pyetjesh dhe përgjigjesh, ku u diskutua më tej rreth detajeve dhe planeve të shkollës së ndërmarrësisë, duke ofruar mundësi për të gjithë pjesëmarrësit për të marrë informacion mbi programin dhe për të kontribuar në rrugën e suksesit të UBT Start Up School.

Ky hap i madh shënon fillimin e një kapitulli të ri në historinë e zhvillimit të Kosovës, duke e nxitur potencialin dhe talentin e të rinjve në fushën e sipërmarrjes dhe inovacionit.

UBT dhe Sakarya University hapin Zyrën e Teknoparkut

"Kjo zyrë është një derë e re për ata që kanë pasion për inovacionin dhe teknologjinë. Ne jemi këtu për të ndihmuar ata që ëndërrojnë të bëhen liderë në këtë fushë," deklaroi rektori Hajrizi

Në një ditë të veçantë për teknologjinë dhe inovacionin në Kosovë, u hap zyrtarisht Zyra e Sakarya Teknokent në qytetin e bukur të Prizrenit. Ky hap është një arritje e madhe për UBT-në, e cila ka krijuar një mundësi të re për studentët dhe profesionistët për të kontribuar në fushën e teknologjisë dhe sipërmarrjes.

Ceremonia e hapjes u mbajt në Prizren nën koordinimin e Prof. Ass. Dr. Cengiz Çesko, drejtor i Institutit të Forenzikës, me të pranishëm nga institucionet shtetërore, akademike dhe përfaqësues të komunitetit të biznesit. Të pranishëm ishin gjithashtu Drejtori i Sakarya Teknopark, Yakup Köseoglu, Ministri i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka, dhe Konsulli i Përgjithshëm i Republikës së Turqisë, Celal Doğan. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi me Sakarya Teknokent dhe shprehu besimin se kjo zyrë do të hapë horizonte të reja për të rinjtë. "Kjo zyrë është një derë e re për ata që kanë pasion për inovacionin dhe teknologjinë. Ne jemi këtu për të ndihmuar ata që ëndërrojnë të bëhen liderë në këtë fushë," deklaroi Hajrizi, duke theksuar angazhimin e UBT-së për të mbështet-

ur zhvillimin e kapaciteteve të rinjve. Përfaqësuesit e Sakarya Teknokent nga Turqia, gjatë fjalës së tyre, nënvizuan marrëdhëniet e forta mes Kosovës dhe Turqisë. Ata theksuan se ky bashkëpunim është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të lidhjeve mes dy vendeve dhe një kontribut i vyer në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit.

Yakup Köseoglu, Drejtori i Sakarya Teknopark, shprehu entuziazmin e tij për hapjen e zyrës në Prizren, duke theksuar rëndësinë e këtij projekti në forcimin e lidhjeve mes Kosovës dhe Turqisë. Ai theksoi se kjo zyrë do të shërbejë si një qendër inovative, duke ofruar mbështetje për të rinjtë dhe profesionistët shqiptarë në zhvillimin e projekteve të tyre. "Jemi të gëzuar që po hapim këtë zyrë në Prizren, e cila do të shërbejë si një qendër inovative. Ky është një hap i rëndësishëm për forcimin e marrëdhënieve tona dhe për ndihmën që do t'i japim të rinjve dhe profesionistëve shqiptarë në zhvillimin e projekteve të tyre," tha Köseoglu. Fikrim Damka, Ministri i Zhvillimit Rajonal, u shpreh i nderuar që mori pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme. Ai theksoi rëndësinë e hapjes së Zyrës së Sakarya Teknokent në Prizren si

një hap të rëndësishëm për zhvillimin e inovacionit dhe teknologjisë në Kosovë.

"Ky bashkëpunim mes UBT-së dhe Sakarya Teknokent është një shembull i shkëlqyer i partneritetit strategjik që ndihmon në ndërtimin e një të ardhmeje më të ndritshme për të rinjtë tanë. Ne jemi këtu për të mbështetur çdo iniciativë që promovon teknologjinë dhe sipërmarrjen," tha Damka. Ai gjithashtu theksoi se investimet në arsim dhe teknologji janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. "Kjo zyrë do të ofrojë mundësi të reja për studentët dhe profesionistët tanë, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë ide dhe projekte që do të kontribuojnë në avancimin e ekonomisë sonë," përfundoi Damka.


Ky bashkëpunim pritet të sjellë përfitime të mëdha për të dy vendet, duke kontribuar në rritjen e qëndrueshme të rajonit dhe zhvillimin e një kulture inovative. Me hapjen e kësaj zyre, UBT dhe Sakarya Teknokent shprehin përkushtimin e tyre për të investuar në të ardhmen e teknologjisë dhe sipërmarrjes në Kosovë.

Vizita në Washington DC

Rektori Hajrizi takohet me Antony Righott, Ambasadorin Bushati, dhe Nada ZOHDY nga Fondacioni OBAMA

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i shoqëruar nga Edison Frangu – Drejtor Ekzekutiv i Open Gov Hub Albania, ka vazhduar vizitat e tij të suksesshme në Washington DC, duke zhvilluar një takim të rëndësishëm me Antony Righott nga Departamenti i Shtetit, zyrtar i programit në Zyrën e Programeve të Shkëmbimit Akademik të ECA-s. Në këtë takim, Rektori shprehu falënderimin e tij për Qeverinë Amerikane për përkrahjen e madhe në fushën e shkëmbimeve akademike, përmes bursave Fulbright dhe projekteve të tjera që kanë ndihmuar në zhvillimin e arsimit në Kosovë.

Ai gjithashtu u njoftua për mbështetjen e UBT-së në projekte të ndryshme që kanë impakt të lartë në zhvillimin e universitetit, duke përfshirë edhe ardhjen e ekspertëve specialistë përmes programit Fulbright dhe shkëmbimeve të stafit me universitetet në ShBA.



Rektori gjithashtu ndau me pjesëmarrësit iniciativat dhe bashkëpunimet e reja që janë duke u zhvilluar me universitete të ndryshme në ShBA, duke përfshirë vizitat e fundit në Universitetin e South Florida, bashkëpunimet me universitetet në IOWA dhe vizitat në Washington DC dhe Boston.

Rektori Hajrizi ka vazhduar serinë e takimeve të rëndësishme në Washington DC, duke përfshirë një vizitë të suksesshme në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë.

Gjatë kësaj vizite, Rektori u takua me Ambasadorin Ervin Bushati dhe stafin e tij, ku zhvilluan një bisedë të rëndësishme për bashkëpunimin mes universiteteve shqiptare dhe UBT-së.

Rektori i prezantoi Ambasadorit iniciativat dhe projektet e bashkëpunimit që janë në zhvillim midis UBT-së dhe Universiteteve në Shqipëri. Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt thellimit të

marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e arsimit dhe zhvillimit të dijes.

Rektori Hajrizi është takuar me Nada ZOHDY, Udhëheqësen e Rrjetit Global në Programet Globale të Fondacionit OBAMA.

Gjatë këtij takimi, ata diskutuan për të ardhmen dhe për mundësitë e bashkëpunimit në fusha të ndryshme. Rektori Hajrizi dhe Nada ZOHDY u pajtuan që të vazhdojnë bisedimet për të shfrytëzuar mundësitë dhe potencialin e Fondacionit OBAMA, me theks të veçantë në krijimin e lidershit të ri.

Rektori Hajrizi shprehu një falënderim të veçantë për Fondacionin OBAMA për kontributin dhe impaktin e tyre në promovimin e vlerave të larta për njerëzimin. Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt bashkëpunimit të thelluar dhe krijimit të projekteve inovative për të përbushur synimet e përbashkëta.

Rektori Hajrizi takon Tony Rodriguez, flasin për thellimin e bashkëpunimit në mes UBT-së dhe Open Gov Hub



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka vazhduar serinë e takimeve të rëndësishme në Washington DC, duke përfshirë një takim të suksesshëm me Tony Rodriguez, Drejtorin e Open Gov Hub.

Gjatë kësaj bisede konstruktive, u diskutua modeli i promovuar nga organizata në rrjetet e saj, duke përfshirë më shumë se 100 organizata të njohura në fushën e qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies.

Rektori Hajrizi dhe Drejtori Rodriguez shprehën dëshirën për të thelluar bashkëpunimin mes UBT-së dhe Open Gov Hub, duke përfshirë mundësinë e hapjes së një degë në Kosovë.

Përveç kësaj, gjatë vizitës, u zhvilluan takime me anëtarë të kësaj organizate, duke përfshirë edhe Open Government Partnership, e cila ka një rol të rëndësishëm në monitorimin e raporteve të Republikës së Kosovës në fushën e transparencës dhe llogaridhënies.

Rektori shfaqti interes për të përfshirë UBT-në në projekte dhe iniciativa të kësaj natyre, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për avancimin e arsimit dhe qeverisjes së mirë.

Vizita në BAU Atlantic University, promovimi i bashkëpunimit akademik dhe zhvillimi i fushave të ndryshme



Në vizitën e tij në Washington DC, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka zhvilluar një sërë

takimesh dhe bisedash të rëndësishme për të thelluar bashkëpunimin akademik dhe shkëmbimin e ideve në fusha të ndryshme.

Një nga momentet kyçe të vizitës ishte takimi në Universitetin BAU Atlantic University, ku u diskutua detajisht për perspektivat e bashkëpunimit në fushat e teknologjisë informative, shkencave politike dhe biznesit.

Gjithashtu, u theksua rëndësia e zhvillimit të publikimeve dhe aktiviteteve akademike të përbashkëta për të avancuar njohuritë dhe për të kontribuar në zhvillimin e arsimit dhe industrisë.

Rektori Hajrizi takoi konsullin e Kosovës në New York, Blerim Reka



Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në një akt solemn të cilin e përshkroi si një moment të veçantë për institucionin dhe për vendin, në emër të UBT-së ka nderuar me çmimin më të lartë institucional "Leadership Excellence Award", David Phillips.

Në këtë ceremoni të rëndësishme, e cila u zhvillua Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, u shfaq një atmosferë e ngrohtësisë dhe përkushtimit ndaj veprave të mëdha dhe ndikimit të tyre në shoqëri.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka zhvilluar një takim të rëndësishëm me Udhëheqësin e Konsullatës së Përgjithshme të Kosovës në New York, Blerim Reka. Në këtë takim, Rektori Hajrizi dhe udhëheqësi i Konsullatës Reka, kanë shqyrtuar thellësisht perspektivat e bashkëpunimit në fushën e arsimit, duke përfshirë strategjitë e përbashkëta për të përfunduar lidhjet akademike dhe shkencore.

Diskutimet e tyre janë përqendruar edhe në sfidat dhe mundësitë e ardhshme për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe për të thelluar bashkëpunimin në diplomaci. Takimi ka shënuar një moment të rëndësishëm në fortesën e lidhjeve ndërmjet institucioneve arsimore dhe diplomacive të dy vendeve.

Rektori Hajrizi zhvillon takime të rëndësishme në Florida - Promovon inovacionin dhe partneritetet ndërkombëtare në arsim



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka qëndruar në Florida, ku ka vizituar "University of South Florida", në qytetin e St. Petersburg dhe Tampa, dhe me këtë rast ka zhvilluar takime të rëndësishme me drejtuesit e këtij institucioni arsimor.

Përgjatë kësaj vizite, nën organizimin e Prof. Dr. Judithanne Scourfield McLauchlan, profesoreshë e asociuar e shkencave politike në Universitetin e

South Florida St. Petersburg, Rektori Hajrizi u takua me Rektorin e këtij Universiteti, ku diskutuan për mundësinë e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e praktikave të mira në mes dy institucioneve. Rektori Hajrizi ka vizituar dhe çarkun e inovacionit në qytetin e St. Petersburgut, ku ka diskutuar për mundësinë e shkëmbimit të praktikave midis qytetit dhe UBT Smart City. Në vijim, ka zhvilluar takime të

rëndësishme edhe në Shkollën e Studimeve Ndërkombëtare, ku ka synuar të harmonizojë aktivitetet e ardhshme brenda kornizës së bashkëpunimit universitar. Diskutimet me Drejtoreshën e Partneritetit Global u përqendruan në projekte të përbashkëta që përfshijnë studentët dhe staf të të dy universiteteve.

Në një prezantim në bibliotekën moderne të Universitetit, Rektori Hajrizi paraqiti modelin e UBT Smart City dhe qasjen e tij inovative në arsim në Kosovë dhe rajon. Rektori takoi studentët shqiptarë në këtë universitet, duke nxitur lidhjet dhe mundësitë e shkëmbimit të ideve.

Vizita e Rektorit Hajrizi në Florida nënvizon angazhimin e UBT-së në nxitjen e partneriteteve ndërkombëtare dhe inovacionit në arsim.

UBT nderon David Phillips me çmimin më të lartë institucional "Leadership Excellence Award"



fusha, sidomos në politikën ndërkombëtare dhe në promovimin e vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut.

Në falën e tij të mbajtur në ceremoninë e ndarjes së çmimit, Phillips shprehu falënderimin e tij për nderimin e UBT-së ndaj veprës së tij, duke e quajtur atë një nder i madh dhe një përkujtim të rëndësishëm për përpjekjet e tij të gjata dhe të palodhshme. Ai theksoi se amerikanët nuk kanë patur kurrë miq më të mirë se shqiptarët.

Rektori Hajrizi zhvillon një vizitë zyrtare në Federatën Pan-Shqiptare të Amerikës "Vatra"



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Federatën Pan-Shqiptare të Amerikës "Vatra".

Rektori Hajrizi u prit nga kryetari i Vatrës, Elmi Berisha, anëtarë të kryesisë, Ilir Cubi, anëtarë të këshillit të Vatrës, Anton Raja, Dritan Haxhia, Editori i Gazetës "Dielli" dhe gazetari Halil Mula. Në takim mori pjesë dhe Naim Dedushaj kryetari i Rrjetit të Bizneseve të Diasporës.

Në fjalën e mirëseardhjes kryetari i Vatrës, Elmi Berisha vlerësoi punën e shkëlqyer të Rektorit Hajrizi, të stafit akademik në UBT, kërkim-

in shkencor, metodat inovative të mësimdhënies dhe infrastrukturën moderne në kampuset universitare. "Nga UBT ka përfutur e gjithë Kosova. UBT është një universitet i shkëlqyer në të gjithë hapësirën shqipfolëse në Ballkanin Perëndimor. Ju jam mirënjohës për bashkëpunimin e veçantë në festimin e 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës dhe sidomos respektin ndaj legjendës së shqiptarizmit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Jim Xhema. Vatra është satelit i kombit dhe i të mirës së shqiptarëve në Amerikë", ka potencuar Berisha.

Më tej ai ekspozoi punën e Vatrës në Uashington dhe përpjekjet për transmetimin e atdhetarizmit të gjeneratave të reja shqiptare në Amerikë.

Në fjalën e tij, Rektori Hajrizi falënderoi Vatrën për bashkëpunimin dhe pritjen e ngrohtë dhe bashkëpunimin e 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës në Prishtinë. "Pa Vatrën e diasporën shqiptare në Amerikë ne s'do e kishim lirinë. UBT ka interes për ndërtimin e qendrës për studimet shqiptaro-amerikane për të njohur kontributin politik, ekonomik dhe patriotik të diasporës shqiptare në Amerikë dhe kontributorëve të tjerë. Synojmë gjithashtu të themelojmë një qendër serioze për studimet amerikane për të njohur aspektet e thelluara, si, aspekte politike, ekonomike, kulturore e diplomatike", është shprehur Rektori Hajrizi.

Gjatë takimit të ngrohtë e vëllazëror u diskutua për vazhdimin e bashkëpunimit me diasporën shqiptare në Amerikë, ku Vatra ka rolin kryesor në të gjitha proceset patriotike në mërgatën shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Rektori Hajrizi takon atdhetarin dhe veprimtarin e shquar për çështjen kombëtare, Jim Xhema



Në vazhdim të vizitave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i shoqëruar nga kryetari i Federatës Pan-shqiptare në Amerikë "Vatra", Elmi Berisha, gazetari Halil Mula dhe kryetari i Rrjetit të Bizneseve të Diasporës, Naim Dedushaj, ka vizituar lobuesin për çështjen shqiptare në Amerikë dhe atdhetarin e shquar, Jim Xhema.

Në këtë takim, Jim Xhema përsëriti qëndrimin e tij për rëndësinë e edukimit për një të ardhme të qëndrueshme dhe në të mirë të Kosovës dhe shqiptarëve në përgjithësi. Po

ashtu, potencoi rolin dhe kontributin e vazhdueshëm të ShBA-ve dhe marrëdhëniet miqësore në mes shqiptarëve dhe amerikanëve, teksa shprehu gatishmërinë e tij për të vazhduar kontributin në këtë aspekt. Në anën tjetër, Rektori Hajrizi e njoftoi për zhvillimet në UBT, në Kosovë, si dhe e falënderoi shumë për kontributin e pazëvendësueshëm që Jim Xhema ka dhënë për lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës dhe për kontributin që po jep në avancimin dhe edukimin e të rinjve dhe ngritjen e talentëve.

Rektori Hajrizi priti në takim përfaqësuesit e kompanisë amerikane XponentL Data



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i shoqëruar nga Dekani i Fakultetit Shkencë Kompjuterike dhe Inxhinieri, Prof. Besnik Qehaja dhe Drejtori i Institutit për Studime Urbane në UBT, Shqiprim Ahmeti, priti në takim përfaqësuesit e kompanisë amerikane XponentL Data, Tom Johnstone, Matt Arellano dhe Drilon Jaha.

Në këtë takim, Rektori Hajrizi dhe përfaqësuesit e kompanisë XponentL

Data diskutuan rreth bashkëpunimit për inteligjencën artificiale, integritetin të AVR dhe AI, gjenerimit të vendeve të reja të punës, si dhe eksplorimit të mundësive për bursa për studentët e orientuar në AI. Ky takim shënoi një hap të rëndësishëm drejt një bashkëpunimi të ngushtë dhe të frytshëm, duke hapur rrugën për zhvillime të reja inovative dhe mundësi të reja për të gjithë pjesëmarrësit.

Vizita zyrtare në Gjakovë: Bashkëpunimet dhe projektet e UBT-së në fokus



Me ftesë nga kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, dhe me organizimin e profesorit Fuat Pallaska nga UBT, me përfaqësim të lartë nga ana e Rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Pro-rektorit Prof. Dr. Binak Beqaj dhe Dekanit të Fakultetit të Ndërtimit dhe Infrastrukturës, Prof. Visar Krelani, është realizuar një vizitë zyrtare në këtë komunë.

Në takimin e parë delegacioni nga UBT u mirëpritën nga kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini dhe përfaqësuesit të institucioneve të qytetit, dhe me këtë rast u bë një rezymë mbi të ariturat e fundit, projektet dhe planifikimi i realizimit të tyre, duke përfshirë projektet vitale të këtij qyteti. Rektori Hajrizi prezantoi mundësitë

që UBT mund të ofrojë për ndihmë në këtë komunë, si me Institucionin e Planifikimit Urban dhe fakultetet e ndryshme që mund të përmirësojnë punën e kësaj komune duke përfutur të dyja palët. Koordinimi u realizua duke planifikuar një takim të afërt edhe nga Kryetari Gjini në Kampusin e UBT-së.

Vizita e dytë u bë me Ngrrohtorja e Qytetit të Gjakovës, e përfunduar në vitin 2021, e cila paraqet një projekt vital me teknologji unike në Ballkan dhe aplikim të Biomases ose Copëzave të drunjve si mbeturina të prodhimit.

Në këtë takim u prezantuan në detaje idetë dhe projektet për të ardhmen nga Drejtori i Ngrrohtores, Blerim

Halilaj dhe stafi i kësaj Kompanie, ndërsa u realizua edhe një vizitë e detajuar në të gjitha kaldajat dhe pjesët përbërëse të Ngrrohtores.

Vizita pasoi edhe tek projekti tjetër vital, i cili tashmë është në përdorim si Trajtimi i Ujërave në Gjakovë. Edhe në këtë objekt, përfaqësuesit e UBT-së u pritën nga Drejtori i Trajtimit të Ujërave, Visar Hasi me stafin e tij. Po ashtu u dhanë shpjegime nga Fjolla Laskaj, e cila në detaje shpjegoi procesin deri tek arritja e pastrimit të ujit dhe derdhja e tij në lumin Erenik në gjendje shumë të mirë dhe të pastër. Përfaqësuesit nga UBT vizituan në detaje secilën pjesë të fabrikës dhe u propozua të realizohet një memorandum bashkëpunimi për këtë fushë me rëndësi, ku përfshihen Ndërtimtaria, Kimia dhe Mjedisit, së bashku me Inxhinierinë e Energjisë, Mekanikën dhe Shkencat Kompjuterike. Një vizitë tjetër u realizua edhe në Kompaninë KOBE, ku drejtori i kësaj kompanie, Zenun prezantoi produktet e tij unike në Kosovë.

Fryma e takimeve ishte shumë pozitive dhe në këtë mënyrë do të vazhdohet drejt realizimit të bashkëpunimeve dhe projekteve të përbashkëta në të mirë të komunitetit, studentëve dhe institucioneve përkatëse.

Rektori Hajrizi vizitoi İstanbul Ticaret Üniversitesi



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka qëndruar për vizitë në İstanbul Ticaret Üniversitesi, ku u takua

me Rektorin Prof. Dr. Abdulhamit Avşar. Qëllimi i kësaj vizite ishte diskutimi i modeleve të reja të bashkëpunimit mes dy universiteteve, bazuar në marrëveshjen e zbatuar vitet e fundit në mes UBT-së dhe İstanbul Ticaret Üniversitesi. Rektori Hajrizi ka theksuar se si dy universitete mund të ofrojnë një perspektivë akademike që do të kontribuojnë në zhvillimin e fushave të ndryshme në dy vendet Kosovë dhe Turqi. Ndërsa, Rektori Avşar ka potencuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve dhe tha se si universiteti i kushtojnë rëndësi zhvillimit të modeleve të bashkëpunimit me rezultate konkrete në periudhën e re.

Rektori i Universitetit të Salentos në Lecce, Fabio Pollice, së bashku me një delegacion nga ky institucion vizitojnë UBT-në

Vizita e Rektorit të Universitetit të Salentos në Lecce, Fabio Pollice, së bashku me profesorët dhe studentët e këtij institucioni, në UBT, ishte një ngjarje e rëndësishme për të dyja universitetet dhe për bashkëpunimin ndërmjet tyre.

Ata u mirëpritën me entuziazëm në Parkun Shkencor Inovativ në Lipjan, nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Ed-



mond Hajrizi, dhe stafi akademik. Gjatë kësaj vizite, u krijua një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e ideve, përvojave dhe projek-

teve në fushën e arsimit të lartë dhe shkencës. Rektori Pollice dhe delegacioni i tij patën mundësinë të njihen me infrastrukturën dhe projektet e inovacionit në UBT, duke eksploruar mundësitë e bashkëpunimit të ardhshëm në fusha të ndryshme akademike dhe shkencore.

Kjo vizitë jo vetëm që thellon marrëdhëniet midis UBT-së dhe Universitetit të Salentos, por gjithashtu hap rrugën për projekte të përbashkëta dhe shkëmbime të mëtejshme në të ardhmen. Ajo shënon një hap të rëndësishëm drejt një bashkëpunimi të vazhdueshëm dhe të suksesshëm mes dy institucioneve akademike.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Trakya Üniversitesi në Turqi

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi është takuar me Rektorin e Trakya Üniversitesi në Turqi, Dr. Erhan Tabakoğlu, dhe me këtë rast kanë nënshkruar marrëveshje bash-

këpunimi ndërmjet dy institucioneve.

Në takimin e realizuar. Rektori Hajrizi dhe Rektori Tabakoğlu diskutuan edhe për projekte konkrete të



përbashkëta në fusha të ndryshme, me qëllim që të hapin mundësi të reja për të rinjtë e të dy vendeve.

Në vazhdim të vizitës së tij në Turqi, Rektori Hajrizi ka vizituar edhe laboratore të ndryshme, qendra të inovacionit dhe shkolla.

UBT dhe Universiteti i Stambollit - Cerrahpaşa nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe Rektori i Universitetit të Stambollit – Cerrahpaşa, Prof. Dr. Nuri Aydın, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, në të cilën

do të përfshihen koordinimi në fusha të ndryshme, shkëmbimi i studentëve, programet kurrikulare dhe kërkime të përbashkëta shkencore. Para ceremonisë së nënshkrimit të

mbajtur në Rektoratin e Kampusit Avclar, u mbajt një takim për të diskutuar mbi bashkëpunimin mes dy institucioneve.

Rektori Hajrizi mori pjesë edhe në ceremoninë e vendosjes së gurthemelit të Fakultetit të Inxhinierisë së sapokrijuar me ftesë të Rektorit Aydın.

Bashkëpunimi i dy institucioneve do të përqendrohet në aktivitetet arsimore dhe kërkimore, kurrikulat e përbashkëta dhe aktivitetet e projekteve si shkolla verore, botimet akademike dhe shkencore, si dhe organizimi i konferencave dhe simpoziumeve.

Rektori Hajrizi vizitoi ENTERTECH në Turqi



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi po qëndron për vizitë në Turqi, me këtë rast ka vizituar ENTERTECH të themeluar në Universitetin e Stambollit – Cerrahpaşa. Me organizim nga drejtori i ENTERTECH, Dr. Muhammed Kasapoğlu, Rektori Hajrizi vizitoi kompanitë e

krijara dhe mori informacione për aktivitetet e tyre.

Kjo vizitë shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e lidhjeve ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe sektorit të biznesit, duke sjellë mundësi për bashkëpunim dhe zhvillim të ardhshëm.

Rektori Hajrizi ishte i ftuar në një darkë pune nga Ambasadori i Japonisë në Kosovë



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ishte i ftuar në një darkë pune, e organizuar nga Ambasada e Japonisë në Kosovë, në mesin e të cilëve kishte edhe përfaqësues të kompanive të ndryshme japoneze. Ky takim shërbeu si një hap i rëndësishëm drejt krijimit të lidhjeve të forta dhe të qëndrueshme midis insti-

tucioneve dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Përfaqësuesit japonezë dhe Rektori Hajrizi shkëmbyen pikëpamjet dhe ndjenjat pozitive rreth bashkëpunimit të mundshëm në të ardhmen, duke shtuar vlerën e një dialogu të hapur dhe të ndërgjegjshëm.

UBT i vetmi institucion në rajon që zbaton Net 0 Energy



Parku Shkencor Inovativ i UBT-së është i pari dhe i vetmi kampus në rajon që ka të integruar Net 0 Energy, përmes së cilës kombinohet eficientia e energjisë dhe prodhimi i energjisë së ripërtitshme, tha Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi në Forumin për Investime të Qëndrueshme të organizuar nga

Këshilli i Investitorëve Evropianë. “Net 0 Energy Campus” do të mundësojë konsumimin e energjisë për aq sa prodhohet në vend nëpërmjet burimeve të ripërtitshme, në këtë rast pan-elëve solar, pa pasur nevojë që të shfrytëzojë ndonjë burim tjetër të energjisë.

“Ky sistem i ri i energjisë, i gërshtuar me teknologjinë më të fundit që ka në dispozicion UBT, është një inovacion që ndihmon jashtëzakonisht shumë në efikasitetin, qëndrueshmërinë dhe produktivitetin në mësim dhe punë”, tha Rektori Hajrizi.

Në panelin me temë: “Mobilizimi i kapitalit publik dhe privat për të përshpejtuar investimet e qëndrueshme”, Rektori Hajrizi tregoi se UBT ka të akredituara programe dhe po nxjerr kuadro të cilët janë në gjendje të menaxhojnë tregjet e reja të energjisë në përputhje me nevojat shoqërore të këtij profili. Studentët në këtë institucion përfitojnë edukim cilësor në këtë fushë, po këta studentë kanë perspektivë në tregun e punës.

Delegacioni i UBT-së mori pjesë në përfaqësimin e përvitshëm të Kosovës në mbledhjen e AESOP-it

Delegacioni i UBT-së për vizitë treditore në Venedik të Italisë: Përfaqëson Kosovën në AESOP shpalos vizionin dhe modelin e Qytetit të Mençur të UBT-së dhe rolin e saj në edukimin interdisiplinor, ngrit bashkëpunimet ndërkombëtare në fushën e urbanizimit dhe po ashtu viziton Institucione Kulturorë dhe mbanë takime me përfaqësues nga kultura dhe biznesi, duke shfaqur identitetin shqiptar në arenën ndërkombëtare.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, së bashku me Drejtoreshën Fisnetë Hajrizi dhe Prorektorin dhe Dekanin e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Binak



Beqaj, qëndruan në Venedik të Italisë, për të realizuar një sërë vizitash të rëndësishme.

Delegacioni i UBT-së nën udhëheqjen e Rektorit mori pjesë në përfaqësimin e përvitshëm të Kosovës në mbledhjen e Asociacionit të Shkollave Evropiane për Planifikimin Urban AESOP. Duke marrë pjesë aktive në debat lidhur me interdisiplinaret, Rektori Hajrizi prezantoi modelin e Qytetit të Mençur të UBT-së si model inovativ për interdisiplinaret dhe ekosistemin inovativ dhe teknologjik.

Në kuadër të takimit në AESOP, delegacioni u takua me Presidentin e AESOP, Prof. Thomas Dlinger,

me Sekretarin e AESOP, Prof. Giancarlo Cotella, si dhe me shumë dekanë dhe udhëheqës të shkollave të arkitekturës dhe planifikimit urban dhe universiteteve nga shumë vende evropiane, si: Italia, Austria, Gjermania, Portugalia, Finlanda, Turqia, Polonia, Sllovakia, ku u shpreh gatishmëria e dyanshme për bashkëpunim. Në këtë takim u paraqit dhe kërkesa dhe gatishmëria nga UBT për organizimin e takimit të radhës AESOP Head of Schools dhe Konferencës në vitet në vijim në Kosovë me konkretisht në Parkun Shkencor dhe Inovativ të UBT-së, e cila u mirëprit shumë mirë nga pjesëmarrësit.

Rektori Hajrizi takohet me Kryetarin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i shoqëruar nga dekanin e Fakultetit Shkencë të Sportit dhe të Lëvizjes, Agron Thaqi, është takuar me kryetarin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, si dhe me Fitim Arifi dhe Diellza Kelmendi nga Akademia Olimpikë.

Në kuadër të këtij takimi, Rektori Hajrizi dhe Kryetari Krasniqi kanë diskutuar për një sërë çështjesh që ndërlidhen me sportin, shëndetin, aktivitetet e të dy institucioneve, konferencat rreth fushës sportive, si dhe

rreth mundësisë së bashkëpunimit institucional. Në këtë takim u ritheksua nevoja për të punuar dhe angazhuar më shumë për të ngritur vetëdijen rreth edukimit sportiv, shëndetit dhe aktivitetit fizik.

UBT përmes programit në nivelin bachelor Shkencë të Sportit dhe të Lëvizjes dhe në nivelin master Shëndeti dhe Aktiviteti Fizik, synon të formojë profesionistë shumë të kualifikuar të sportit në gjendje të plotësojnë nevojat në rritje të tregut të punës në një perspektivë evropiane.

Drejtuës të UBT vizituan Muzeun e Venedikut “Museo Correr”

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, së bashku me Drejtoreshën Fisnetë Hajrizi dhe Prorektorin dhe Dekanin e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Binak Beqaj, qëndruan në Venedik të Italisë, për të realizuar një sërë vizitash të rëndësishme.

Në vazhden e aktivitetëve në Venedik, përfaqësuesit nga UBT vizituan Muzeun e Venedikut “Museo Correr”, nën organizimin e Prof. Lucia Nadin, ku u mirëpritën nga stafi i Muzeut të cilët i njoftuan për punën dhe grumbullimin e dokumenteve të rëndësishme për shqiptarët, për personalitetin dhe veprimtarinë e Karl Gega-s dhe shumë dokumente të tjera



të rëndësishme të realizuara me një punë të gjatë të profesoreshës Nadin, e që priten të prezantohen edhe me një

kontribut të shtuar të UBT-së, të përfaqësuesve të shqiptarëve të diasporës, dhe arbëreshëve të Italisë.

Rektori i UBT-së diskuton për zhvillimin urban me kryetarin e Bashkisë së Shkodrës, Benet Beci

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, së bashku me prorektorin Binak Beqaj dhe drejtorin e Institutit për Studime Urbane, Shqiprim Ahmeti, kanë qëndruar në Shkodër për një takim të rëndësishëm me kryetarin e Bashkisë, Benet Beci.

Në këtë takim, Rektori Hajrizi dhe Kryetari Beci kanë diskutuar rreth projekteve në fushën e zhvillimit lokal të mençur dhe të qëndrueshëm. Diskutimet u fokusuan në iniciativat që mund të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës

urbane, përfshirë planifikimin urban, infrastrukturën dhe sigurinë. Ky takim u shënuar si një hap i rëndësishëm drejt bashkëpunimit për të arritur qëllimet e përbashkëta në avancimin e qëndrueshmërisë në komunitetin lokal.

UBT ndan çmimin më të lartë institucional për Rektorin e Trakya Üniversitesi, Prof. Dr. Erhan Tabakoğlu dhe bën hapjen e Teknoparkut Ndërkombëtar

Në praninë e Rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Rektorit të Trakya Üniversitesi, Prof. Dr. Erhan Tabakoğlu, Ambasadorit të Turqisë në Kosovë, Tunç Angılı, Ministrit për Zhvillim Rajonal në Qeverinë e Kosovës, Fikrim Damka, në Qytetin e Mençur të UBT-së në Lipjan, u mbajt ceremonia e nënshkrimit dhe hapjes së Teknoparkut më të madh në rajon "UBT & Trakya University International Technopark", si dhe ceremonia e veçantë e ndarjes së çmimit më të lartë institucional "Leadership Excellence Award" për Prof. Dr. Erhan Tabakoğlu.

Në fjalën e tij, Rektori Hajrizi në emër të UBT-së, falënderoi për kontributin e jashtëzakonshëm në afirmimin, konsolidimin e vlerave, standardeve, si dhe lidhshirësinë e treguar në promovimin dhe integrimin e universiteteve të Ballkanit. "Kemi kënaqësinë që në një ceremoni të veçantë, në emër të UBT-së, të ndajmë çmimin më të lartë institucional për Rektorin e Universitetit Trakya, Prof. Dr. Erhan Tabakoğlu, për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në afirmimin, konsolidimin e vlerave, standardeve, si dhe lider-



shipin e treguar në promovimin dhe integrimin e universiteteve të Ballkanit", ka thënë Rektori Hajrizi.

Rektori Tabakoğlu falënderoi Rektorin Hajrizi për ndarjen e këtij çmimi, duke theksuar se, ndër të gjitha çmimet që ka marrë, ky çmim është më i rëndësishmi për të. Ai theksoi se, nga ky moment, Rektori Hajrizi është vëllai i tij, ndërsa UBT dhe Universiteti Trakya janë vëllazëruar.

"Falënderoi Rektorin Edmond Ha-

jrizi për ndarjen e këtij çmimi. Kam marr shumë çmime, por ky çmim është më i rëndësishmi. Nga sot profesori Edmond është vëllai im. Njëkohësisht, UBT është vëllazëruar me Universitetin Trakya. Hapja e teknoparkut është një lloj lloje, sepse çdo minut mund të ndodh një çmim i madh. Sepse, kemi të rinjtë që mund të vijnë këtu dhe të japin ide dhe të realizojnë eksperimente të reja. Një ide e vlefshme nga ky vend mund të ndërrojë fatin

e shtetit. Pas këtij çmimi e llogarisë edhe unë veten si një njeri i Kosovës. Rroftë gjatë vëllazërisë mes Kosovës dhe Turqisë", është shprehur Rektori Tabakoğlu.

Ambasadori Angılı shpreh mendimin se bashkëpunimi midis Turqisë dhe Kosovës në fushën e teknologjisë dhe shkencës është një hap i rëndësishëm. Përfaqësuesit e institucioneve akademike dhe start-up-ëve nga të dy vendet po thellojnë bashkëpunimin e tyre, duke krijuar një situatë të përfitimit për të gjithë. "Ne jetojmë në një botë ku forcat ekonomike rajonale luajnë një rol po aq themelor sa forcat ekonomike globale në zinxhirët e furnizimit global. Kjo situatë parandalon që teknologjia të jetë vetëm në dorë të një grupi të vogël. Prandaj, është një hap jashtëzakonisht korrekt, që bashkëpunimin mes Turqisë dhe Kosovës t'i shtohet teknologjia dhe shkencën. Ndërsa, institucionet akademike, start-up-et e Turqisë dhe Kosovës thellojnë bashkëpunimin e tyre, kjo do të krijojë një rezultat "win-win" për të gjithë", tha Ambasadori Angılı.

Ministri Damka nënvizoi se kjo marrëveshje sjell përfitime të shum-

ta për të dy institucionet. Ai tha se përveç këmbimit të njohurive dhe përvojave akademike, ajo gjithashtu hap rrugën për zhvillimin e programeve të përbashkëta të punës dhe hulumtimit në fushat e inxhinierisë, teknologjisë informative, shkencës kompjuterike dhe të tjera. "Kjo marrëveshje sjell përparësi të shumta për të dy institucionet. Përveç shkëmbimit të njohurive dhe përvojave akademike, ajo gjithashtu do të mundësojë zhvillimin e programeve të përbashkëta të punës dhe hulumtimit në fushat e inxhinierisë, teknologjisë informative, shkencës kompjuterike dhe shumë të tjera. Në Kosovë, hulumtimi dhe inovacioni po bëhen gjithnjë e më tërheqës. Investimet në teknoparqe po rriten, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për start-up-et, kompani të reja dhe kërkime shkencore. Në të njëjtën kohë, Turqia ka një histori të suksesshme në zhvillimin e teknoparqeve dhe mbështetjen e inovacionit dhe biznesit teknologjik. Shtimi i një teknoparku do të krijojë një mjedis inkurajues për inovacionin dhe zhvillimin e re teknologjik në Kosovë dhe në rajon", potencoi Ministri Damka.

UBT do t'i edukojë 200 persona në vit për inteligjencë artificiale përmes projektit të fituar nga Fondi Rajonal i Sfidave (RCF)



Në mesin e pesë kompanive, UBT është përfituese e projektit për arsim dhe aftësim profesional nga Fondi Rajonal i Sfidave (RCF). Rreth 200 persona në vit do të edukohen për inteligjencë artificiale, dhe kjo është

një mundësi unike për t'u bërë të gatshëm për tregun e punës.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka thënë se ky projekt do të rritë kuadrin e punës për investime të huaja për punësim. Ai tha se ideja e projektit është që të ndërlihd praktikë, punësim dhe shkollim.

"Kemi fituar një projekt të Bankës Gjermane për zhvillim dhe Qeverisë Zvicerane që lidhet me kompetencat. Lidhet me përkrahjen e kompetencave profesionale në fushën e IT-së në pjesën e inteligjencës artificiale në zhvillim. Është një fushë që mbështet vendet e punës të së ardhmes dhe në bazë të kësaj do të punojmë të hapim një sektor

të bashkëpunimit me industrinë në nivelin e pestë të arsimit profesional. Do të krijojmë kuadrot dhe do të rrisim sa më shumë mundësi për investime të huaja po edhe për punësim. Ky projekt në bashkëpunim me industrinë dhe pjesën e edukimit është një projekt shumë i mirë për të lidhur ngushtë akademinë. Së pari, të rinjtë do të marrin diplomat për këtë fushë dhe ideja është që ata të punësohen menjëherë, sapo të fillojnë shkollimin dhe punësimin dhe të bëhet një lloj paralelizmi, praktikë, punësim dhe shkollim. Kemi menduar rreth 200 persona në vit dhe ky projekt do të rritet edhe në universitet", tha Rektori Hajrizi.

Rektori Hajrizi në Aleancën e universiteteve evropiane "EU4Dual" në Malta

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi po merr pjesë si anëtar i Bordit Këshillëdhënës industrial në Aleancën më të madhe të Universiteteve evropiane për edukimin dual "EU4Dual", në Malta.

Pjesëmarrja e Rektorit Hajrizi shënon një hap të rëndësishëm drejt përfshirjes së UBT-së në një forum të rëndësishëm evropian në fushën e arsimit dual. Rektori Hajrizi, me pjesëmarrjen e tij në Bordin Këshillëdhënës industrial të kësaj aleance, do të ketë mundësinë për të shprehur vizionin dhe qëllimet e UBT-së për zhvillimin e arsimit dual dhe për të ndikuar në

hartimin e politikave dhe strategjive në nivel evropian në këtë fushë. UBT ka mundësinë për të kontribuar në zhvillimin e këtyre praktikave dhe për të marrë nga përvoja dhe ekspertiza e institucioneve të tjera partnere në këtë aleancë.

Aleanca EU4Dual përbëhet nga 9 nga institucionet kryesore universitare të dyfishta në Evropë, të cilat ndajnë një filozofi të përbashkët për marrëdhëniet midis studentëve, universitetit dhe botës së punës.

Rektori Hajrizi në festën për 104-vjetorin e themelimit të UNWE-s - takohet me Rektorin e këtij institucioni



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në rastin e Festës së 104-vjetorit të themelimit të Universitetit Ndërkombëtar të Ekonomisë (University of National and World Economy (UNWE/YHCC)), në Sofia të Bullgarisë.

Me këtë rast, Rektori Hajrizi takoi Rektorin e UNWE-s, Prof. Dr. Dimitar Dimitrov, me të cilin diskutoi për projektet e reja dhe diplomat e përbashkëta, si dhe për fillimin e realizimit të programit Erasmus+ ndërmyjet dy institucioneve, i cili

është aprovuar të financohet nga Bashkimi Evropian.

Gjatë ceremonisë, Rektori së bashku me bashkëpunorët e tij, Dekani i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Prof. Muhamet Gërvalla dhe Prof. Bekim Marmullaku, realizuan edhe takime me përfaqësues të Qendrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar, dekanë, profesorë të universitetit, si dhe me Maxim Behar, kryetarin e Bordit të Universitetit dhe një mik të madh të Kosovës.

Rektori Hajrizi dhe ekipi i UBT-së po marrin pjesë në Javën Ndërkombëtare të Erasmus+ dhe CEEPUS



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i shoqëruar nga Elinda Krasniqi, Lirigzona Morina, Besnik Qehaja, Blerim Zylfiu, Lavdim Menxhiqi, Armend Ymeri, Bekim Marmullaku dhe Muhamet Gërvalla, po merr pjesë në Javën Ndërkombëtare të Erasmus+ dhe CEEPUS që

po mbahet në "Technical University" në Sofia të Bullgarisë.

Kjo ngjarje, e cila mbledh së bashku akademikë dhe profesionistë nga e gjithë Evropa, ka për qëllim promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në arsim dhe kërkime shkencore.

Gjatë kësaj ngjarje, Rektori Hajrizi mbajti një prezantim rreth temës "UBT as a Small Scale Smart City". Ai ndau me të pranishmit vizionin dhe përvojat e UBT-së në krijimin e një qyteti të zgjuar, ku teknologjitë inovative përdoren për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe efikasitetin operativ.

Ndërsa, Dekani i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Besnik Qehaja, prezantoi rreth temës "IoT Deployment in UBT Campus".

Në prezantimin e tij, Qehaja shpjegoi se si UBT ka integruar teknologjinë e IoT. Ai përkthoi aplikimet praktike të IoT në kampus, duke përfshirë monitorimin në kohë reale të infrastrukturës, sistemet e automatizuara të menaxhimit të ndërtesave, dhe zgjidhjet e avancuara për sigurinë dhe mirëqenien e studentëve dhe stafit.

Rektori Hajrizi në Konferencën Evropiane të Arsimit të Lartë EU4Dual në Malta

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi në kuadër të promovimit të zhvillimit të arsimit të lartë në nivelin evropian, mori pjesë me një prezantim të shquar në edicionin e parë të Konferencës Evropiane të Arsimit të Lartë të Dyfishtë EU4Dual, e cila po mbahet në Malta.

Rektori Hajrizi ishte panelist në sesionin "Industry and regional stakeholders track", ku u trajtua tema e

Transformimit Digjital dhe Arsimit Dual.

Në fjalën e tij, Rektori Hajrizi në veçanti theksoi se e ardhmja e njeriut do të jetë pozitive, por që kërkohet një bashkëpunim më i mirë ndërmjet teknologjisë dhe njeriut, duke qenë çdo herë në bazë vlerat humane për zhvillim.

Diskutimi i gjerë u përqendrua në sfidat dhe mundësitë e trans-



formimit digjital në arsimin e lartë, duke theksuar rëndësinë e përshtatjes së programit të arsimit dual me kërkesat e tregut të punës.

Pasqyrimi i përvojave dhe strategjive inovative të UBT-së në përputhje me këto kërkesa të arsimit të lartë tregoi përkushtimin e vazhdueshëm të institucionit ndaj çështjeve të zhvillimit të arsimit në një kontekst global.

Konferenca e Ekosistemit Inovativ

Në këtë ngjarje morën pjesë: Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, kryetari i Bashkisë së Shën Mitër Koronës (San Demetrio Corone), njëherit kryetar i Fondacionit të Institutit Rajonal të Komunitetit Arbëresh të Kalabrisë, Ernesto Madeo, kryetari i Federatës Pan-shqiptare "Vatra", Elmi Berisha, Presidenti i Shoqatës "Korabi" nga Italia, Genc Podgorica, arkitekti, Gjon Radovani dhe ish-presidenti i Interportos dhe Acer-it, Dr. Alessandro Alberani

Në një ceremoni solemne, në Qytetin e Mençur të UBT-së, në Lipjan, u zhvillua Konferenca e Ekosistemit Inovativ (Under the Jim Xhema Highland), e cila mbledhi shqiptarë nga Amerika, arbëreshë të Italisë, studiues nga Austria, profesorë Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, si dhe profesorë dhe studentë të UBT-së.

Në këtë ngjarje morën pjesë: Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, kryetari i Bashkisë së Shën Mitër Koronës (San Demetrio Corone), njëherit kryetar i Fondacionit të Institutit Rajonal të Komunitetit Arbëresh të Kalabrisë, Ernesto Madeo, kryetari i Federatës Pan-shqiptare "Vatra", Elmi Berisha, Presidenti i Shoqatës "Korabi" nga Italia, Genc Podgorica, arkitekti, Gjon Radovani dhe ish-presidenti i Interportos dhe Acer-it, Dr. Alessandro Alberani.

Në fjalën e tij, Rektori Hajrizi falënderoi të pranishmit, si dhe i uroi ata për 16-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës. Ai tha se kjo është një ditë e veçantë dhe na bën të reflektojmë për të qenë të bashkuar në ndërtimin e një vizioni për të ardhmen.

"Bashkëpunimi ndërmjet nesh është me të vërtetë një arritje e mirë dhe për t'u vlerësuar. Faleminderit shumë për kontributin tuaj dhe për energjinë, dhe jeni një model i mirë për ne për t'u ndjekur. Me të vërtetë arbëreshëve iu desh të largohen vite më parë nga Shqipëria dhe Kosova, meqenëse siç e dimë këto dy vende



gjitmonë kanë kaluar në periudha të vështira. Por, kjo neve sot na bën më të fortë dhe më të bashkuar për të ndërtuar të ardhmen tonë, në një zonë mjaftë të mirë", ka thënë Rektori Hajrizi. Dr. Ernesto Madeo tha se Arbëria i ka dhënë frymëzimin dhe shpirtin autorit tonë të madh, Jeronim de Rades. Ai tha se është detyrim të ndërveprohet edhe me universitetet dhe të krijojmë hapësira për studentët e interesuar për studimet italiane, arbëreshe dhe shqiptare.

"Dy presidentët, nga Kosova dhe Shqipëria, gjatë vizitës së tyre në Kalabri, shprehën gatishmëri për të bashkëpunuar. Një popull, një histori, një gjuhë. Gjaku ynë i shpërndarë nëpër botë. Ky është qëllimi i misionit tonë që po e çojmë përtej

me ndihmën e shumë miqve dhe kolegëve. Kështu që kemi kënaqësinë të ndërveprojmë edhe me universitetet. Do të kemi kënaqësinë të krijojmë klasa të reja në bashkëpunim me kolegjin më gjithëpërfshirës në Itali, si ai i Sant'Adrianos, në të cilën kemi në dispozicion 40 vende, për të cilat do të donim të krijojmë hapësira për studentët për të ardhur dhe studiuar, dhe për të çuar më tej jo vetëm studimet italiane, por mbi të gjitha ato arbëreshe dhe shqiptare", ka thënë Madeo. Në fjalën e tij, kryetari i Federatës Pan - Shqiptare "Vatra", Elmi Berisha tha se UBT për 22 vjet i ka dhënë Kosovës, një dritë, një të ardhme, inovacion dhe shpresë.

"Jam i nderuar të jem sot prezent këtu në mesin e vëllezërve dhe mo-

trave tona, nga gjaku ynë, që vijnë për të vizituar këtë universitet shumë të veçantë, që për 22 vjet i ka dhënë Kosovës, Kosovës së re dhe të pavarur, një dritë, të ardhme, inovacion dhe shpresë. Përkushtimi i Rektorit Hajrizi, është premtues, dhe nuk duhet të shqetësohemi, sepse në një të ardhme shumë të afërt të rinjtë nuk do të largohen nga ky vend i mrekullueshëm. Dhe të gjitha këto janë thjesht sepse universiteti, ky si UBT, bën që kjo të ndodhë. Ne duhet të trajnojmë këta studentë të bukur që të përputhen me botën e sotme. Mesazhi im për këta studentë është që në këtë qiell, çdo gjë është e mundur, vazhdoni të studiojnë me vendosmëri, vazhdoni të punoni me zell, dhe arritjet tuaja do të shpërblehen,"

u shpreh Berisha.

Genc Podgorica nga Shoqata "Korabi" u shpreh i emocionuar për prezencën e tij në UBT dhe theksoi se shqiptarët gjithmonë kanë dhënë gjithçka nga vetja dhe e kanë kthyer kokën pas çdo herë që është kërkuar. "Jam shumë i emocionuar se po bëjmë ca hapa të mëdha po kemi ca shembuj shumë të mira që po vijnë nga jashtë. Ne atje po mundohemi të marrim shembuj të mirë, siç është UBT, dhe të aplikojmë edhe atje në Bolonjë të Italisë. Shqiptarët gjithmonë ikin, por kur është nevoja për ndihmën e vendit tonë, ata kthejnë kokën mbrapa. Si Jeronim De Rada që ishte i pari që vuri themelet e rilindjes kombëtare. Kjo është historia nga Skënderbeu, nga arbëreshët që kanë dhënë ndihmën më të madhe", tha Podgorica. Arkitekti, Gjon Radovani dhe ish-presidenti i Interportos dhe Acer-it, Dr. Alessandro Alberani shprehën gatishmërinë e tyre për të kontribuar dhe për të bashkëpunuar, ndërsa Marco Spinedi, Presidenti i Interportos nga Bolonja në Itali, përmes një video-mesazhi përcjelli përgëzimet e tij për këtë konferencë duke theksuar bindjet e tij se kjo do të jep rezultate konkrete në të ardhmen.

Kjo ngjarje ishte e rëndësishme dhe një shembull i mirë i bashkëpunimit dhe inovacionit në fushën e arsimit dhe zhvillimit të komunitetit.

Çmimi "Leadership Excellence Award" për Dr. Ernesto Madeo

Dr. Ernesto Madeo është një emër shumë i njohur jo vetëm për arbëreshët, por edhe për opinionin në Shqipëri, në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare. Atë e kemi parë duke pritur delegacione të rëndësishme nga Shqipëria e nga Kosova, përfshirë këtu krerët më të lartë të shteteve



UBT nderoi me Çmimin Tradicional Honor Degree "Leadership Excellence Award", Dr. Ernesto Madeo, kryetarin e Bashkisë së Shën Mitër Koronës (San Demetrio Corone), njëherit kryetar i Fondacionit të Institutit Rajonal të Komunitetit Arbëresh të Kalabrisë.

Në një ceremoni solemne, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ndau çmimin "Leadership Excellence Award", për Dr. Ernesto Madeo, për të vlerësuar kontributin e tij dhënë në ruajtjen e traditës, të kulturës, të gjuhës dhe të identitetit kombëtar shqiptar, me theks të veçantë në Kalabri, por edhe ndër gjithë arbëreshët e Italisë. Dr. Ernesto Madeo është një emër shumë i njohur jo vetëm për ar-

bëreshët, por edhe për opinionin në Shqipëri, në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare. Atë e kemi parë duke pritur delegacione të rëndësishme nga Shqipëria e nga Kosova, përfshirë këtu krerët më të lartë të shteteve.

E kemi parë duke folur në promovime librash të autorëve nga Shqipëria e nga Kosova, të cilat flasin për arbëreshët, historinë dhe të tashmen e të ardhmen e tyre. Në gjithë aktivitetin e Dr. Madeos, ne gjejmë një përkushtim të tij të pandalshëm për ruajtjen dhe për promovimin e identitetit dhe kujtesës historike të arbëreshëve të Kalabrisë, që paraqesin një nga degët më të rëndësishme të ngulimeve arbëreshe në Itali. Si kryetar i Bashkisë së Shën Mitër

Koronës (San Demetrio Corone), Dr. Mateo bëri hapa dhe veprime konkrete për të shtyrë përpara një varg çështjesh, që nga zhvillimi ekonomik, aktivitetet kulturore, ruajtja e traditës e deri te kërkesat për më shumë të drejta për arbëreshët, sidomos në aspektin gjuhësor.

Po kështu, duke qenë drejtues i Fondacionit të Institutit Rajonal të Komunitetit Arbëresh të Kalabrisë, ai shihet si një figurë qendrore, rreth të cilit dhe fondacionit që drejton, lidhen shpresat aktivitete të pandalshme, në drejtim të ruajtjes së gjuhës, traditës dhe kulturës arbëreshe.

Gjithashtu, me emrin e tij lidhen edhe aktivitetet bashkërenduese me institucionet përfaqësuese të Kosovës dhe të Shqipërisë në Romë, e sidomos me institucionet shtetërore në Prishtinë e në Tiranë, në drejtim të veprimeve konkrete të të dy shteteve, për të qenë sa më afër arbëreshëve. Me punën që ka bërë deri tash, Dr. Ernesto Madeo tashmë ka lënë gjurmë dhe emrin e tij në historinë e re arbëreshe. Presim dhe e nxisim e i premtojmë ndihmë e bashkëpunim, për më shumë aktivitete edhe në të ardhmen, në të mirë të arbëreshëve, në të mirë të të gjithë shqiptarëve, kudo që janë.

Rreth 40 vajza nga komunitetet përfunduan trajnimin e shkathtësive në TI në UBT



UBT ka përfunduar një trajnim të rëndësishëm në fushën e Teknologjisë së Informacionit (TI) për anëtarët e shoqatës "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians" (VORAE). Ky trajnim, i cili zgjati nga dhjetori i vitit të kaluar deri në janar të këtij viti, ka pasur si qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe ofrimin e mundësive për vajzat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Gjatë kësaj periudhe dy-mujore, UBT ka trajnuar 36 vajza në disa nga aspektet më kryesore të TI-së. Programi i trajnimit përfshinte tema të ndryshme si Bazat e TI-së, Siguria në TI, Sistemet Operative, si dhe përdorimi i aplikacioneve të Microsoft Office, si: MS Word, MS Excel dhe MS PowerPoint. Ky trajnim është veçanërisht i

rëndësishëm për komunitetet e përfshira, pasi synon të ofrojë aftësi dhe njohuri që do t'i ndihmojnë pjesëmarrësit në tregun e punës. Përmes kësaj iniciative, UBT dhe VORAE kanë shfaqur angazhimin e tyre për të përmirësuar aksesin në arsim dhe mundësitë profesionale për grupet në rrezik, siç janë vajzat nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Trajnimi është pritur me entuziazëm nga pjesëmarrësit dhe ka shërbyer si një platformë e rëndësishme për të ndërtuar vetëbesim dhe për të zbuluar talente të reja në fushën e TI-së. UBT dhe VORAE shpresojnë se ky trajnim do të jetë një hap i rëndësishëm drejt integritimit me të mirë të këtyre komuniteteve në shoqërinë dhe tregun e punës.

UBT shpërbleu mbi 100 studentë të dalluar me bursa studimi

Bursat u ndan nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në një ceremoni ku morën pjesë edhe mysafirë nga Italia dhe vende të tjera të Evropës, në mesin e të cilëve ishin edhe arbëreshë të Italisë. Në fjalën e tij, Rektori Hajrizi tha

se qëllimi i këtyre bursave është të motivojë dhe të përkrahë studentët gjatë rrugës së tyre në botën akademike. Ai shprehu krenarinë për suksesin e studentëve dhe i cilësoi ata si talentët, inovatorët e së ardhmes dhe shtet-ndërtuesit e Kosovës.

"Arritjet e këtyre studentëve na bëjnë shumë krenarë dhe gjithsesi janë motivi jonë si institucion i arsimit të lartë. Ne mburremi që studentët tanë kanë sukses në studime. Pra, nuk është pak sepse gjithë këta studentë kanë arritur notë të

lartë mesatare. Këta të rinj janë talentët dhe inovatorët e së ardhmes, prandaj gjejmë punë dhe janë më të kërkuarit në tregun e punës", potencoi Rektori Hajrizi. UBT ka një histori të gjatë në ndihmën dhe lehtësimin e shkoll-

limit për të rinjtë nga Kosova dhe rajoni. Çdo vit, institucioni ndan bursa në vlerë prej vlerë të 1 milion e 500 mijë eurove, duke ndihmuar qindra studentë në rrugën e tyre të arsimit të lartë.

Themelohet Fondacioni Jim Xhema - një nismë e fuqishme për zhvillimin e talentit dhe arsimimin cilësor të rinisë shqiptare

UBT me përkrahjen e atdhetarit dhe lobuesit më të madh të Pavarësisë së Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Jim Xhemës, ka themeluar Fondacionin Jim Xhema, i cili ka për qëllim përkrahjen e të rinjve nga mbarë trojet shqiptare për zhvillimin e talentit të tyre dhe për një edukim sa më cilësor

Fondacioni synon të ofrojë mbështetje të plotë për rininë, duke tejkaluar kufijtë gjeografikë dhe përfshirë rajone të ndryshme me komunitete shqiptare. Përkushtimi i Jim Xhemës dhe UBT-së ndaj kësaj tregon objektivin kryesor të fondacionit për të ndihmuar në zhvillimin e talenteve të reja, duke u mundësuar atyre të shfrytëzojnë potencialin e tyre dhe të kontribuojnë në mënyrë domethënëse në komunitetet e tyre dhe më gjerë.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka thënë se ky fondacion do të jetë në përkrahje të të gjithë të rinjve të cilët duan të zhvillojnë talentin e tyre dhe kontribuojnë në avancimin e fushës së tyre të



studimit. "Si dëshmi e përkushtimit të palëkundur ndaj avancimit të gjeneratës së re, Fondacioni Jim

Xhema ngrihet si një dritë shprese dhe mundësie. Ky fondacion synon të krijojë një trashëgimi të qën-

drueshme të fuqizimit, arsimimit dhe transformimit pozitiv në dobi të komunitetit shqiptar në përgjithësi", ka thënë Rektori Hajrizi.


Në vitin e kaluar UBT në praninë e atdhetarit Jim Xhema, Rektori Hajrizi, përfaqësuesve të Federatës Panshqiptare "VATRA", përfaqësuesve të Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Diasporë, profesorëve dhe studentëve të UBT-së, zbuloi pllakën e objektit në Parkun Shkencor Inovativ në Lipjan me emrin "Jim Xhema Building".

Në këtë eveniment madhështor, atdhetari Jim Xhema potencoi se do të vazhdojë të kontribuojë dhe angazhohet për studentët, të rinjtë shqiptarë dhe për të ardhmen e

Kosovës dhe Shqipërisë. "Më duhet që të sigurohem që ju e dini se jeni ardhmëria dhe shpresa jonë. Pa ju nuk ka asgjë dhe nuk do të arrihet shumë. Ju duhet që të angazhoheni e studioni shumë për të punuar për sigurinë e vendit tonë dhe ardhmërinë. Duhet t'i merrni studimet shumë seriozisht. Unë personalisht do të qëndrojë i lidhur me ju këtu dhe do të bëjë fonde me të cilat do të sigurohem që bashkërisht t'i arrijmë qëllimet tona", u shpreh ai.

Së shpejti Fondacioni Jim Xhema do të shpall konkursin për bursa nga të cilat do të mund të përfitojnë të gjithë studentët dhe të rinjtë, për të zhvilluar më tej talentin e tyre.

Profesorët e UBT-së bëjnë thirrje për mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve të ujit



Profesorët e UBT-së, përmes Organizatës Quality Kosova, po bëjnë thirrje për një angazhim gjithëpërfshirës për mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve ujore. Në një punëtori të zhvilluar në Komunën e Mitrovicës, ata prezantuan të dhënat, gjetjet dhe rekomandimet e tyre nga projekti: "Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore në pellgun e lumit Ibër". Kjo iniciativë u realizua në kuadër të skemës së Grantit nga Programi për Menaxhimin

e Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë, njohur si MIRU-K. Profesoresha Emine Daci, menaxhere e projektit, theksoi se synimi i tyre është të ndërrojnë hapa konkrete për të përmirësuar gjendjen aktuale të menaxhimit të burimeve ujore. Po ashtu, ajo shtoi se është e rëndësishme të krijohet një departament i veçantë në nivelin komunal për të zbatuar aktivitete të rëndësishme për menaxhimin e ujërave.

"Situata e menaxhimit të burimeve ujërave është mjaft kritike. Në bazë të hulumtimit kemi vërejtur që ekziston një koordinim jo i mirë në mes të politikave të nivelit qendror në nivelin lokal. Nuk ekziston një departament i veçantë në kuadër të komunave i cili do të zbatonte aktivitete të rëndësishme sa i përket menaxhimit të ujërave", tregoi menaxherja e projektit Prof. Dr. Emine Daci.

Ekspertët dhe profesorët e pranishëm në punëtori u pajtuan se çështja e mbrojtjes së burimeve ujore duhet të trajtohet në nivele të ndryshme, fillimisht duke bërë investime dhe projekte për mbrojtjen e tyre. Ata theksuan nevojën për zbatim të ligjit, forcim të kapaciteteve inspektuese, si dhe bashkëpunim dhe koordinim të vazhdueshëm për zhvillimin e projekteve për mbrojtjen e ujërave.

Vizita e delegacionit nga Austria në UBT: Nisma dhe diskutime për inovacionin në turizëm dhe menaxhim hotelierie

Në UBT një moment i rëndësishëm u shënuar me vizitën e një delegacioni nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara IMC Krems në Austri.

Delegacioni ishte i përbërë nga Kryetari i bordit mbikëqyrës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara IMC Krems, njehërit themeluesi i IMC-së dhe HLF-së, Heinz Boyer, si dhe Drejtori Menaxhues në Universitetin e Shkencave të Aplikuara IMC Krems, njehërit Kryeshefi Ekzekutiv i këtij institucioni, Udo Brandler.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi mirëpriti delegacionin nga Austria dhe me këtë

rast së bashku me profesorë dhe studentë të UBT-së, zhvilluan një diskutim konstruktiv rreth sipërmarrjes, inovacionit dhe edukimit në turizëm dhe menaxhim hotelierie.

Në këtë bashkëbisedim u theksua rëndësia e përmirësimit të sektorit të turizmit dhe menaxhimit të hotelierisë përmes inovacionit dhe zhvillimit të aftësive të studentëve në këto fusha.

Rektori Hajrizi potencoi faktin se UBT është duke u angazhuar në përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe krijimin e një strategjie për shkolla profesionale në këtë drejtim.

Studentët vizituan kompanitë "Ananasi" dhe "Agropeti" në Podujevë



Studentët e programit Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT zhvilluan vizita studimore në kompanitë "Ananasi" dhe "Agropeti" në Podujevë.

Gjatë vizitave, studentët u njohën me procesin e tharjes së frutave dhe perimeve, duke fituar njohuri të rëndësishme për formimin e ekstrakteve të ndryshme.

Vizita u ofroi studentëve një kuptim të procesit të kultivimit të kërpudhave, procesin e tharjes dhe metodat më të përshtatshme të paketimit për kërpudhat.

Diskutimet gjithashtu përfshinë tema si ruajtja e vlerave ushqyese të produkteve dhe menaxhimi i mbetjeve ushqimore.

UBT shembull për mbështetjen, fuqizimin dhe trajtimin e barabartë të grave në shoqëri

UBT tashmë e ka bërë traditë mbështetjen, fuqizimin dhe trajtimin e barabartë të grave në shoqëri, duke i kushtuar rëndësi të madhe angazhimit të gruas në institucion dhe si rezultat i këtij përkushtimi, UBT sot fatmirësisht rezultoi të jetë institucioni i parë me numrin më të madh të grave të punësuar në rajon, dhe atë, të gjitha në pozita udhëheqëse dhe koordinuese.

Kështu u tha sot në diskutimin organizuar nga UBT në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit, me temën "Barazia gjinore - sfidat dhe mundësitë".

Pjesëmarrëse në këtë panel diskutimi ishin: Edi Gusia, u.d. Kryeshefe e Agjencisë për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit, Vlora Tuzi - Nushi, Kryeshefe e UN Women, Kosovë, Albana Rexha - Ligjëruese në UBT, si dhe Dekania e Fakultetit të Psikologjisë në UBT, Denis Celcima.

Dekania e Fakultetit Psikologji, Dr. Denis Celcima si përfaqësuese



e UBT-së në këtë diskutim tha se shumë vajza e gra të diplomuara në UBT tashmë janë punësuar në kompani të ndryshme botërore, janë angazhuar në pozita udhëheqëse dhe si staf akademik e administrativ, por edhe në shumë institucione shtetërore.

"Çfarë na motivon dhe na bën krenarë në të njëjtën kohë, është fakti se numri i studentëve që zgjedhin për të studiuar në UBT është në rritje të vazhdueshme. Në kurrikulat tona është lënda e barazisë gjinore, një lëndë shumë e rëndësishme, jo thjesht një temë diskutimi" ka thënë

dekania e Fakultetit të Psikologjisë, Denis Celcima.

Gjatë kësaj tryeze u diskutua mbi progresin e arritur dhe sfidat drejt barazisë gjinore në Kosovë, mundësitë për tejkalimin e normave sociale dhe kulturore drejt arritjes së barazisë gjinore. Gjithashtu u diskutua prioritetet të vendosura në kuadër të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, bashkëpunimi ndërinstytucional për zbatim të politikave dhe intervenimet konkrete të akterëve ndërkombëtarë siç është UN Women.

Studentët shfaqën produkte ushqimore në një mini panair në UBT

Prezantimi i produkteve ushqimore në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së ishte një sukses i shkëlqyeshëm, ku studentët e nivelit master nga programi Shkenca të Ushqimit dhe Nutricionit prezantuan krijimet e tyre ushqimore.

Në mini panairin e organizuar në kuadër të lëndës "Aditivët dhe Suplementet në Ushqim", Prof.



Ibrahim Memeti udhëhoqi një sesion informues.

Pjesa më e rëndësishme e panairit ishte përqendrimi te ushqimet dhe suplementet, ku prezantimet e studentëve ndihmuar në përmbledhjen e informacioneve mbi efektet pozitive dhe mënyrën e aplikimit të këtyre produkteve.

Në këtë ngjarje, pjesëmarrja e kompanive mbështetëse shtoi një

dimension të veçantë, duke dhënë një hov të ri për përdorimin dhe përkrahjen e produkteve.

Ky bashkëpunim pozitiv ndihmoi në promovimin e diversitetit ushqimor dhe në krijimin e një platforme të rëndësishme për shkëmbimin e njohurive në fushën e ushqimit dhe nutricionit brenda komunitetit universitar.

Prezantohet projekti "Shape" në UBT: Ndërtimi i rrjetit universitar për portin në Ballkanin Perëndimor dhe promovimi i shëndetit



Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, u prezantua projekti "Shape – Sport, health and the people".

Në këtë ngjarje morën pjesë personalitete të shquara nga institucione publike dhe private, brenda dhe jashtë Kosovës.

Në këtë ngjarje ishin: Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, nga Zyra e Unionit Evropian në Kosovë, Lucia Parducci, nga Am-

basada e Italisë, Antonello De Riu, nga Ambasada e Austrisë, Mag. Georg Schnetzer, nga Ambasada e Shqipërisë, Pranvera Teli Dibra, nga Komiteti Olimpik i Kosovës, Ismet Krasniqi, nga Zyra e Erasmus në Kosovë, Mimika Dobroski dhe profesori italian, Paolo Parisi.

Kjo platformë ishte e rëndësishme për shkëmbimin e ideve dhe përfundimin e lidhjeve ndërmjet sektorit të arsimit, institucioneve qeveritare

dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, me synimin e përbashkët të përmirësimit të shëndetit dhe kualitetit të jetës nëpërmjet sportit dhe aktiviteteve të tjera shëndetësore.

Projekti "Shape – Sport, health and the people" synon të ndërtojë një rrjet universitar për sportin në Ballkanin Perëndimor dhe të hartojë veprime të përbashkëta, në përputhje me kontekstin evropian dhe rekomandimet e BE-së, për të promovuar një mënyrë jetese aktive dhe për të kontribuar në jetën e komunitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm në rajon.

Për këtë qëllim, projekti synon të trajtojë profesionistë sportivë të kualifikuar në fusha specifike sportive që zbatohen për nevoja të ndryshme, dhe të promovojë shëndetin personal, si dhe vlerat e përbashkëta si përfshirja, barazia, siguria ose ndërgjegjësimi mjedisor.

Përfaqësues të kompanisë amerikane XponentL Data qëndruan në UBT



Studentët e UBT-së patën rastin të takohen drejtpërdrejt me përfaqësues të kompanisë amerikane "XponentL Data", si një mundësi e shkëlqyer për t'u njohur nga afër me udhëheqjen e kësaj kompanie rreth fushës së Inteligjencës Artificiale dhe Machine Learning.

Folësit nga XponentL Data, Tom Johnstone, Matt Arellano dhe Drilon Jaha ndanë njohuri nga përvoja e tyre me studentët e Shkencave Komputerike dhe Inxhinierisë, si dhe me të gjithë ata që ishin të interesuar për këtë ngjarje.

Kompania XponentL Data është e specializuar në integrimin e këtyre teknologjive në çdo proces që ka të bëjë me shumësi të dhënash.

Kjo ngjarje ishte një mundësi e mirë edhe për të krijuar lidhje me profesionistë dhe kompani të rëndësishme në fushën e shkencave kompjuterike, si dhe për të zgjeruar rrjetin profesional të studentëve.

Pjesëmarrja në këtë ngjarje u mundësoi studentëve të kontaktonin me përfaqësues të XponentL Data dhe të shprehnin interesin e tyre për punë praktike apo punësim.

Ndërmarrësi Samir Mane qëndroi për vizitë në UBT



Në UBT qëndroi për vizitë ndërmarrësi shqiptar, Samir Mane, i cili zhvilloi një bashkëbisedim me studentët e drejtimeve të ndryshme.

Mane foli rreth ndërmarrësisë, zhvillimit ekonomik dhe përgjegjësisë sociale. "Ndiem sot i nderuar për çmimin e Mirënjohjes që më akorduan. Për mua, sa është kënaqësi, aq është edhe detyrim që të ndaj eksperiencën time si sipërmarrës me studentët. Më vjen mirë që studentët e sotëm kanë interes për biznesin dhe inovacionin. Ashtu sikurse i thashë edhe studentëve dhe stafit akademik të UBT, unë do jem përherë i gatshëm për të ndihmuar të rinjtë që të arrijnë më shumë", u shpreh Mane.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, falënderoi për vizitën Presidentin Mane, për të cilin në emër të UBT-së ndau një mirënjohje për kontributin e tij në ndërmarrësi dhe zhvillim ekonomik.

Rektori Hajrizi tha se Mane është një sipërmarrës i suksesshëm dhe vlerësoi lartë kontributin e tij për zbutjen e varfërisë.

"Është një ndër sipërmarrësit më të shquar shqiptar, duke cekur se ka laramani të gjitha llojeve të ndërmarrësisë dhe kemi ndjekur gjithë rrugëtimin e tij drejt këtyre fushave si ndërmarrësi, zhvillim ekonomik dhe përgjegjësi sociale", tha Rektori Hajrizi.

Studentët vizituan Korporatën Bujqësore "Krusha" në Krushë dhe atë "Koral" në Fushë Kosovë



Studentët e drejtimet Shkencë të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT kanë zhvilluar vizitë studimore në Korporatën Bujqësore

"Krusha" në Krushë, si dhe në Korporatën Bujqësore "Koral" në Fushë Kosovë. Në kuadër të këtyre vizitave, studentët kanë

mësuar rreth procesit të përpunimit të frutave dhe perimeve, përkatësisht për procesin e përgatitjeve të turshive me metodë tradicionale, si dhe për procesin e përpunimit të mishit, përkatësisht përgatitjen e produkteve si proshuta, suxhuku dhe sallama. Përgjatë vizitave, ata u njohën edhe me teknologjitë e fundit të cilat përdoren nga korporatat, si dhe me angazhimin e stafit të tyre.

Studentët e Muzikës Moderne zhvilluan performancë në skenë

Në skenën e artit në kampusin e UBT-së në Lipjan, u realizua një shfaqje muzikore mbresëlënëse, duke treguar talentin e madh të



studentëve nga Fakulteti i Muzikës Moderne (Grupi Vokal).

Kjo shfaqje ishte në kuadër të lëndës "Performancë në Skenë", me bartëse Prof. Fatlume Bunjakun, si dhe shërbeu si një provë kryesore për studentët, duke u shënuar si pika kulmore e semestrit të tyre të parë për këtë vit.

Ambasadori i Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen, ligjëroi para studentëve të UBT-së



Studentët e UBT-së patën një mundësi për të eksploruar historinë dhe rrugëtimin e Finlandës drejt anëtarësisë në Bashkimi Europian (BE). Ambasadori i Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen, ishte pranë tyre për të ndarë perspektivën dhe përvojën e vendit të tij në këtë proces të rëndësishëm.

Diskutimi u karakterizua nga një

shkëmbim i pasur i ideve dhe mendimeve, i udhëhequr nga pyetje të thella dhe komente nga studentët që përfaqësojnë disiplina të ndryshme, duke përfshirë shkencat politike, studimet e sigurisë, juridike dhe psikologjike. Profesori Hajdi Xhixha, një eksperte në Shkencat Politike, udhëhoqi diskutimin duke inkurajuar pjesëmarrësit të ndajnë mendimet e

tyre me lirinë dhe respektin e duhur. Në pjesën më të madhe të diskutimit, u theksua rëndësia e përfshirjes së aspekteve të ndryshme të politikës, sigurisë, ligjit në procesin e anëtarësisë në BE. Studentët u frymëzuan nga modeli i suksesit të Finlandës dhe debatuan për mënyrat efikase që përshpejtojnë rrugëtimin e Kosovës drejt anëtarësisë të plotë në Bashkimi Europian.

Në përfundim, diskutimi u vlerësua si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin konstruktiv të ideve dhe për të shtuar njohuritë e tyre në fushën e integriteteve evropiane. Eksperiencia e Finlandës u bë burim frymëzimi për studentët, duke i nxitur ata të shqyrtojnë më thellë mënyrat se si Kosova mund të përfitojë dhe të përparojë në rrugën e saj drejt anëtarësisë në BE.

Dr. Akemi Mizuuchi në UBT



UBT në bashkëpunim me Asociacionin e Miqësisë Kosovaro-Japoneze, organizoi një diskutim të hapur rreth temës: "Roli i grave japoneze përgjatë historisë nga antikiteti deri në ditët e sotme".

Në këtë ngjarje morën pjesë Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Luljeta Arifi nga Asociacioni i Miqësisë Kosovaro-Japoneze, si dhe Dr. Akemi Mizuuchi, bashkëshortja e ambasadorit japonez në Kosovë dhe Vjenë.

Prezantimi i Dr. Akemi Mizuuchi rreth temës "Roli i grave japoneze

përgjatë historisë nga antikiteti deri në ditët e sotme", ishte një mundësi e mirë për të pasuruar kuptimin dhe vlerësimin për kontributet e shumta të grave japoneze gjatë kohërave të ndryshme dhe zhvillimit të shoqërisë japoneze.

Ky diskutim ofroi një mundësi të vlefshme për reflektim dhe shkëmbim mendimesh rreth rolit të rëndësishëm të grave japoneze në formimin e historisë së tyre unike dhe të ndikimit të tyre në shoqërinë japoneze dhe botërore.

Studentët e MBE vizituan Bankën Qendrore të Kosovës

Studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, realizuan një vizitë studimore në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK). Studentët u pritën nga zyrtarët dhe personat përgjegjës brenda Bankës Qendrore të Kosovës, të cilët i informuan studentët rreth rolit dhe përg-

jegjësisë që BQK ka si institucion, si dhe rreth zhvillimeve të fundit në sektorët e ndryshëm që mbulojnë nga BQK. Përgjatë vizitës, studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, zhvilluan një interaktivitet të frytshëm me



zyrtarë të këtij institucioni rreth shumë çështjeve ekonomike e fi-

nanciare, rreth funksionimit të sistemit të pagesave, funksionimit të

mbikëqyrjes financiare, menaxhimit të mjeteve, letrave me vlerë, si dhe aktivitete të tjera që po organizohen nga BQK. Gjatë vizitës, studentët bashkëbiseduan me zyrtarët e BQK-së rreth shumë çështjeve ekonomike e financiare, rreth funksionimit të sistemit të pagesave, funksionimit të mbikëqyrjes financiare, menaxhimit të mjeteve, letrave me vlerë e aktiviteteve tjera që po organizohen nga BQK.

Punëtorja e UBT-së për Menaxhimin e Cilësisë: Një hap drejt ekselencës akademike

UBT së fundmi organizoi një seminar strategjik kyç mbi Menaxhimin e Cilësisë, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt përsosmërisë akademike dhe efikasitetit të zgjeruar operacional. Ky seminar gjithëpërfshirës, i mbajtur në kampusin tonë prestigjioz, ishte dëshmitar i pjesëmarrjes aktive të 96 anëtarëve të nderuar të stafit tonë akademik, duke përfshirë shefat e departamenteve, dekanët dhe koordinatorët e cilësisë nga fakultetet përkatëse.

Kjo nismë nënvizon përkushtimin e palëkundur të UBT-së për të nxitur një mjedis përmirësimi dhe përsosmërie të vazhdueshme. Duke integruar parimet e menaxhimit të cilë-



sisë në proceset tona akademike dhe administrative, ne synojmë të ngjirim përvojën arsimore për studentët tanë dhe të vendosim standarde të reja për arsimin e lartë.

Seminari u krijua për të ofruar jo vetëm një kuptim të thellë të sistemeve të menaxhimit të cilësisë, por edhe për të fuqizuar fakultetin tonë me mjetet dhe metodologjitë për

të zbatuar këto parime në mënyrë efektive në fushat e tyre përkatëse. Nëpërmjet një sërë sesionesh interaktive, studime të rasteve dhe diskutime në grup, pjesëmarrësit u angazhuan në një dialog produktiv për rritjen e cilësisë në të gjitha aspektet e funksionimit të universitetit.

Rezultatet kryesore të seminarit përfshijnë zhvillimin e një udhërrëfyese strategjik për përmirësimin e cilësisë, vendosjen e standardeve të cilësisë për proceset akademike dhe administrative dhe formulimin e planeve të veprimit për çdo departament dhe fakultet. Këto rezultate pritet të kontribuojnë ndjeshëm në misionin e UBT-së për të ofruar një

mjedis arsimor të klasit botëror.

Jemi krenarë për suksesin e kësaj nisme dhe frymën e bashkëpunimit të treguar nga komuniteti ynë akademik. Ky seminar është vetëm fillimi i rrugëtimit tonë drejt arritjes së përsosmërisë operationale dhe udhëheqjes akademike. Ne jemi të ngazëllyer për ndryshimet pozitive që këto përpjekje do të sjellin në universitetin tonë dhe presim të ndajmë përparimin tonë.

Qëndroni të informuar për përditësime mbi iniciativat tona të menaxhimit të cilësisë dhe zhvillime të tjera emocionuese në UBT.

Në UBT shënohet Dita Botërore e Ujit



Në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, në Ditën Botërore të Ujit, nën organizimin e Fakultetit Inxhinierë dhe Ndërtimit dhe Infrastruktural në UBT, u zhvillua një diskutim i hapur me temën: "Uji për Paqe".

Prorektori Prof. Dr. Binak Beqaj dhe Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë dhe Ndërtimit, Prof. Dr. Visar Krelani, i përshëndetën pjesëmarrësit dhe folën për rëndësinë e mbrojtjes së ujërave.

Prorektori Beqaj nënvizoi domoshmërinë e përkushtimit të të gjithë aktorëve në mbrojtjen e burimeve të ujit në shoqërinë tonë. Gjithashtu Beqaj theksoi rolin e institucioneve arsimore në kërkimin dhe zhvillimin e teknologjive për trajtimin dhe ruajtjen e ujërave. Në ngjarje ishte i pranishëm edhe Zëvendësministri në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktural, Jeton Raka, duke shfaqur angazhimin e in-

stitucioneve qeveritare në këtë çështje të rëndësishme për të ardhmen e mjedisit dhe të shoqërisë në tërësi.

Profesorët nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Mjedisit dhe Teknologjisë Ushqimore, prezantuan gjendjen e ujërave në Kosovë dhe diskutuan me pjesëmarrësit për sfidat dhe zgjidhjet potenciale.

Pjesëmarrësit, përfshirë gjimnazistë, studentë dhe profesorë, shprehën mendimet, komentet, dhe sugjerimet e tyre, duke vënë në pah nevojën për veprime më të fuqishme për të ruajtur dhe mbrojtur burimet ujore.

Profesori Hazir Çadraku në përmblyllje falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e tyre në përcjelljen e rëndësishë së ruajtjes së burimeve ujore dhe në nevojën për një menaxhim të integruar të tyre.

Fillon bashkëpunimi institucional për zhvillimin e sportit, shëndetit dhe aktivitetit fizik në Ballkan



Fakulteti i Shkencave të Sportit dhe Lëvizjes, nën udhëheqjen e Dekanit Prof. Agron Thaqi, së bashku me Prof. Masar Gjaken dhe Prof. Milaim Berishën, morën pjesë në workshopin me titull "Sport, Health and Physical Activity" të organizuar nga GIZ-i Gjerman në qendrën ITP në Prizren. Në këtë takim, ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës dhe përfaqësuesit nga Universiteti i Prishtinës. Diskutimet kryesore u fokusuan në potencialin e bashkëpunimit ndërinstitucional për përdorimin e Parkut

Inovativ dhe Trajnimit në Prizren, me synimin e zhvillimit të një qendre të përsosur në Ballkan në fushën e shëndetit, sportit dhe aktivitetit fizik. Përfaqësuesit e Fakultetit të Shkencave të Sportit dhe Lëvizjes prezantuan punën dhe kontributin e tyre në fushën e sportit, si dhe ngritjen e kapaciteteve humane dhe infrastrukturale. Në këtë takim u shkëmbyen ide dhe sugjerime rreth mënyrave të përdorimit të infrastrukturës së ITP në Prizren për të ngritur kapacitetet në fushën e sportit dhe shëndetit.

Profesori nga Linnaeus University në Suedi, Dr. Sc. Christopher Allen viziton UBT-në



Profesori nga Linnaeus University në Suedi, Dr. Sc. Christopher Allen qëndroi për vizitë në UBT, ku është takuar me studentë dhe profesorë të Fakultetit të Gjuhës Angleze.

Gjatë kësaj vizite, nën udhëheqjen e Dekanes së Fakultetit të Gjuhës Angleze në UBT, Prof. Dr. Alma Lama, profesori Christopher Allen ka trajtuar tema të ndryshme, duke përfshirë lëndë si Mikro-teza, Fonetika dhe Fonologjia e Gjuhës Angleze, si dhe Gjuhë Angleze për Qëllime Specifike (ESP) në fushën e Biznesit dhe Ekonomisë. Mësimet e tij janë shënuar nga metoda inovative, që kanë inkurajuar pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe përmirësimin e përvojës së tyre të mësimin.

Përveç mësimdhënies, praktikat gjithashtu kanë përfshirë zbatimin e metodave si mësimi forenzik dhe

Dictogloss, të cilat kanë ndihmuar në zhvillimin e aftësive kritike të mendimit dhe zgjidhjen e problemeve për studentët. Së bashku me këto, studentët kanë praktikuar metodën e screencasting për të krijuar video-instruksione për mësimin vizual dhe online.

Ky bashkëpunim ka shërbyer për të përmirësuar përmbajtjen e kursit dhe për të përshtatur strategjitë mësimore në përputhje me nevojat e studentëve. Prezantimi i Dr. Allen gjithashtu ka kontribuar në intensifikimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në promovimin e kuptimit ndërkulturor mes Universitetit Linnaeus dhe UBT-së. Ky bashkëpunim ngushtë ka sjellë ndikime pozitive në fushën e arsimit dhe në forcimin e lidhjeve mes universiteteve të përshira.

Dita Italiane e Dizajnit: Diskutime ndërdisiplinore për inovacionin dhe qëndrueshmërinë në UBT



Në UBT u mbajt një tryezë e rumbullakët në kuadër të Ditës Italiane të Dizajnit 2024. Në këtë takim morën pjesë studentë të arkitekturës dhe dizajnit, si dhe profesionistë të sektorit. Tema kryesore e

diskutimit ishte "Vlera e prodhimit – gjithëpërfshirja, inovacioni dhe qëndrueshmëria", ku u fokusua në procesin e prodhimit dhe impaktin e tij në të ardhmen e planetit. Luisa Collina, arkitekte dhe profe-

sore e rregullt e dizajnit në Politeknikun e Milanos, ishte një prej folësve kryesorë në takim.

Diskutimi u përqëndrua në rëndësinë e inovacionit dhe qëndrueshmërisë në procesin e dizajnit dhe prodhimit. Gjithashtu, u bisedua për cilësinë si një faktor kryesor për rinovimin dhe zhvillimin e produkteve dhe proceseve.

Zëvendës shefi i misionit italian, Ugo Ferrero, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe profesionistëve për promovimin e inovacionit dhe kreativitetit në fushën e dizajnit.

Vizita e përfaqësuesve të industrisë së arkitekturës në UBT



Parku Shkencor Inovativ i UBT-së u bë vendtakimi i përfaqësuesve të industrisë së arkitekturës dhe profesorëve të UBT-së. Në një ngjarje të organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, profesorët dhe studentët e UBT-së u takuan me profesionistë të njohur të arkitekturës për të ndarë eksperiencat, idetë dhe pers-

pektivat për zhvillimin e fushës. Delegacioni i përfaqësuesve të industrisë, përbërë nga arkitektë, inxhinierë, dhe ekspertë të fushës, diskutuan mbi inovacionet më të fundit në fushën e arkitekturës, si dhe adresuan sfidat dhe mundësitë e kësaj industrie në Kosovë. Në sesionin e diskutimit, profesorët dhe studentët e UBT-së patën

mundësinë të ndanin pyetje dhe të shpreheshin në lidhje me zhvillimet më të reja në fushën e arkitekturës dhe planifikimit hapësinor. Dialogu ndërthuri eksperiencën akademike me praktikën profesionale, duke krijuar një mjedis të pasur me njohuri dhe ide inovative.

Gjatë diskutimit u theksua nevoja për një lidhje të ngushtë midis UBT-së dhe industrisë për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës.

Ngjarja përfundoi me një tur të përbashkët në hapësirat e Parkut Shkencor Inovativ dhe një sesion informues të rrjetëzimit, duke krijuar një mundësi të shkëlqyeshme për të vazhduar bashkëpunimin midis akademisë dhe industrisë së arkitekturës në Kosovë.

Prorektori Beqaj takon Dekanin e Fakultetit të Shkencave në Universitetin e Tetovës, Prof Dr. Enis Jakupi



Prorektori dhe Dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Binak Beqaj, ka prituri në një takim pune Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Zbatuara në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Prof Dr. Enis Jakupi. Në këtë takim, u disku-

tuan për arritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Prorektori Beqaj dhe Dekani Jakupi diskutuan për planifikimin dhe organizimin i një akademie verore të përbashkët për studentët e të dy fakulteteve, duke ofruar programe

të pasura dhe sfiduese për zhvillimin e tyre intelektual, organizimi i ligjëratave tematike nga profesionistë të fushës, duke sjellë për studentët temat dhe trendet më të fundit në arkitekturë, planifikim hapësinor dhe shkencat e zbatuara.

Gjithashtu u tha se do të krijohen mundësitë për vizita studimore reciproke mes studentëve të dy institucioneve për të njohur më mirë praktikën dhe projekte të shkencave të zbatuara në terren.

Ky bashkëpunim synon të thellojë lidhjet akademike dhe të krijojë mundësi për shkëmbim të njohurive dhe përvojave mes studentëve dhe stafit të të dy institucioneve.

Studentët e Medias prezantuan punimet rreth fushës së komunikimit ndërkulturor



Në kuadër të lëndës “Komunikimi Ndërkulturor”, studentët e nivelit master në programin Media dhe Komunikim në UBT, prezantuan

an punimet e tyre dhe të gjeturat rreth veshjes tradicionale të Medvegjës, plisit, çiftelisë, besës dhe komunikimit ndërkulturor dhe përfaqësimit ndërkombëtar të kulturës shqiptare. Në këtë lëndë, nën udhëheqjen e profesorit, Dr. Votim Hanoli, studentët shfrytëzuan mundësinë për të lidhur dhe analizuar temat e tyre, duke thelluar diskutimet në lidhje me detajet e komunikimit ndërkulturor.

Nëpërmjet kësaj lënde, studentët jo vetëm zhvilluan njohuri të reja, por edhe thelluan aftësitë e tyre për të kuptuar, vlerësuar dhe praktikuar komunikimin ndërkulturor në një mjedis global.

UBT dhe Usiteti i Tokaj zgjerojnë bashkëpunimin në kërkimin shkencor të verës

UBT dhe Universiteti i Tokaj (UT) kanë arritur një marrëveshje për të zgjeruar bashkëpunimin e tyre në fushën e kërkimit shkencor të verërave. Kjo marrëveshje forcon angazhimin e tyre për aktivitete të përbashkëta kërkimore që synojnë avancimin e njohurive në këtë fushë. Sipas marrëveshjes, të dy institucionet, do të promovojnë në mënyrë aktive përpjekjet e përbashkëta kërkimore në përpunime me qëllim të interesat e tyre përkatese. Një rezultat kryesor i këtij bashkëpunimi do të jetë krijimi dhe funksionimi i Qendrës së Përbashkët të

Kërkimit të Shkencave të Verës UT-UBT (WSRC), e parashikuar të jetë një qendër inovacioni dhe ekspertize në studimin e vreshtarisë dhe enologjisë.

Kjo iniciativë premtan të nxisë sinergjitë midis dy institucioneve dhe të nxisë përpunime në shkencën e verërave, duke përfutur jo vetëm akademinë, por edhe industrinë më të gjerë të verërave dhe entuziastët në mbarë botën. Qëndroni të sintonizuar për përditësime të mëtejshme mbi këtë bashkëpunim dinamik.

Dr. Sc. Vali Gjinali, zhvilloi një punëtori dhe seminar në Javën e Artit dhe Dizajnit



Eksperti i Kozmetikologji, Dr. Sc. Vali Gjinali, njëherit profesori i

“Mjeshtër i Plastikës” në kuadër të Fakultetit të Aktrimit në UBT, ka

zhvilluar një punëtori dhe seminar brenda kornizës së Javës së Artit dhe Dizajnit në UBT, me temën “Arti i Gritit”.

Seminari filloi me prezantimin teorik të historisë së efekteve speciale të grimeve, zhvillimi dhe transformimi i tij në efektet speciale të përgatitura nga programet kompjuterike.

Pas seminarit teorik u zhvillua workshopi i efekteve special të gritit. Është demonstruar efekti i prerjes dhe mavijosjes në fytyrë me konceptin “No violence against women”.

Profesori Cengiz Çesko emërohet Drejtor i Institutit të Forenzikës në UBT




Profesori i UBT-së, Cengiz Çesko është emëruar Drejtor i Institutit të Forenzikës në UBT. Ai është një

figurë e njohur dhe e respektuar në botën akademike dhe profesionale. Emërimi i Profesorit Çesko në këtë

pozicion do të sjellë një frymë të re për zhvillimin dhe përmirësimin e këtij institucioni, duke siguruar një drejtim të qëndrueshëm për kërkimet shkencore dhe zhvillimin e programeve të arsimit dhe trajnimit në fushën e forenzikës.

Instituti i Forenzikës në UBT është një qendër e rëndësishme e dijes dhe shërbimeve në Kosovë dhe mbulon një gamë të gjerë temash në aspektin akademik, shkencor dhe profesional, duke përfshirë mjekësinë, kriminologjinë, teknologjinë, ushqimin, ekonominë, sigurinë, inxhinierinë, teknologjinë, artin, dhe shumë fusha të tjera.

Studentët e Aktrimit në UBT performuan disa shfaqje në kuadër të Javës së Artit dhe Dizajnit



Studentët e Fakultetit të Aktrimit në UBT, Elvana Prendi, Kevin Kçira dhe Qlirimtare Llumnica realizuan disa performanca në kuadër të Javës së Artit dhe Dizajnit.

Nën mentorimin e profesorëve Alban Zogaj, Ilir Prapashtica dhe Shkodran Tolaj studentët performuan shkëlqyeshëm para një publiku të gjerë. “Rini thuaja këngës”, “Laboratori”, “Burgu”, “Prishtinalikja” dhe “Profesori dhe Studenti” ishin disa nga performancat që u shfaqën nga studentët për publikun.

Fakulteti i Aktrimit vazhdon të jetë promotor i talentëve të artit dhe aktrimit. Është një mundësi unike e të rinjve për t'u bashkuar në këtë drejtim unik në UBT, ku përmes një stafi prej profesionistëve, studentët mbështeten në iniciativat e tyre për të ardhmen.

Ministri Elbert Krasniqi diskutoi me studentët e UBT-së



Për të folur rreth sfidave dhe mundësive të zhvillimit të qëndrueshëm lokal në Republikën e Kosovës, në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, në Lipjan, ishte Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi. Në aktivitetin e organizuar nga Fakulteti Shkencë Politike në UBT, në panelin e diskutimit ishte edhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Ministri Elbert Krasniqi ndau përvojën e tij në Ministri me studentët

e Shkencave Politike, teksa tha se ka ndryshuar qasjen në hartimin e politikave, dhe se kanë filluar reformën e munguar.

“Ne kemi ndryshuar qasjen në hartimin e politikave, kemi filluar reformën e munguar, kemi ngritur mbështetjen financiare dhe kemi krijuar programe të reja. Për secilin student i cili ka pasion pjesëmarrjen aktive në jetën politike, duhet ta kenë parasysh se niveli lokal është dera e parë e secilit qytetarë”, tha Krasniqi.

Në UBT u mbajt Konferenca Ndërkombëtare “Building Sustainable IoT Ecosystems”

Qindra të ftuar, profesionistë të teknologjisë nga Kosova dhe bota u mbledhën në Konferencën Ndërkombëtare “Building Sustainable IoT Ecosystems” për të shkëmbyer pikëpamjet e tyre mbi sfidat dhe mundësitë që ofron fusha e IoT në zhvillimin e një qyteti inteligjent dhe të qëndrueshëm në UBT.

Në një bashkërendim, profesorë, studentë dhe udhëheqës të industrisë u përpoqën të gjejnë zgjidhje të qëndrueshme për sfidat që ballafaqohen mjedisi dhe sektori industrial. Energjia e ngrohtë e debateve dhe prezenca e personaliteteve të shquara krijoi një atmosferë frymëzuese për të shkëmbyer ide dhe për të gjetur rrugët më të mira për të përdorur teknologjinë në shërbim të planetit tonë.

Prezantimi i Rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi rreth temës “Implementation of IoT hub and digital twins at UBT smart and self-sustainable city”, përshkroi përdorimin e teknologjisë IoT dhe binarëve digital për të zhvilluar një qytet inteligjent dhe të qëndrueshëm në UBT. Prezantimi u fokusua në implementimin e teknologjisë IoT dhe binarëve digital

në zhvillimin e një qyteti inteligjent dhe të qëndrueshëm në UBT. Sipas Hajrizit, kjo përfshin përdorimin e pajisjeve të sensorëve të lidhura në internet për të mbledhur dhe monitoruar të dhënat në kohë reale nëpër qytet. Përmes përdorimit të binarëve digital, të dhënat janë modeluar dhe simuluar për të krijuar një përfaqësim digital të qytetit. Ky përfaqësim digital lejon për monitorimin dhe menaxhimin efikas të burimeve dhe infrastrukturës në qytetin inteligjent të UBT-së për të ndërtuar një mjedis më të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm.

Prof. Asoc. Dr. Galia Marinova nga Universiteti Teknik i Sofisë në Bullgari, me temën “IoT Green Transformation for Academic Society and Business Oriented Ecosystem in Western Balkans”, diskutoi për ndikimin e teknologjisë së IoT në transformimin e mjedisit në kontekstin akademik dhe në ekosistemin biznesor në Ballkanin Perëndimor. Marinova nxjerr në pah rëndësinë e përdorimit të IoT në përmirësimin e mjedisit, veçanërisht në aspektin e ndryshimeve klimatike dhe qëlli-

meve të zhvillimit të qëndrueshëm. Gjatë prezantimit, Marinova nënvizoi edhe rëndësinë e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane, e miratuar në 2020, si një grup inicativash politike nga Komisioni Evropian për të bërë Bashkimin Evropian neutral ndaj klimës deri në vitin 2050. Plani përfshin rishikimin e çdo ligji ekzistues për të vlerësuar kontributin e tyre në luftën kundër ndryshimeve klimatike, dhe prezantimin e legjislacionit të ri për të promovuar ekonominë rrethore, rinovimin e ndërtesave, biodiversitetin, bujqësinë dhe inovacionin. Sipas Marinovës, tranzicioni i gjellbër kontribuon në realizimin e qëllimeve të Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane. Prof. Terrence Egan në prezantimin e temës “Embedded Systems Programming”, u fokusua në programimin e sistemeve të integruara. Prof. Egan nga Kolegji Shtetëror i Floridës Lindore, analizoi teknikat dhe praktikën për zhvillimin e softuerit për pajisje të përfshira në pajisjet elektronike dhe sistemet e kontrollit të përdorura në shumë fusha, duke përfshirë teknologjitë e lidhura me IoT dhe automjedisin.

Moduli i Xhudos në UBT: Udhëtimi praktik i studentëve në Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë

Studentët e Shkencave të Sportit dhe Lëvizjes dhe të Aktrimit nga Kolegji UBT ishin në Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë, për të realizuar pjesën praktike të modullit të Xhudos që është pjesë e Sporteve Luftarake dhe Luftërave Skenike. Trajneri i mirënjohur Driton Kuka dhe Majlinda Kelmendi, të cilët janë pjesë e stafit në Fakultetin e Shkencave Sportive në UBT, së bashku me xhudistët Olimpikë Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova dhe të tjerët, demonstuan para studentëve tanë teknikat e xhudos

dhe njëkohësisht i mësuar studentët tanë në mënyrë praktike se si realizohen teknikat e rënies dhe mbrojtjeve në xhudo. Studentët të shoqëruar nga profesorët: Agron Thaçi, Masar Xhaka, Abedin Bahtiri dhe Milaim Berisha, patën rastin të njihen me teknikat dhe strategjitë e xhudos nga profesionistët e fushës. Përmes kësaj përvojë, ata jo vetëm që përfutuan njohuri të reja në fushën e xhudos, por edhe ndjeu frymën e bashkëpunimit dhe përkrahjes së ekipit.

Ambasadori i Austrisë në Kosovë, George Schnetzer në një ligjëratë me studentët e UBT-së

Ambasadori i Austrisë në Kosovë, George Schnetzer ishte i ftuari i radhës në ligjëratat e Institutit të Ballkanologjisë në kuadër të Fakultetit të Shkencave Politike në UBT.

Në prezantimin e tij, ai shpalosi me detaje marrëdhëniet e ngushta ndërmjet Kosovës dhe Austrisë, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të tyre në fusha të ndryshme, si politika, ekonomia, arsimit, dhe kultura. Gjatë fjalës së tij, Ambasadori Schnetzer u përqendrua në historinë e miqësisë së thellë midis dy vendeve dhe përparimin e arritur në bash-



këpunimin bilateral. Ai gjithashtu përshëndeti sukseset e Kosovës në procesin e integritimit evropian dhe premtot mbështetjen e vazhdueshme të Austrisë në këtë drejtim. Në këtë kontekst, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, falënderoi Ambasadorin Schnetzer për kontributin e tij në promovimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve. Ai theksoi se Austrisë i takon një vend i rëndësishëm në historinë e Kosovës dhe

Studentët e UBT-së në vizitë studimore në Turqi



Një grup i studentëve të UBT-së, po qëndrojnë për vizitë studimore në Turqi, dhe me këtë rast kanë ata kanë patur rastin të shohin nga afër monumente historike e kulturore të Stambollit dhe më gjerë. Në vazhden e vizitave, ata kanë qenë

në Universitetin "Mimar Sinan", ku janë mirëpritur nga Prof. Hakan Ersiz dhe i cili i ka udhëhequr në një turne frymëzues në departamentet dhe fakultetet e institucionit. Studentët shkëmbyen idetë e tyre mbi konceptet dhe punimet e tyre

me kolegët e tyre, duke pasur një përvojë të frytshme mësimore. Përveç kësaj, studentët ishin të pranishëm në panairin e materialeve, një ngjarje që mbahet çdo vit dhe ku studentët e UBT-së kanë qenë prezent për 12 vite me radhë. Vizita e tyre në Universitetin e Stambollit gjithashtu shënoi një moment të rëndësishëm, pasi ata vizituan universitetin më të vjetër në kryeqytet.

Ata do të vizitojnë gjithashtu edhe Edirnen, më konkretisht Xhaminë e vjetër të Mimar Sinanit. Kjo eksperiencë e pasur kulturore dhe akademike siguron një platformë të rëndësishme për zhvillimin e tyre të ardhshëm.

Profesoreshat e UBT-së, Diana Sejdiu Shala dhe Denis Çelçima, botojnë librin "Mbi Motivimin në Mësimdhënie"



Profesoreshat e UBT-së, Diana Sejdiu Shala dhe Denis Çelçima, kanë botuar librin "Mbi Motivimin në Mësimdhënie" (Studime psiko-pedagogjike në ndihmë të mësuesve në sistemin arsimor Shqipëri-Kosovë). Ky libër u dedikohet të gjithë mësuesve dhe studentëve, sepse përfshin mënyrën se si mund të shndërrohet mësimdhënia në një proces shumë të rëndësishëm për secilin individ dhe shoqërinë. Libri është përpiluar në bazë të studimeve dhe përvojës shumë vjeçare të autoreve në fushën e mësimdhënies. Kjo përvojë ka ndikuar në krijimin

e një përmbledhjeje shkencore mbi rëndësinë e motivimit në mësimdhënie siç është ky libër.

Puna e autoreve të librit, shfaqet si pjesë e përvojës psikologjike dhe pedagogjike, e cila tregon fuqinë e besimit të tyre në atë që duan t'u përcjellin kolegëve dhe lexuesit në shkolla dhe universitete. Përvoja e krijuar në procesin e mësimdhënies, ka ndikuar mjaftueshëm në arritjen e qëllimit.

Mesazhi që përcjell libri është një qasje e re, që duhet të vlerësohet nga institucionet arsimore në Shqipëri dhe Kosovë. Jemi në procesin e reformimit, përballë të cilit kemi detyrimin të kontribuojmë me përvojat tona në revolucionarizimin e procesit të mësimdhënies. Për të arritur këtë kërkohet këmbëngulje dhe besim. Autorët janë përpjekur shumë të sjellin informacione të reja të përvojës kombëtare dhe praktikave ndërkombëtare. Aftësia analitike e fenomeneve dhe dukurive, i ka dhënë librit dimensionin e gjerë profesional. Përveç tjerash, këto përgjithësime në libër do të jenë shumë të dobishme për punëtorët e arsimit dhe studentët.

Ligjëratë tematike për të shënuar muajin për ndërgjegjësimin e spektrit të autizmit



Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për autizmin, Fakulteti i Psikologjisë në UBT organizoi një ligjëratë tematike

me Fatime Sahiti – Bekteshi, specializante e psikologjisë klinike, njëkohësisht udhëheqëse e Klinikës Emos.

Duke u mbështetur në rastet e saj klinike, Fatime Sahiti – Bekteshi solli për studentët përvojën e saj mbi 10 vjeçare në trajtimin e fëmijëve me çrregullime të spektrit të autizmit.

Ajo ndër të tjera, së bashku me dekanen e Fakultetit të Psikologjisë, Prof. Denis Celçima dhe Prof. Violeta Zefi, diskutuan për se afërmi me studentët për çrregullimet e spektrit të autizmit, rëndësinë e ndërhyrjes së hershme të fëmijët e diagnostikuar, si dhe teknikat bashkëkohore të trajtimit.

Delegacioni nga Universiteti "Fan Noli" në Korçë viziton Qytetin e Mençur të UBT-së

Një delegacion nga Universiteti "Fan Noli" në Korçë ka bërë një vizitë zyrtare në kampusin e UBT-së në Lipjan. Delegacioni u mirëprit nga Prorektori i UBT-së, Binak Beqaj, Drejtoresha e Kampusit, Lirigzona Morina, si dhe nga profesorët të UBT-së.

Përfaqësuesit e Universitetit "Fan Noli" u njohën me zhvillimet në ekosistemin inovativ të UBT-së dhe u ofrua një perspektivë e detajuar



për mundësitë e shkëmbimit të vlerave dhe bashkëpunimit e thellë mes dy institucioneve arsimore. Ata u impresionuan nga infrastruk-

tura moderne dhe inkuadrimit e praktikës me teorinë nëpërmjet programeve të avancuara shkencore dhe teknologjike.

UBT shënon prezencën e parë të Kosovës në Festivalin Evropian "Music Beyond Borders" në Bari

Profesori i Klarinetës në Fakultetin Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi në UBT, Blerim Emerllahu, ka qenë pjesë e Festivalit "Music Beyond Borders" në Bari, Itali, me ftesë nga Konservatori i Muzikës "Niccolò Piccinni". Në këtë festival të mbajtur në mesin e një grupi prej 11 shteteve evropiane, e përfaqësuar ishte edhe Kosova me pjesëmarrjen e UBT-së. Gjatë kësaj periudhe, Profesori Emerllahu mbajti disa ligjëratë me



studentët nga e gjithë Evropa, dhe në koncertin final drejtoi orkestren ndërkombëtare të klarinetave. Në këtë koncert u paraqit edhe premiera botërore "Dance", e kompozuar nga Profesori Valton Beqiri. Kjo ishte hera e parë që Kosova bëhet pjesë e një projekti të rëndësishëm evropian si ky, i cili është mbështetur nga Erasmus+.

Stafi i Fakultetit të Gjuhës Angleze në Konferencën "Multilingualism, Innovation and Digitalization in the Light of European Education Policies"

Stafi i Fakultetit të Gjuhës Angleze në UBT, me Dekanen Prof. Alma V. Lama po marrin pjesë në Konferencën "Multilingualism, Innovation and Digitalization in the Light of European Education Policies", që po mbahet në Korçë.

Në fjalën e saj, Prof. Alma V. Lama, i përshëndeti të pranishmit në emër të Rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në veçanti Rektorin e Universitetit të Korçës "Fan S. Noli", Prof. Dhimitri Bello.

"Është kënaqësi e veçantë të jemi sot në mesin tuaj në kuadër të një bash-



këpunimi premtues në mes të UBT-së dhe Universitetit të Korçës "Fan S. Noli", të bashkuar me një përkushtim


të përbashkët për ekselencë akademike, inovacion dhe zhvillim të njohurive", tha Dekania Lama.

Ky partneritet është ndërtuar mbi respektin e ndërsjellë dhe një vizion kolektiv për të përmirësuar përvojat

edukative, për të nxitur hulumtime të jashtëzakonshme dhe për të kontribuar pozitivisht në shkencë.

"Me të gjitha burimet, ekspertizën dhe përvojat unike, ne synojmë dhe besojmë se do të krijojmë sinergji që do t'i shtojnë të dy universitetet drejt horizonteve të reja të suksesit. Ne besojmë se nëpërmjet këtij bashkëpunimi, ne do të ndërtojmë ura lidhëse që do të përfitojnë jo vetëm institucionet tona, por edhe komuniteti akademik global", potencoi Dekania Lama.

UBT në vitin 2024





Në UBT u mbajt ceremonia e diplomimit të gjeneratës së parë të maturantëve të Shkollave të Mesme

Me një atmosferë të mbushur me emocione, krenari dhe pozitivitet, në UBT u mbajt ceremonia e diplomimit të gjeneratës së parë të maturantëve të Shkollave të Mesme të UBT-së.

Në praninë e Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Drejtoreshës së Shkollave të Mesme të UBT-së, Hajrije Devetaku, prindërve, familjarëve, miqve dhe profesorëve, maturantët e gjeneratës së parë diplomuan dhe shënuan përfundimin e një kapitulli të rëndësishëm edukativo-arsimor.

Në fjalën e tij, Rektori Hajrizi uroi maturantët për sukseset e tyre, duke theksuar rëndësinë e përkushtimit dhe punës së palodhshme që kanë treguar gjatë viteve të shkolimit. Ai gjithashtu nënvizoi rolin e rëndësishëm që UBT ka luajtur në formimin e tyre akademik dhe profesional, duke siguruar një mjedis të favorshëm për zhvillimin e aftësive dhe talenteve të tyre.

“Është nder dhe privilegj që të qëndrojmë para jush, një gjeneratë e cila me



përkushtim të madh ka arritur që sot të ketë një momentum të veçantë. Këtë vit Kosovës i shtohet një gjeneratë me kompetenca dhe aftësi. Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe procese e individ që na kanë mbështetur për të realizuar këtë momentum, prandaj dëshirojmë që t'i falënderojmë të gjithë ata që kanë kontribuar në mënyrë direkte apo indirekte në

suksesin tuaj. Diplomimi nuk është vetëm një moment reflektimi për të kaluarën, por edhe një moment pritjeje për të ardhmen”, potencoi Rektori Hajrizi.

Drejtoresha Devetaku shprehu mirënjohjen e saj ndaj prindërve dhe profesorëve për mbështetjen dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm, që kanë kontribuar në arritjen

e këtij momenti të rëndësishëm. Ajo inkurajoi maturantët të vazhdojnë të ndjekin ëndrrat e tyre dhe të mos ndalen kurrë së kërkuari njohuri dhe përvoja të reja.

“Në përmbyllje të këtij cikli të shkolimit tuaj, përkatësisht përfundimit të maturës, është koha për të menduar për fillimin e një cikli të radhës, për t'i ndjekur ëndrrat e juaja të cilat

janë vërtet reale dhe të arritshme. Krejt çka duhet të bëni është që t'i bashkoni ambicidet, këmbënguljen dhe pritshmëritë e juaja në interes të vizionit se ku do të jeni pas 10 viteve, si do të arrini atje dhe çfarë do të bëni”, u shpreh ajo.

Ceremonia vazhdoi me ndarjen e certifikatave dhe shpërblimeve për maturantët e dalluar, të cilët u vlerësuan për arritjet e tyre të jashtëzakonshme në fusha të ndryshme. Prindërit dhe familjarët përjetuan momente emocionuese teksa shikonin fëmijët e tyre duke marrë diplomat, një dëshmi e punës dhe përkushtimit të tyre ndër vite.

Kjo ngjarje shënoi një pikë të rëndësishme në historinë e Shkollave të Mesme të UBT-së, duke dëshmuar përkushtimin e institucionit për ofrimin e arsimit cilësor dhe përgatitjen e gjeneratave të ardhshme për sfidat e jetës dhe karrierës.

Në UBT u organizua një debat diskutimi për sigurinë në komunikacionin rrugor



Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (Ndërtimtari dhe Infrastruktura) në UBT organizoi një debat të rëndësishëm diskutimi rreth sigurisë në komunikacionin rrugor, duke mbledhur ekspertë vendorë, profesorë dhe studentë për të trajtuar këtë çështje jetike.

Debati u hap nga Dekani i Fakultetit Inxhinierisë së Ndërtimit (Ndërtimtari dhe Infrastruktura) në UBT, Visar Krelani, i cili falënderoi të pranishmit për prezencën dhe theksoi

nevojën e zhvillimit të diskutimeve të tilla në nivele akademike.

Në panelin e diskutimit morën pjesë profesori i UBT-së, Nol Dedaj, Togër nga Policia e Kosovës, Nazim Zogaj dhe ligjëruesi Visar Baxhuku, të cilët ndanë njohuritë dhe përvojat e tyre mbi tematika të ndryshme që lidhen me sigurinë rrugore.

Debati përfshiu tema të tilla si teknologjitë e reja për përmirësimin e sigurisë rrugore, sfidat aktuale në menaxhimin e infrastrukturës rru-

gore dhe masat që mund të merren për të reduktuar aksidentet rrugore në Kosovë.

Ngjarja tërhoqi një audiencë të gjerë, përfshirë studentë, profesorë dhe profesionistë të fushës, të cilët patën mundësinë të diskutojnë dhe të ndajnë ide për zgjidhjen e problemeve që ndikojnë në sigurinë e trafikut rrugor. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e edukimit të vazhdueshëm dhe ndërgjegjësimit publik për të përmirësuar standardet e sigurisë në rrugët tona.

UBT vazhdon të jetë një qendër e rëndësishme për diskutimin dhe zgjidhjen e çështjeve kyçe që prekin komunitetin dhe shoqërinë në tërësi, duke përfshirë edhe sigurinë në komunikacionin rrugor. Ky debat shënon një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të kushteve të sigurisë në rrugët e Kosovës dhe promovimit të një kulture të re përgjegjësie në komunikacion.

Në UBT u bë hapja e Laboratorit të Forenzikës



Në kuadër të Kongresit të Tretë Kosovë - Turqi, në UBT u bë hapja e Laboratorit të Forenzikës, që shënon një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të kapaciteteve të kërkimit shkencor në Kosovë.

Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ishte i pranishëm për të shënuar këtë moment historik, krahas personaliteteve të shquara si Prof. Dr. Irfan Karadede nga Universiteti Izmir Katip Çelebi, Prof. Dr. Sevinç Polat nga Universiteti Yozgat Bozok, si dhe Prof. Dr. Ilirjan Mandro, Rektor i Akademisë së

Sigurisë së Shqipërisë. Në mesin e të pranishmëve ishin edhe personalite eminente nga fusha e drejtësisë dhe politikës, si Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, Zëvendësministri në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, Ali Tafarishku, dhe Ambasadori i Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili.

Në këtë moment të rëndësishëm, Udhëheqësi i Bordit Shkencor të Institutit të Forenzikës në UBT, Arsim Gërxhaliu, u shpreh mbi rëndësinë e këtij laboratorit për përpunimin e fushës së forenzikës në vend.

Në një ceremoni madhështore në UBT, u bë hapja e Kongresit të Tretë të Forenzikës Kosovë - Turqi

Një ngjarje e rëndësishme për fushën e drejtësisë u shënuar në UBT, ku u zhvillua me sukses hapja e Kongresit të Tretë të Forenzikës Kosovë - Turqi. Në hapjen e këtij kongresi morën pjesë personalitete të rëndësishme, si Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe përfaqësues si Prof. Dr. Irfan Karadede nga Universiteti Izmir Katip Çelebi, Prof. Dr. Sevinç Polat nga Universiteti Yozgat Bozok, si dhe Prof. Dr. Ilirjan Mandro, rektor i Akademisë së Sigurisë së Shqipërisë. Ndër të pranishmit ishin edhe figura të rëndësishme të drejtësisë dhe politikës si Kryeprokurori i shtetit, Besim Kelmendi, Zëvendësministri në Ministrinë e

Zhvillimit Rajonal, Ali Tafarishku, dhe Ambasadori i Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angili.

Në një fjalë rasti para të pranishmëve Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi tha se ky është mesazh që forenzika është një ekosistem në të cilin duhet të ndërlihdhen të gjitha palët e interesit si në nivel kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

“Kjo traditë e cila ka ndodhur edhe njëherë paraprakisht që të mbahet mes Kosovës dhe Turqisë, të vazhdojë si format tradicional për të vazhduar me kongrese të tilla edhe në vitet tjera në Kosovë, në Turqi dhe mendojmë që në të ardhmen të vendosen edhe shtetet tjera fqin-



je sikurse Shqipëria, që të krijojmë kështu një miqësi të mirë. Mendoj se shkenca e Forenzikës është një dimension shumë interesant dhe kompleks. Ka edhe një ndërlidhje apo më mirë të themi një ndikim edhe nga teknologjitë e reja që po zhvillohen tash e tutje. Dhe nga ky kompleksitet dhe ky nivel kërkohet edhe një qasje

më e madhe akademike dhe shkencore, dhe një qasje edhe më e mirë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në nivelin nacional dhe ndërkombëtar, në mënyrë që ne të krijojmë metoda më të mira, qasje më të mira, vegla më të mira, involvim të teknologjive të avancuara sa më mirë dhe sa më lehtë, në mënyrë që cilë-

sia e shërbimeve dhe i gjithë spektri i Forenzikës, të trajtohet apo punohet sa më mirë”, deklaroi Rektori Hajrizi. Kongresi synon të shërbejë si platformë për ndarjen e njohurive dhe përvojave të fundit në forenzikë, duke përfshirë teknikat më të reja të analizave kriminalistike.

Studentët e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT organizojnë Panairin e Ushqimit në Prizren

Studentët e Fakultetit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT kanë organizuar me sukses Panairin e Ushqimit në Prizren. Ky panair, i cili u mbajt në ambientet e ITP-së, mbledhi së bashku studentë,

profesorë, dhe profesionistë të industrisë së ushqimit për të ndarë njohuritë dhe inovacionet më të fundit në fushën e shkencave ushqimore dhe bioteknologjisë.

Gjatë panairit, vizitorët patën mundësinë të shihonin dhe të

vlerësojnë një gamë të gjerë produktesh ushqimorë të përgatitura nga vetë studentët. Produktet e prezantuara përfshinin ushqime tradicionale, të cilat demonstuan aftësitë praktike dhe krijimtarinë e tyre në fushën e përpunimit të

ushqimit dhe zhvillimit të bioteknologjisë.

Ky aktivitet ishte një mundësi e shkëlqyer për studentët që të prezantojnë punën e tyre para një audience më të gjerë dhe të krijojnë

lidhje me profesionistë të sektorit. Profesorët e pranishëm vlerësuan lartë përkushtimin dhe punën e palodhur të studentëve, duke theksuar rëndësinë e aktivitetëve të tilla në zhvillimin profesional dhe personal të tyre.

U promovohet libri “Gazetaria Online në Kosovë dhe në rajon, etika dhe sfidat e vetërregullimit”, i autorit Musa Sabedini

Me praninë e rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, profesorëve, studentëve, miqve dhe familjarëve, profesori, autori, gazetari dhe publicistit, Musa Sabedini, promovoi librin voluminoz “Gazetaria Online në Kosovë dhe në rajon, etika dhe sfidat e vetërregullimit”, i cili është një libër profesional dhe kryesisht trajton gazetarinë online, etikën dhe sfidat e vetërregullimit.

Rektori Hajrizi foli rreth rëndësisë së botimit të librave të tillë profesional dhe akademik, si dhe dha perspektivën e tij mbi integrimin e inteligjencës artificiale në gazetari.

“Marrë parasysh kohën e teknologjisë dhe të digitalizimit duhet të diskutojmë më thellë për këtë tematikë, ku në bazë të fokusit shihet se nuk ka shumë botime në drejtim të mediave online. Edhe pse në Kosovë kemi mbi 400 portale, në një mënyrë ose tjetër, ky koncept, ose ky libër do të shërbejë për të bërë një punë më të përgjegjshme”, ka thënë Rektori Hajrizi.

Dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Ferid Selimi, në fjalën e tij përgëzoi autorin për guximin dhe vullnetin për t'u marrë me krijimtari të tillë, e cila mund të jetë shpesh sfiduese. “E përgëzoj për guximin që ka autori dhe profesori Musa Sabedini, për t'u marrë me krijimtari të tillë. Të merresh me krijimtari apo hulumtime rreth problematikave të shumta është një çështje e ndërlikuar dhe profesori nuk po heziton asnjëherë”, është shprehur Selimi.

Recensenti Safet Zejnullahu tha se libri do të mbulojë një boshllëk të madh në studimet rreth medias së internetit në Kosovë.

“Libri “Gazetaria online në Kosovë dhe në rajon, etika dhe sfidat e vetërregullimit”, i autorit Musa Sabedini, do të mbulojë një boshllëk të madh në studimet rreth medias së internetit në Kosovë. Përveç materialit i duhur për studentët e gazetarisë, ky libër do të shërbejë si bazë e mirë edhe për studimet e ardhshme në këtë fushë”, tha Zejnullahu.

Për librin folën edhe profesori Adnan Merovci dhe Bejtush Gashi, të cilët përgëzuan autorin dhe u shprehën se fusha e gazetarisë ka nevojë për botime të tilla për t'u zhvilluar në mënyrën e duhur. Profesori, gazetari, publicisti, autori i librit “Gazetaria Online në Kosovë dhe në rajon, etika dhe sfidat e vetërregullimit”, Musa Sabedini, kalënderoi të gjithë të pranishmit në këtë promovim të këtij libri, njëherit rektorin e UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizin, dekanin e Fakultetit Media dhe Komunikim, Ferid Selimi, recensenti Safet Zejnullahu, duke besuar se ky libër do të jetë gjatë dhe do të shërbejë shumë për studentët, gazetarët dhe profesionistët e medias.

“Gazetaria Online në përgjithësi është një zhanër, që ka shumë sfida e telashe profesionale, të papritura, të panjohura dhe bukur delikate. Ata që nuk e kanë provuar, peshën e kësaj zeje dhe se kanë përjetuar rëndësinë që ka, e kanë të vështirë dhe të pamundur, madje të flasin apo debatojnë hapur për këtë zeje,



tashmë fort të aktualizuar. Libri po vije si rezultat i njohjes së thellë, i përjetimit shpirtëror të botës digjitale dhe online, që sjell ky risk, sa delikat e sfidues, aq edhe i shpejt dhe dobiprurës për botën bashkëkohore”, tha Sabedini.

Ai tutje tha se libri ka për qëllim të shpërfaq të mirat, anëtarë negativë, anëtarë pozitivë që krijon ky gjigant brilant, që po depërton në çdo qenie krijuese, për shkak të shpejtësisë marramendëse, që ka dhe depërtimit në botën dhe intelektualin e çdo njeriu.

Libri ka 493 faqe ndërsa botues është UBT.

Libri “Gazetaria online në Kosovë dhe në rajon, etika dhe sfidat e vetërregullimit”, ka për synim t'i mësojë dhe edukojë jo vetëm studentët, por të gjithë ata që duan të jenë pjesë, e këtij rrjeti profesionistësh, që kanë përzgjedhur t'i përshtaten kodeve të etikës dhe standardeve profesionale të raportimit online. Libri andaj merret, me të arriturat në këtë fushë, me përdorimin e uebsajtave të rinj dhe mundësinë, që ata kanë të punojnë, në këtë fushë, pa shpenzuar shumë.

Në Kapitullin e parë libri trajton historinë fillimisht të lindjes së gazetarisë online – digjitale, kompleksitetin e saj në kuptimin funksional dhe praktik, për teletekstin, videotekstin, për epokën elektronike dhe dixhitale, për gjuhën e përdorur në internet, për inovacionin dhe gazetarinë online, për lindjen e internetit që ka shpejtuar zhvillimin e mediave online ose mediet e reja, për World Wide Web, për web faqet, për internetin sot, për web 2.0, për strukturën e Web-it, për përmasat e World Wide Web, për Web 3.0, për internetin dhe raportimi për web, për stilin e të shkruarit në median online – web, për digitalizimin e mediave që solli ndryshime të rëndësishme edhe për profesionin e gazetarisë, për terminologjinë e re për median online, për karakteristikat, dhe parimet e Gazetarisë Online, për përparësitë dhe mangësitë e gazetarisë online, për disavantazhet dhe mungesat e fokusit në gazetari cilësore, për të ardhmen e mediave online, për standartet e reja të raportimit në gazetarinë

online, për portalet dhe lexuesit atraktiv tek portalet, për artikullin Online dhe standartet e raportimit, për periudhën e vërtetë të gazetarisë online, për gazetaria online e cila kërkon besnikëri, saktësi, korrektesë dhe paanshmëri, për historinë e Gazetarisë Online, për Google, Yahoo, Hotmail, Facebook, Twitter, Instagram, Tik Tok, për bullizmin kibernetik, për websitet individuale të lajmeve, për krijimin e blogjeve, për ndikimin e mediave sociale në blog, për portalin, përkufizimin dhe përgjegjësin, për rolin e administruesit të faqes në portal, për dizajnin dhe uebsajtet e lajmeve ditore, për reklamimi online – dhe ndikimin e tyre në gazetarinë online, për rolin e reklamës në tregun mediatic dhe në raportim, për artikullin e sponsorizuar, përkufizimin, karakteristikat dhe dizajnin, për rrezikun nga sulmet kibernetike etj.

Kurse në Kapitullin e dytë gjithash-tu, kam trajtuar gjithçka që dihet mbi gazetarinë online, në Kosovë dhe rajon, për median online, që është trend i zhvillimeve të mediave në tërë botën, për websitet e para në Kosovë dhe kush konsiderohet nxitës i gazetarisë online, për lindjen e gazetarisë online në Kosovë dhe pse nuk dihet numri i saktë i portaleve, për gjendjen e portaleve dhe organizimin e brendshëm të mediaveve online në Kosovë, për faktin se a dihen dhe kush janë pronarët e portaleve në Kosovë, për transparencën e pronësisë së mediave në Kosovë, për portalet e vetëshpallura, të cilat vuajnë nga mungesa e profesionalizimit, për portalet në Kosovë, dëshmi dhe fakte, për portalet kryesore në qytetet e Kosovës, për ombrellën e gazetarisë online – KMSHK, dhe çfarë duhet të dinë qytetarët në ankesat ndaj portaleve, për rregullat e procedurës së KMSHK, për ankesat e pranuar për shkeljet e Kodit të Etikës, për marketingun në portale, për financimin e mediave online, që është problemi më i madh në Kosovë, për gazetarinë qytetare, mediat sociale dhe platformat e tyre, për përparësitë dhe mangësitë e gazetarisë qytetare, për mediet sociale, rrjetet sociale, ose

mediat e gjeneratës së re, për rrjetet më të mëdha sociale në shifra, për mediat sociale dhe momentet e bukura, për zhvillimin e gazetarisë online në rajon, në Shqipëri, Serbi, Maqedoni e Mal të Zi, për uebsajtet individuale më të klikuara në Shqipëri, për portalet dhe mediet online, më me ndikim në Shqipëri, për vetërregullimin e mediave online në Shqipëri, për mediat Online në Bujanoc e Preshevë etj.

Kurse në Kapitullin e tretë kam trajtuar shqetësimet kryesore me të cilat preokupohet Gazetaria Online në Kosovë, duke filluar nga etika, vetërregullimi dhe sfidat, për integritetin dhe gazetarinë e pavarur, për etikën e gazetarisë, përkufizimin, historinë dhe rëndësinë e saj për mediet, për Kodin e Etikës së Gazetarisë, për ndershmërinë e gazetareve që është kategori e cila kërkohet në mënyrë ultimative, për rëndësinë thelbësore të kodit të etikës për një gazetari të përgjegjshme, etikën e medias digjitale, problemet e veçanta etike, për praktikën dhe normat, për paanshmërinë, konfliktet e interesit dhe gazetarinë partiake, për etikën dhe legjislacionin në Kosovë, për rregulloret dhe ligjet për mediat në Kosovë, për ligjet mbi lirinë e informimit në Ballkan, dhe si prezantohet Kosova, për lirinë e shprehjes, për të drejtat e gazetareve, siguria e tyre dhe mbrojtja e lirisë së medias, mëdyshjet e gazetarisë në teren, për vetërregullimin për median online, lajmet e ngutshme dhe të pa verifikuara, për gazetarinë e “like”-ve që po e dëmton gazetarinë profesionale dhe shoqërinë, për gabimet dhe joshjen nga portalet kosovare, për efektet e pëlqimeve, në perceptimin e opinionit publik dhe opinionin personal, për shpifjen dhe fyerjen, për ligjin për shpifjen në internet dhe mediat sociale, nga këndi i avokatëve ndërkombëtar, për identifikimin e shpifjeve në internet, për gjuhën e urrejtjes, lajmet e rreme, dezinformimin dhe keqinformimin në mediet online në Kosovë, për vendosjen e aksesoreve për rrjetet sociale dhe lajmet e rreme, për bullizmin në Tik Tok, nga gjuha e urrejtjes deri tek tragjedia, për sfidat e medias online në Kosovë

që janë të shumta, dhe cilat janë sugjerimet profesionale, për plagjiaturën, copy – paste, për të drejtat e autorit të mbrojtura nga ligjet, për transparencën e munguar të medias online në Kosovë, për risitë dhe kërkesat e gazetarisë online, për censurën dhe vet censurën tek gazetarët kosovar, për gazetarët kosovar, që punojnë pa kontrata pune, për Intelligjencën Artificiale dhe sfidat ndaj gazetarisë online etj.

Libri është edhe më i dobishëm, në një kohë kur në Kosovë e rajon ekzistojnë qindra portale, uebsajte, rrjete sociale e media tjera online, që veprojnë në mënyrë ligjore, e jo ligjore, me respektim të etikës, e me shkelje ekstreme të saj. Ky libër nuk do të kishte vlerë profesionale, nëse nuk do e trajtonim me kujdes edhe vetërregullimin e portaleve në Kosovë, ose median digjitale, nga e cila më së shumti dëmtohet ose mund të pësojë dëme ligjore vet lexuesi i saj.

Libri rrëfen edhe për njohurit e shumta profesionale, që ndërliken me standartet e raportimit dhe kriteret që duhet të kenë, lajmet e shumta të plasura në publik. Me kujdes andaj në libër është shkruar edhe për të gjitha prapaskanat e këtij digasteri problematik dhe tejet misterioz, që në fakt as media, e gazetar me përvojë të gjatë, e kanë të vështirë të japin definicione, e vlerësime për të kuptuar e drejtë dhe të qartë, mbi rolin që duhet të ketë media online.

Libri pashmangshëm pasuron këtë gjuhë goditëse, pasuron mënyrën e komunikimit në raport me publikun, pasuron gazetar, redaktor e botues të portaleve, të cilët edhe mund të përfitojnë nga njohurit shkenore, e studimore të prezantuar mjeshtërisht në këtë libër, me literaturë të kompletuar dhe krahasuese me vendet e rajonit. Një pjesë e librit i kushtohet edhe gjendjes së mediave online, në Maqedoni e Shqipëri, për të parë dallimet në funksion të ekzistimit dhe përvojave që kanë këto shtete fqinje.

Kuptohet që nuk pretendojmë të jemi fundi i këtij studimi ose prezantimi, sepse nuk mund ta dimë asnjëherë rrëfimin, pas 20 viteve të avancimit të kompjuteristikës, e cila pritet të sjell avancime, e risi edhe më të mëdha në fushën digitalizues, e ku pashmangshëm bëjnë pjesë edhe mediet online, por shpresoj dhe mendoj, se libri është një ndihmesë dhe një shtytje për ata studiues të rinj, që e duan dhe e përjetojnë të bërit realitet Gazetarinë Online, me kriteret, me standarde dhe etikë të avancuar.

Të gjithë këta kapituj në vete përmbajnë dilema dhe shqetësime të shumta profesionale, të cilat i kuptojnë dhe mund t'i zgjidhin apo përjetojnë, vetëm ata që e kanë provuar në kurrizin e tyre të jetuarit, me orë të tëra mbi laptopin inteligjent, që aq sa na gëzon, e lumturon, po aq na shkakton edhe telashe, stresse e sfida, gjatë praktikimit të gazetarisë online.

Profesoreshat e UBT-së përfunduan me sukses shkëmbimin e stafit, përmes Erasmus +, në Universitetin Linnaeus në Suedi

Profesoreshat e UBT-së, gjegjësisht Dekania e Fakultetit Gjuhë Angleze, Prof. Dr. Alma Lama dhe Prof. Eglantina Bilalli, kanë përfunduar me sukses shkëmbimin e stafit, përmes Erasmus +, në Universitetin Linnaeus në Suedi.

Ky shkëmbim ka qenë një përvojë e frytshme dhe e rëndësishme për të dy institucionet, duke sjellë përparime të rëndësishme në fushën e arsimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Profesoresha Alma Lama ka thënë se ky bashkëpunim është një mundësi ideale për stafin e UBT-së dhe stafin e Universitetit Linnaeus të hulumtojnë praktikën dhe metodologjinë e arsimit në një mjedis tjetër kulturor.

“Ky bashkëpunim është një mundësi ideale për stafin e UBT-së dhe stafin e Universitetit Linnaeus të hulumtojnë praktikën dhe metodologjinë e arsimit në një mjedis tjetër kulturor, si dhe të ndajnë njohuri dhe të krijojnë lidhje të reja profesionale”, ka thënë Lama.

Ligjëratat dhe metodat e vlerësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie u vlerësuan shumë dhe kishte mundësi për bashkëpunime me fakultete të tjera, si: Psikologjia, Arti dhe Muzika.

Përfundimi i këtij programi ka krijuar mundësi për njohjen e kulturave dhe metodave të ndryshme të punës në arsim, si dhe ka përforcuar lidhjet midis dy institucioneve.

Ambasadorja e Kroacisë në Kosovë, Danijela Barišić zhvilloi një ligjëratë tematike me studentët e UBT-së

Në UBT, qëndroi për vizitë Ambasadorja e Kroacisë në Kosovë, Danijela Barišić, e cila në kuadër të sesioneve të Institutit të Ballkanologjisë, zhvilloi një ligjëratë tematike me studentët e Shkencave Politike.

Tema e ligjëratës ishte “Rruga e Kroacisë drejt Integritimit Euroatlantike”, një temë e cila përqendrohet tek pesha e bashkëpunimit rajonal dhe në sfidat që vendet e Ballkanit përballen në rrugën drejt anëtarësimit në strukturat euroatlantike.

Ambasadorja Barišić ndau përvojën dhe perspektivën e Kroacisë në këtë rrugë të gjatë dhe sfiduese, duke dhënë një shpresë dhe frymëzim të veçantë për studentët që po përballen me studimin e temave



të tilla të rëndësishme. Ngjarja shfaqti edhe lidhjet në mes dy vendeve Kosovë dhe Kroaci, dhe gjithashtu përmirësoi njohuritë dhe ndërgjegjësimin e studentëve për sfidat dhe mundësitë që ofrojnë proceset e integritimit euroatlantik.

Gjatë këtij semestri Instituti ka planifikuar ligjëratat e tjera për tema të ndryshme, duke ofruar emra të rëndësishëm nga fushat e shkencës, diplomacisë, politikës dhe publicistikës.

Dita e shijes

UBT dhe Chef Christophe bashkohen për kulinari

Në një ngjarje të veçantë për studentët e programit të Shkencës së Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, Chef Christophe organizoi një trajnim intensiv dhe kreativ në kulinari. Ky trajnim ofroi një mundësi të shkëlqyer për studentët për të përmirësuar aftësitë praktike dhe për të thelluar njohuritë në gatimin profesional. Chef Christophe, i njohur për ekselencën e tij në kuzhinë dhe përkushtimin ndaj arsimit, udhëhoqi studentët në një udhëtim gastronomik, duke përfshirë teknika të avancuara gatimi dhe krijimin e pjatave me shumë shije.

Studentët punuan në grupe, zhvilluan pjatat e tyre nën mbikëqyrjen e Chef Christophe, duke aplikuar teorinë në praktikë dhe inkurajuar



kreivitetin dhe bashkëpunimin. Në fund, një degustim i pjatave të përgatitura u organizua në KinoAr-

mata, ku Chef Christophe vlerësoi kreivitetin dhe përkushtimin e studentëve. Ai theksoi se këto cilësi

janë thelbësore për suksesin në industrinë e ushqimit. Ky trajnim forcoi lidhjen mid-

is arsimit dhe praktikës, duke ndihmuar studentët të ndjehen të sigurt dhe të përgatitur për sfidat e ardhshme në karrierën e tyre. UBT vazhdon të jetë një lider në ofrimin e mundësive edukative, duke angazhuar profesionistë të njohur për të kontribuar në zhvillimin e brezave të rinj në fushën e ushqimit dhe bioteknologjisë.

Në përfundim, trajnimet si ky janë të rëndësishme për avancimin e arsimit profesional dhe përgatitjen e studentëve për të qenë të suksesshëm në një industri gjithnjë e më konkurruese. UBT mbetet e angazhuar për të ofruar përvoja që ndihmojnë në formimin e profesionistëve të ardhshëm të ushqimit dhe bioteknologjisë.

UBT organizon punëtori për fuqizimin e vajzave të komunitetit REA përmes leadershipit dhe edukimit



Instituti për Zhvillimin e Edukimit dhe Çështjeve Akademike (IDEAA), që vepron në kuadër të UBT-së, ka organizuar një punëtori të suksesshme me temën "Udhëheqja dhe Leadershipi", e cila ishte e dedikuar posaçërisht për vajzat e komunitetit REA (Romë, Egjiptian dhe Ashkali). Kjo punëtori, e udhëhequr nga Prof. Dr. Deniz Çelçima, është një dëshmi e qartë e përkushtimit të UBT-së për të avancuar përfshirjen sociale dhe mbështetjen ndaj grupeve të marginalizuara të shoqërisë, duke fokusuar vëmendjen në fuqizimin e vajzave përmes edukimit dhe zhvillimit të aftësive të leadershipit.

UBT, nëpërmjet Institutit IDEAA, ka bërë të mundur krijimin e një platforme të rëndësishme për të promovuar barazinë gjinore dhe për të ofruar mundësi të barabarta për zhvillim personal dhe profesional. Ky aktivitet është pjesë e përgjegjësisë

sociale të institucionit, duke synuar fuqizimin e vajzave dhe grave të komunitetit REA, të cilat përballen me vështirësi të shumta në rrugën e tyre drejt zhvillimit dhe suksesit. Përmes kësaj punëtorie, pjesëmarrëset patën mundësinë të pajisen me njohuri të reja dhe aftësi praktike në fushën e leadershipit, që do t'i ndihmojnë ato jo vetëm në jetën e përditshme, por edhe në karrierat e tyre profesionale. Punëtorja ishte e strukturuar në mënyrë të tillë që të adresonte sfidat specifike me të cilat përballen vajzat e komunitetit REA në aspektin e udhëheqjes dhe vendimmarrjes. Përmes diskutimeve, trajnimeve dhe shembujve të suksesit, pjesëmarrëset u inkurajuan të ndërtojnë besimin e tyre dhe të marrin një rol më aktiv në udhëheqjen e komuniteteve të tyre. Prof. Dr. Deniz Çelçima, me përvojën e saj të gjerë në këtë fushë, ndau njohuri të vlefshme mbi rolin e

leadershipit efektiv dhe si ky mund të ndikojë pozitivisht në shoqëri.

Ky aktivitet është një pjesë e rëndësishme e përpjekjeve të UBT-së për të krijuar një mjedis më të barabartë dhe më të drejtë për të gjithë, duke ofruar mundësi për t'u pajisur me aftësi dhe njohuri që ndihmojnë në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë. Përveç trajnimit mbi leadershipin, punëtorja ofroi edhe një platformë për rrjetëzim, ku pjesëmarrëset patën mundësinë të ndajnë përvojat e tyre dhe të krijojnë lidhje të reja që mund t'i ndihmojnë në rrugën e tyre të zhvillimit personal dhe profesional.

UBT mbetet e përkushtuar për të ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe për të fuqizuar grupet e marginalizuara përmes edukimit cilësor dhe përfshirjes sociale.

Profesorët e UBT-së prezantojnë punime rreth inovacionit energjetik dhe teknologjik në Kosovë në konferencën ICONST EST



Në konferencën ndërkombëtare ICONST EST, e cila u mbajt në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës, morën pjesë profesorë të njohur nga UBT. Prof. Vehbi Sofu ishte kryesues i një prej sesioneve kryesore të konferencës, ndërsa Prof. Armend Ymeri dhe Prof. Nexhmi Krasniqi prezantuan punime shkencore në fusha me rëndësi të madhe për zhvillimin teknologjik dhe energjetik.

Punimet e prezantuara nga profesorët përfshinin tema të rëndësishme si tranzicioni i energjisë inteligjente ("Smart Energy Transition"), vlerësimi i kapacitetit të sistemeve fotovoltaike për një

sistem ujitjeje të vetëqëndrueshëm në Kosovë, dhe modeli efektiv i transformimeve Laplace për kontrollin e frekuencës në sistemet teknike. Këto punime theksojnë përkushtimin e UBT-së për të sjellë inovacione dhe zgjidhje të reja në sektorët kyç të teknologjisë dhe energjisë, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës dhe më gjerë.

Konferenca ICONST EST mbledhi akademikë dhe studiues nga vende të ndryshme, duke krijuar një platformë për shkëmbimin e njohurive dhe ideve rreth zhvillimeve të fundit teknologjike dhe shkencore.

Maturantë të shumtë nga e gjithë Kosova vizituan Qytetin e Mençur të UBT-së



Maturantë të shumtë nga e gjithë Kosova u bënë bashkë sot në Qytetin e Mençur të UBT-së në Lipjan, në kuadër të ditëve të Programit Përgatitor të Maturës 2024.

Mbi 10 mijë maturantë po trajnohen nga ekspertë të fushave të ndryshme në UBT, me qëllim që të përgatiten sa më mirë dhe të arrijnë rezultate të larta në testin e maturës.

UBT organizoi takim pune me ekspertin e deleguar nga BE për njohjen e kualifikimeve profesionale të arkitektëve nga Kosova



Në kuadër të procesit të njohjes së kualifikimeve profesionale dhe licencimit të arkitektëve nga Kosova në Bashkimin Evropian, UBT organizoi një takim të rëndësishëm pune me Prof. Dubravko Bačić, ekspert i deleguar nga BE dhe profesor në Universitetin e Zagrebit. Ky takim kishte si synim të kontribuojë në

avancimin e njohjes së kualifikimeve profesionale të arkitektëve kosovarë në tregun evropian. Takimi i parë u zhvillua me pjesëmarrjen e strukturave udhëheqëse të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Dekanan e Fakultetit të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës "Hasan Pr-

ishtina", përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, si dhe përfaqësues të Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës. Në këtë takim u diskutua rreth cilësisë së programeve të studimeve të arkitekturës në Kosovë dhe lidhjes së tyre me tregun e brendshëm dhe të jashtëm të punës për arkitektët, si dhe procesit të licencimit.

Takimi i dytë, i karakterit bilateral, u mbajt me Prof. Dubravko Bačić dhe Dekanin të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Prof. Binak Beqaj. Në këtë takim u diskutua rreth zhvillimeve dhe sukseseve të Fakultetit të Arkitekturës në UBT, si dhe mundësive të bashkëpunimit mes UBT-së dhe Universitetit të Zagrebit, duke përfshirë fakultetet e arkitekturës të dy institucioneve.

Në UBT mbahet Konferenca për Leadership - fokusi kryesor në leadershipin e grave dhe integrimin e minoriteteve

Në Parkun Shkencor, Teknologjik dhe Inovativ të UBT-së në Lipjan u mbajt Konferenca për Leadership, me temën qendrore: "Thyerja e Barriera: Leadership i Grave dhe Integrimi i Minoriteteve". Konferenca mbledhi personalitete të njohura nga fusha akademike dhe politike për të diskutuar mbi rëndësinë e leadershipit dhe integrimin e minoriteteve.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi; ish-presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga; Zëvendëskryeministria Emilija Rexhepi; profesori nga Universiteti i Harvardit, Dr. Ronald Heifetz, profesori Faton Limani, dhe shumë të tjerë.

Në hapje të konferencës, Prof. Dr. Edmond Hajrizi theksoi rëndësinë e fuqizimit të pozitës së gruas nëpërmjet edukimit cilësor dhe fuqizimit ekonomik.

"UBT është munduar të instalojë politikën e forcimit të pozitës së gruas përmes ofrimit të edukimit cilësor dhe fuqizimit ekonomik të tyre. Si UBT gjithmonë i kemi kushtuar



rëndësi të madhe angazhimit të gruas dhe si rezultat i këtij përkushtimi, ne sot fatmirësisht rezultojmë të jemi institucioni i parë me numrin më të madh të grave të punësuar në rajon, dhe atë, të gjitha në pozita udhëheqëse", tha Rektori Hajrizi.

Ish-presidentja Atifete Jahjaga tha, "Është gjithmonë kënaqësi të ndaj këtë përvojë shumëvjeçare me njerëz të vendit tim si dhe me rininë e mrekullueshme të Kosovës. E ardhmja le të jetë e përbashkët, e të gjithëve. Në Kosovën e të gjithëve

ka vend për të gjithë dhe ky është vizioni ynë për të ardhmen". Ajo theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe përfshirjes së të gjitha grupeve në ndërtimin e një shoqërie më të barabartë dhe të drejtë.

Profesori nga Universiteti i Harvardit, Dr. Ronald Heifetz, në fjalën e tij tha se leadershipi është kyç për përparimin shoqëror dhe ekonomik. Është thelbësore që liderët të kenë aftësinë të drejtojnë me empati dhe të përfshijnë zërat e ndryshëm në proceset vendimmarrëse. Vetëm në

këtë mënyrë mund të krijojmë një mjedis që nxit inovacionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Konferenca u nda në dy panele diskutimi. Paneli i parë, moderuar nga Merita Limani, përfshiu diskutimin e Zëvendëskryeministres Emilija Rexhepi mbi rëndësinë e përfaqësimit institucional të grave dhe minoriteteve. Rexhepi theksoi se përfaqësimi i barabartë në institucionet shtetërore dhe vendimmarrëse është një hap i rëndësishëm drejt barazisë dhe drejtësisë shoqërore. Ajo ndau

përvojat dhe sfidat e saj personale në përfaqësimin e minoriteteve dhe rolin e grave në politikë publike.

Paneli i dytë, moderuar nga Dr. Adelina Emini, trajtoi temën "Inclusive Leadership - Challenges and Opportunities". Sakibe Jashari, një nga folëset kryesore, diskutoi mbi sfidat që gratë përballen në rolet drejtuese dhe mënyrat për t'i kapërcyer ato. Dr. Valentina Dedi theksoi rëndësinë e krijimit të mundësive të barabarta dhe ofrimit të mbështetjes për gratë dhe minoritetet për të arritur sukses në karrierat e tyre.

Gjithashtu, sesioni interaktiv për zhvillimin e leadershipit për gratë dhe grupet minoritare u drejtua nga Faton Limani dhe Shqipe Vela, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive dhe trajnimin për diversitet. Ky sesion ofroi pjesëmarrësve një mundësi unike për të ndërtuar aftësitë e tyre drejtuese dhe për të mësuar teknika të reja për të promovuar diversitetin dhe përfshirjen në vendet e tyre të punës.

Në Kampusin e UBT-së në Prizren qëndruan për vizitë ambasadorë nga BE në Kosovë



Kampusi i UBT-së në Prizren mirëpriti një numër ambasadorësh nga Bashkimi Evropian në Kosovë, të cilët panë nga afër dhe u njoftuan me infrastrukturën moderne, teknologjitet e UBT-së për të rritur bashkëpunimin e ndërsjellë me partnerë nga këto vende.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, priti të ftuarit dhe i udhëhoqi ata nëpër kampusin inovativ, duke ndarë me ta historinë e zhvillimit të institucionit, përparimin e tij të qëndrueshëm dhe profesionalizmin që udhëheq çdo hap të tij. Rektori Hajrizi theksoi përkushtimin e UBT-së për të ofruar një arsim cilësor dhe inovativ.

Në fjalën e tij, Rektori foli për ekosistemin e qëndrueshëm që UBT ka krijuar ndër vite, një strukturë që mbështet kërkimin shkencor, inovacionin dhe zhvillimin personal të studentëve.

Vizitorët u shprehën të impresionuar nga infrastruktura inovative e kampusit, laboratorët e pajisur me teknologji të avancuar dhe ambientet e mësimdhënies që ofrojnë një përvojë mësimore të jashtëzakonshme.



Stafi i UBT-së po merr pjesë në kuadër të aktiviteteve të projektit COWEB në Universitetin e Salentos në Itali



Në kuadër të projektit COWEB (Virtual Collaborative Learning in WB HEIs) stafi i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Muhamet Gërvalla, Gonxhe Beqiri, Engelbert Zefaj dhe Kestrim Avdimetaj, janë duke

përfaqësuar UBT-në në Universitetin e Salentos në Itali, duke kontribuar në aktivitetin e radhës të projektit.

Projekti mbështetet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe ka për qëllim të ndikoj në aplikimin e teknikave të

Bashkëpunimit Virtual në Mësimdhënie (VCL) si një qasje inovative pedagogjike në mësimdhënie dhe të nxënit, me fokus në bashkë-krijimin e hapësirave të të mësuarit virtual, të përzier dhe përmbajtjes së kurseve që do të nxisin aftësitë dhe kompetencat e shekullit të 21-të për studentët dhe do të adresojë bashkëpunimin ndërkufitar midis IAL-ve dhe studentëve në rajoni i BB. Projekti bashkon 3 IAL të BE-së dhe 7 IAL të Ballkanit Perëndimor.

Gjatë sesioneve të planifikuara do të prezantohen platforma elektronike të cilat kanë për synim rritjen e bashkëpunimit virtual në mes të profesorëve dhe studentëve për mësimdhënie dhe mësimnxënie.

UBT zhvillon sistem të bazuar në inteligjencë artificiale për monitorimin dhe parandalimin e zjarreve pyjore në kuadër të projektit ARCA



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në takimin e projektit "ARCA" në Lecce të Italisë, ku u diskutua për "Platformën e inteligjencës artificiale për parandalimin e rreziqeve natyrore nga ndryshimet klimatike". Ky projekt synon të zhvillojë një platformë të fuqizuar nga inteligjenca artificiale për monitorimin e ekosistemeve pyjore, me qëllim parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve natyrore të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, siç janë zjarret pyjore, stuhitë e erës dhe thatësira. Projekti përfshin një qasje transnacionale me iniciativë pilot në zona të ndryshme pyjore në disa vende, përfshirë Italinë, Kroacinë, Greqinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Shqipërinë. Në këtë projekt, UBT do të dizajnojë dhe zhvillojë një sistem të bazuar në inteligjencë artificiale për

monitorimin dhe vlerësimin e zjarreve në pyje. Ky sistem mundëson kalkullimin e riskut për mundësinë e shfaqjes së zjarrit dhe monitorimin në kohë reale të gjendjes së terrenit përmes teknologjive moderne, si dronë, sensorë, kamera, etj.

"UBT ka një potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e këtyre teknologjive, pasi posedon të gjithë infrastrukturën moderne dhe stafin kompetent për këtë qëllim", tha Rektori Hajrizi, duke prezantuar njëkohësisht edhe ekosistemin inovativ të mençur të krijuar në këtë rast.

Projekti ARCA do të zgjasë tri vite dhe ka për qëllim forcimin e kapaciteteve inovative në rajon, duke zhvilluar një platformë të qëndrueshme dhe të bazuar në teknologji për mbrojtjen e pyjeve dhe përshtatjen me rreziqet klimatike.

UBT lanson kampanjën "Leading the Way"

UBT - kryeqendra për arsim cilësor dhe inovativ po hapë zyrtarisht kampanjën "Leading the Way" me qëllimin për të bashkuar të rinjtë nga të gjitha qendrat e Kosovës dhe rajonit, në institucionin lider të arsimit të lartë.

Përmes "Leading the Way" - UBT dëshmon se është institucioni lider dhe më i ranguar në rajon për cilësi, shkencë, teknologji, inovacion

dhe ndikim pozitiv në shoqëri, dhe me këtë rast fton të gjithë të rinjtë #jointheLEADER, për të qenë pjesë e tij.

Vetëm duke zgjedhur më të mirin, ju mund të jeni liderët e së ardhmes në profesionet e përzgjedhura për studime, dhe në këtë mënyrë ju do të jeni kontribuesit më të mëdhenj në vend dhe mburrja e Kosovës kudo në botë.

Në UBT u hap ekspozita “n’Pikturë” e studentëve të Fakultetit Media dhe Komunikim

Një numër i madh vizitorësh, përfshirë studentë, profesorë dhe profesionistë të fotografisë, morën pjesë në hapjen e ekspozitës “n’Pikturë” të studentëve të Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT. Ekspozita “n’Pikturë” ka synuar të demonstrojë aftësitë artistike dhe teknike të studentëve në fushën e fotografisë, duke i dhënë atyre një platformë për të shprehur vizionet



dhe idetë e tyre. Në ceremoninë e hapjes së ekspozitës, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, vlerësoi punën e studentëve dhe theksoi rëndësinë e aktiviteteve të tilla për zhvillimin e tyre profesional dhe personal. “Kjo ekspozitë është një dëshmi e përkushtimit dhe pasionit që studentët tanë kanë për artin dhe fotografinë. Ajo jo vetëm që tregon

aftësitë e tyre teknike, por edhe mënyrën se si ata perceptojnë dhe interpretojnë botën përreth tyre”, tha Rektori Hajrizi. Kjo ekspozitë u udhëhoq nga profesori Orhan Kerkezi, dhe është një nga shumë aktivitetet kreative dhe akademike që Fakulteti i Media dhe Komunikim organizon për të promovuar zhvillimin e aftësive praktike dhe artistike të studentëve të tij.

UBT prin për aktivitetin në mediat sociale nga universitetet në Kosovë

UBT në Kosovë ka dalë si lider në përdorimin e fuqisë së mediave sociale për të komunikuar me studentët dhe komunitetin e gjerë. Në një kohë kur teknologjia dhe digjitalizimi luan një rol kyç në arsim, UBT ka vendosur një standard shembullor për universitetet e tjera në Kosovë. Përmes një përmbajtjeje kreative dhe të mirinformuar në platformat Facebook dhe Instagram, raporti i nxjerrë nga Terra World ka ranguar UBT-në të parin nga univer-

sitetet në Kosovë, duke dëshmuar kështu angazhimin e përditshëm të tij për të qenë sa më afër audiencës në Kosovë dhe më gjerë. Për më tepër, përfshirja aktive e UBT-së në platforma, si: Facebook, Instagram, Twitter, LinkedIn, Youtube dhe TikTok, ka bërë që ndarja e lajmeve, përditësimet akademike, pikat e forta të kërkimit dhe sukseset, të dëshmojnë transparencën dhe të kontribuojnë në ndërtimin e besimit dhe kredibilitetit të audiencës.

Mbahet takimi i radhës i studentëve të UBT-së me Ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen

Në takimin e radhës të studentëve të UBT-së me Ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen, u diskutua për një sërë çështjesh që ndërlidhen me Bashkimin Evropian, ekonominë, sanksionet dhe të ardhmen. Diskutimet ishin të frytshme dhe u fokusuan në analizën e kompleksitetit të dinamikave politike dhe ekonomike të rajonit dhe të botës në përgjithësi. Ambasadori dhe studentët shkëmbyen pikëpamje dhe analiza të ndryshme, duke sjellë një perspektivë të pasur dhe të diversifikuar për çështjet e diskutuara.



Ky takim u vlerësua si një mundësi e çmuar për të zgjeruar horizontet dhe për të ndërtuar një bashkëpunim të

frytshëm mes institucioneve arsimore dhe përfaqësuesve diplomatikë të vendeve miqësore.

Shënohet Dita Botërore e Lirisë së Shtypit në UBT

Në Ditën Ndërkombëtare të Lirisë dhe Shtypit, Fakulteti Media dhe Komunikim në UBT organizoi një debat rreth temës: “Etika në mediat e shkruara elektronike në Kosovë”. Diskutimi u fokusua në sfidat dhe mundësitë që përballeshin gazetaret në këtë kontekst, duke u përqëndruar në standardet profesionale dhe etike të profesionit.

Panelistët, si: Ferid Selimi, Gjylie Rexha, Safet Zejnullahu, Musa Sabedini dhe Votim Hanoli, ndanë eksperiencën e tyre të gjatë dhe të pasur në fushën e gazetarisë. Ata ngritën shembuj konkret nga praktika e tyre, duke theksuar rëndësinë e ndërgjegjësimit të gazetarëve për rolin e tyre në shoqëri dhe për përg-



jegjësinë e tyre për të raportuar të vërtetën.

Në fjalën e tij, Dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Prof. Dr. Ferid Selimi shprehu bind-

jen se integriteti dhe besueshmëria e informacionit janë dy elemente themelore për mediat moderne. Selimi u fokusua në rëndësinë e standardeve etike në një periudhë ku informacioni është përhapur shumë

shpejt, theksoi se kjo është arsyeja pse përgjegjësia për transparencë dhe saktësi është më e rëndësishme se kurrë më parë. Profesori Musa Sabedini theksoi se mungesa e strukturave të redaktimit të mirëfillta dhe e gazetarëve të trajnuar mund të dëmtojë nivelin e gazetarisë profesionale dhe të vë në rrezik rolin e medias si zë zyrtar i informacionit.

“Mediat duhet të jenë të lira nga çdo ndërhyrje politike dhe ekonomike, gjatë punës së tyre për të informuar publikun. Ndërsa gazetaret në përgjithësi, duhet të çlirohen nga frika, lakmia, servilizmi dhe vetë censura. Në mungesë të redaksive profesionale, në mungesë të redaktorëve të

shkolluar e ngritur profesionalisht dhe në mungesë të gazetarëve nga tereni, po krijojmë dhe po rrezikojmë mënyrën e të bërit gazetari profesionale, në fakt po rrezikojmë vet ekzistencën e medias profesionale”, tha Sabedini.

Në linjë me këtë, edhe profesori Safet Zejnullahu u përqëndrua në ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e informacionit të saktë dhe të paanshëm, duke e cilësuar këtë si një pjesë kritike e funksionimit të një shoqërie demokratike. Ai shtoi se një publik i informuar dhe i ndërgjegjësuar është baza për një debat të shëndetshëm publik dhe për një demokraci të qëndrueshme.

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Barduani, viziton UBT-në



Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Barduani, vizitoi UBT-në, ku mori pjesë në një diskutim me stafin dhe studentët e këtij institucioni. Gjatë takimit, ai ndau informacione mbi misionin e KFOR-it në Kosovë, theksoi rëndësinë e paqes dhe stabilitetit në rajon, dhe diskutoi rolin e forcës ndërkombëtare në mbështetje të zhvillimit dhe sigurisë. Diskutimi ofroi mundësinë për një shkëmbim idesh mbi sfidat dhe mundësitë që paraqet situata aktuale në Kosovë dhe rajon, si dhe për rëndësinë e arsimit dhe angazhimit të rinisë në proceset e zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë takim mori pjesë edhe Ambasadori i Italisë në Kosovë, Antonello De Riu. Komandanti theksoi se ndihet

i nderuar dhe i privilegjuar për mundësinë që ka të jetë sot këtu si komandant i NATO-s, si bashkëpunëtor, dhe për të marrë pjesë në këtë konferencë të rëndësishme, në prani të atyre që ai i konsideron, dhe që beson se janë pjesa më e rëndësishme e shoqërisë sonë: vajzat e reja, rinia dhe studentët.

“Pavarësisht etnisë, besimit fetar dhe, sigurisht, bindjeve politike, ende ka një rrugë të gjatë për të bërë. Të dashur studentë, e ardhmja e kësaj toke është në duart tuaja, vetëm ju keni fuqinë për të ndryshuar gjërat dhe mendësitë. KFOR-i është në krahun tuaj, krah për krah. Le të ecim miljen e fundit së bashku, duke u siguruar që Ballkani Gadi-shulli nuk kthehet në ditët e errëta të

së kaluarës”, ka përfunduar komandanti i KFOR-it.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, e njoftoi gjeneralmajorin Barduani dhe ambasadorin Antonello De Riu për angazhimin e UBT-së në ofrimin e mundësive arsimore për studentët në fusha të ndryshme. Ai theksoi se UBT ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndikimin pozitiv në shoqëri, duke ofruar arsim të cilësisë së lartë dhe mundësi zhvillimi për studentët e saj. Hajrizi gjithashtu vlerësoi punën e vazhdueshme të KFOR-it në Kosovë dhe ndikimin e tij të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe stabil për qytetarët e Kosovës.

“Ju falënderoj personalisht për angazhimin tuaj të jashtëzakonshëm. Falë jush, ne tani ndihemi të lirë dhe gëzojmë paqe, e cila na mundëson të veprojmë. Përmes këtij kontributi, dhe siç është dëshmuar në shumë raste të tjera, jemi të pranishëm në investime të rëndësishme dhe zhvillimin e një kulture që vazhdon të rritet. Është e rëndësishme të theksojmë se mësimi gjatë gjithë jetës është themeli i suksesit dhe progresit tonë. Faleminderit edhe një herë për këtë kontribut të çmuar”.

UBT dhe UNIURB dakordohen për të zgjeruar mundësitë arsimore dhe kërkimore



Në një hap të rëndësishëm drejt nxitjes së bashkëpunimit ndërkombëtar arsimor, UBT dhe Universita degli Studi di Urbino Carlo Bo nga Italia, kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi. Ky partneritet i ri është vendosur për të rritur mundësitë akademike dhe kërkimore midis dy institucioneve. Sipas marrëveshjes, të dy institucionet akademike, të përfaqësuar nga Rektoret e tyre, përkatësisht Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe Profesor Giorgio Calcagnini, synojnë të inkurajojnë shkëmbimet dhe projektet bashkëpunuese në departamente të ndryshme dhe fakultete kërkimore.

UBT prezanton qasjen e tij inovative ndaj teknologjisë dhe edukimit të biznesit, ndërsa Universita degli Studi di Urbino Carlo Bo sjell historinë e tij të pasur dhe prestigjin akademik në partneritet.

Aspektet kryesore të bashkëpunimit përfshijnë shkëmbimin e stafit për kërkime akademike, aktivitete të përbashkëta kërkimore dhe ndarjen e burimeve akademike si materialet e bibliotekës, përmbajtjen pedagogjike dhe botimet kërkimore.

Për më tepër, marrëveshja propozon krijimin e programeve të përbashkëta të diplomave të dyfishta, të cilat parashikohen t'u ofrojnë studentëve mundësi të zgjeruara të të mësuarit dhe ekspozim ndërkombëtar.

Ky partneritet synon jo vetëm të zgjerojë horizontet arsimore të studentëve të saj, por edhe të avancojë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Italisë dhe Kosovës në sferën akademike.

Të dyja institucionet shprehin përkushtimin e tyre për këtë përpjekje dhe presin përfitimet reciproke që padyshim do të sjellë ky bashkëpunim.

Java e kuzhinës italiane në botë u shënuar në UBT

Java e kuzhinës italiane në botë u shënuar me një aktivitet të veçantë në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan, ku morën pjesë Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Ambasadori i Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, si dhe studentë e profesorë të UBT-së.

Në kuadër të këtij organizimi, u mbajt punëtorja me temën “Ristoceutics: nga ushqimet e dietës mesdhetare, tek vakte të shijshme dhe funksionale për shëndetin tonë”. Ky aktivitet shërbeu si një platformë për të promovuar jo vetëm traditën e pasur të kuzhinës italiane, por edhe lidhjen e saj me ush-

qimet funksionale dhe ndikimin pozitiv që ato kanë në mirëqenien njerëzore. Rektori Hajrizi, dhe ambasadori De Riu theksuan rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në fusha inovative, duke vënë theksin te promovimi i traditave të shëndetshme dhe edukimit cilësor.



Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit

UBT dhe UN Women bashkë për “Luftimin e dhunës me bazë gjinore në epokën e digjitalizimit”

UBT në bashkëpunim me UN Women Kosova, mbajtën eventin “Dhuna me Bazë Gjinore në Digjitalizim”, i cili u zhvillua me rastin e 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore. Ky aktivitet ishte pjesë e një përpjekjeje globale për të ngritur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar veprime konkrete kundër dhunës që lidhet me gjininë, duke përfshirë aspekte të reja dhe të rëndësishme të dhunës që ndodhin në mjediset digjitale.

Ky aktivitet i rëndësishëm u mbajt në UBT, një institucion i njohur për angazhimin e tij në promovimin e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale, që ka një traditë të fortë në mbështetje të iniciativave që përpiqen të fuqizojnë gratë dhe vajzat, duke ofruar mundësi për zhvillim të karrierës dhe arsimim. Gjatë ngjarjes, ekspertë të fushave të ndryshme ndanë njohuritë dhe përvojat e tyre lidhur me ndikimin e teknologjisë digjitale në jetët e grave, veçanërisht në lidhje me dhunën digjitale dhe sigurinë online.

Disa nga folëset ishin, Teuta Sahatqija një udhëheqëse e shquar me përvojë të gjatë në politikë, diplomaci dhe teknologji. Ajo ka shërbyer si deputete, Zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe Konsulle e Përgjithshme e Kosovës në Nju Jork. Aktiviste për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, ajo është bashkëthemeluese e “Women in Tech Kosovo” dhe “Women’s Parliamentary Caucus”.

Flutura Kusari një juriste e specializuar në të drejtën e medias dhe një aktiviste e angazhuar për lirinë e shprehjes. Ajo punon si këshilltare e lartë ligjore në Qendrën Europiane për Liri të Shtypit dhe Medias në Leipzig, Gjermani, ku mbështet gazetaret e rrezikuar dhe monitoron legjislacionin që rregullon sektorin e medias. Në vitin 2024, Flutura Kusari u nderua me Urdrin e Meritave të Republikës Federale të Gjermanisë nga presidenti Frank-Walter Stein-



meier për kontributin e saj të rëndësishëm.

Orkidea Xhaferaj, eksperte e Politikave të Digjitalizimit dhe Inovacionit pranë Qendrës për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCi-DEV), në Shqipëri, dhe njëkohësisht themeluese e Rrjetit të Grave Shqiptare në STEM.

Ejona Icka, Master në Psikologji Klinike dhe specializim në Mjekësinë Seksuale dhe Terapinë Familjare Sistemike. Ajo ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e shëndetit mendor, duke mbështetur të mbijetuarit e dhunës seksuale, veçanërisht ata në grupet më të cenueshme, në kuadër të Qendrës për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (KRCT) në Kosovë dhe profesore-shë në Fakultetin e Psikologjisë dhe Shkencave Mjekësore në UBT.

Ngjarja ishte strukturuar në formën e fjalimeve TEDx, ku çdo folës ndau eksperiencën dhe ekspertizën e tij në

lidhje me sfidat që gratë dhe vajzat hasin në internet, si dhe mundësitë për të luftuar dhunën digjitale. Pjesëmarrësit kishin mundësinë të merrnin pjesë në një sesion pyetje-përgjigje, ku ata mund të diskutonin më thellë me folësit dhe të shprehnin shqetësimet dhe sugjerimet e tyre.

Aktiviteti përfundoi me thirrje për të angazhuar çdo individ, si në nivel institucional ashtu edhe personal, për të kontribuar në zgjidhjen e këtij problemi të rëndësishëm, duke krijuar hapësira digjitale më të sigurta, ku gratë dhe vajzat mund të shprehin lirinë e tyre pa frikë nga dhuna dhe abuzimi.

Në fjalimet e tyre, folëset theksuan disa aspekte kyçe që lidhen me sfidat dhe mundësitë që sjell digjitalizimi për gratë. Së pari, nënvizuan “ana e errët e digjitalizimit”, e cila paraqet rreziqe të mëdha për gratë dhe vajzat, duke përfshirë forma të ndryshme dhune online, që pengojnë

mundësinë e tyre për të marrë pjesë plotësisht në hapësirat digjitale. Po ashtu, theksuan se fuqizimi dhe siguria shkojnë dorë për dorë, dhe se teknologjitë digjitale mund të jenë mjete të fuqishme për avancimin e grave, por është thelbësore që këto hapësira të jenë të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe pa dhunë. Mbrojtja ligjore dhe avokimi u identifikuan gjithashtu si elementë kyç për të luftuar dhunën online, duke përfshirë nevojën për ligje më të forta, forcim më të mirë të tyre dhe sisteme mbështetëse për viktimat.

Në përfundim të fjalimeve, folëset kërkuar bashkëpunim dhe inovacion për të arritur objektivat e përbashkëta. Ato theksuan se bashkëpunimi dhe inovacioni janë thelbësore për të krijuar hapësira më të sigurta për gratë në internet. Sipas tyre, krijimi i këtyre hapësirave kërkon përpjekje të përbashkëta nga rinia, aktivistët, politikanët dhe ekspertët. Ato inkurajuan

të pranishmit të angazhohen për të drejtat digjitale, barazinë gjinore dhe politika më të mira që mbrojnë gratë dhe vajzat në mjediset digjitale.

Përfundimi i ngjarjes ishte një thirrje për veprim, duke inkurajuar pjesëmarrësit që të përdorin atë që kishin mësuar për të bërë një ndryshim të vërtetë. Ata u ftuan të qëndrojnë të informuar për rreziqet që gratë përballen online dhe si mund të mbrojnë veten dhe të tjerët. U kërkuar mbështetje për nismat që luftojnë dhunën digjitale dhe avokim për politika që promovojnë sigurinë digjitale dhe barazinë gjinore. Po ashtu, u theksua rëndësia e integritetit të edukatës digjitale në shkollë, krijimit të mekanizmave të qasshëm për raportimin e dhunës dhe përmirësimin e ligjeve që mbrojnë gratë online.

Në këtë drejtim, folëset propozuan disa hapa të tjerë për të krijuar një ambient më të sigurt dhe gjithëpërfshirës për gratë dhe vajzat.

Ato kërkuar komunikim të rritur mes prindërve, mësuesve dhe institucioneve për të sensibilizuar më shumë rreth mundësive dhe rreziqeve të mjedisve digjitale. Përveç kësaj, u kërkuar fuqizimi i organizatave jo-qeveritare (OJQ) dhe kampanjave të vetëdijesimit që promovojnë sigurinë online dhe mbështetje për viktimat e dhunës digjitale. Shteti gjithashtu u nxit të marrë përgjegjësi më të madhe në krijimin e politikave që mbrojnë gratë në internet, ndërsa pjesëmarrësit u inkurajuan të edukojnë veten dhe të tjerët për t'i bërë hapësirat digjitale më të sigurta dhe më gjithëpërfshirëse për të gjithë.

Në përfundim të ngjarjes, u bë një thirrje e fuqishme për veprim kolektiv, për t'u angazhuar të gjithë në krijimin e një të ardhmeje digjitale ku gratë dhe vajzat mund të zhvillohen pa frikë dhe të realizojnë potencialin e tyre të plotë.

Profesori ndërkombëtar nga Paraguai, Juan Pane, zhvilloi dy ligjërata tematike në UBT



Profesori i njohur në fushën e Open Data dhe Shef i Inovacionit në Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshëm në Paraguai, Juan Pane, vizitoi Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, ku

pati mundësinë të takonte stafin akademik dhe studentët, si dhe të kontribuonte me dy ligjërata të veçanta për studentët.

Gjatë takimeve me studentët e vitit të dytë të Shkencave Kompjuterike,

Profesori Pane ndau përvojat e tij mbi zhvillimin dhe aplikimet e të dhënave të hapura, duke theksuar rëndësinë e këtyre të dhënave në nxitjen e transparencës dhe inovacionit në epokën digjitale.

Ai foli për sfidat dhe përfitimet që sjell kjo fushë në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë përmirësimin e shërbimeve publike dhe ndihmesën në vendimmarrje të bazuar në të dhëna.

Vizita e Profesor Pane shënon një hap të rëndësishëm për UBT-në në angazhimin për të sjellë njohuri ndërkombëtare dhe përvoja nga ekspertë globalë direkt te studentët.

Së bashku për shëndetin

Fakulteti i Shkencave Mjekësore në UBT organizoi një aktivitet humanitar me qëllim ndërgjegjësimin dhe inkurajimin e studentëve dhe stafit të UBT-së për të kontribuar në një kauzë jetësore. Aktiviteti kishte për qëllim mbështetje për ata që kanë nevojë urgjente për transfuzione

gjaku, duke theksuar rëndësinë e dhurimit të gjakut në shpëtimin e jetëve.

Gjatë ditës, pjesëmarrësit patën mundësinë të mësojnë mbi rëndësinë e dhurimit të gjakut dhe ndikimin e tij për shëndetin e komunitetit.

UBT dhe UNDP përzgjedhin 10 ideatorët e rinj të industrisë kreative



UBT ka mirëpritur 10 talentet kreative, fitues të sfidës “Innovation Unleashed: A Challenge for Creative Minds”, të cilët do të punojnë për të transformuar idetë e tyre në prototipe të reja inovative. Ky projekt, i mbështetur nga Embassy of the Grand-Duchy of Luxembourg in Pristina, ka për qëllim të nxisë zhvillimin e industrive kreative, duke krijuar produkte të reja dhe duke përmirësuar ekonominë vendore. Përmes mentorimit nga ekspertët

më të mirë që ofron UBT, të rinjtë do të kenë mundësinë të zhvillojnë aftësi në sipërmarrje dhe vetëpunësim, duke ndihmuar në rritjen e sektorit të industrive kreative në Kosovë. Në bashkëpunim me akademianë dhe sektorin privat, ky program krijon një platformë të fuqishme për rritjen e ekonomisë kreative dhe gjenimin e mundësive të reja për punësim dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Vizitë nga Universiteti IMC i Austrisë në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së

Përfaqësues nga Imc University of Applied Sciences Krems i Austrisë zhvilluan një vizitë të rëndësishme në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së, ku u mirëpritën nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi. Kjo vizitë ka synuar forcimin e bashkëpunimit akademik dhe profesional ndërmjet dy institucioneve për zhvillimin e turizmit dhe menaxhimin e sektorit të gastronomisë në Kosovë. Gjatë takimit, Rektori Hajrizi dhe specialistët nga IMC diskutuan rreth projekteve të përbashkëta për ndërtimin e infras-



strukturës moderne dhe përmirësimin e programeve në fushat e turizmit, menaxhimit të hoteleve dhe shërbimeve gastronomike. Ky bashkëpunim pritet të sjellë inovacione dhe praktika të suksesshme nga Austria, duke kontribuar në zhvillimin e turizmit dhe ngritjen e standardeve të mikpritjes dhe shërbimit në Kosovë.

UBT, përmes Fakultetit të Turizmit, ofron një platformë të rëndësishme

për të rinjtë që dëshirojnë të avancohen profesionalisht dhe të aplikojnë njohuritë më të fundit në këtë industri. Bashkëpunimi me universitetin IMC i hap studentëve dhe stafit të UBT-së mundësi të reja për shkëmbime akademike, trajnime praktike dhe përvetësimin e metodave bashkëkohore që përmirësojnë aftësitë e tyre dhe kontribuojnë në ekonominë e Kosovës.

Dr. Elmi Berisha presidenti i Federatës Panshqiptare VATRA, ligjëron para studentëve të UBT-së



Në ambientet e UBT-së, studentët e Fakultetit të Sigurisë dhe Shkencave Politike patën nderin të dëgjojnë një ligjëratë të veçantë nga Dr. Elmi Berisha, Presidenti i Federatës Panshqiptare VATRA. Tema e ligjëratës ishte "Roli i Lobit Shqiptaro-Amerikan për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës," një çështje me rëndësi të veçantë për të kuptuar angazhimin historik dhe strategjik të komunitetit shqiptaro-amerikan në çlirimin e Kosovës dhe njohjen e saj ndërkombëtare.

Gjatë ligjëratës, Dr. Berisha përkroi me detaje rrugëtimin e gjatë dhe sfidues të diasporës shqiptaro-amerikane në mbështetje të çështjes së Kosovës. Duke përmendur momente kyçe dhe përpjekje të palodhshme, ai vuri në dukje ndikimin e madh që komuniteti shqiptar ka ushtruar përmes lobimit në qarqet politike dhe institucionet amerikane, veçanërisht gjatë dhe pas luftës së Kosovës.

Dr. Berisha theksoi se përkrah-

ja e vazhdueshme e SHBA-së për Kosovën nuk do të kishte qenë e mundur pa ndihmën e organizatave të tilla si VATRA, të cilat me angazhimin e tyre kanë ngritur zërin e Kosovës në nivel global. "Lobi shqiptaro-amerikan ka qenë një nga aleatët më të fuqishëm të Kosovës në arenën ndërkombëtare, duke u bërë shtytës i fuqishëm për pavarësinë dhe lirinë e saj," theksoi Dr. Berisha. Studentët patën mundësinë të diskutojnë dhe të parashtronë pyetje mbi sfidat aktuale dhe të ardhshme për zhvillimin e mëtejshëm të Kosovës si shtet i pavarur.

Ligjëratat u organizuan nga Arian Kadriu, profesor i UBT-së, duke e kthyer këtë ligjëratë në një mundësi të vlefshme për studentët e sigurisë dhe shkencave politike që të mësojnë nga përvoja e një figure të njohur dhe të përfshirë direkt në çështjet kombëtare.

Mat Jordan, CEO i Procurrit, viziton UBT dhe thekson potencialin e jashtëzakonshëm të Kosovës në IT



CEO i kompanisë së njohur ndërkombëtare "Procurrit", Mat Jordan, vizitoi UBT-në, ku shprehu admirimin e tij për burimet e pasura dhe talentin e jashtëzakonshëm në fushën e IT-së.

Gjatë fjalimit të tij, ai theksoi se studentët e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë janë shumë të përgatitur për tregun e punës, një fakt që reflektohet edhe në përbërjen e stafit të Procurrit, ku shumica janë studentë dhe ish-studentë të UBT-së. Mat theksoi potencialin në rritje të Kosovës, veçanërisht në sektorët e

teknologjisë dhe IT-së, duke theksuar se vendi ka një fuqi punëtore të kualifikuar që i përgjigjet nevojave të tregut global. Ai vuri në dukje se profesionistët e rinj të Kosovës zotërojnë një njohuri të thellë të trendeve të industrisë dhe kanë një etikë të punës, dy faktorë kyç për inovacion dhe rritje.

Për më tepër, ai theksoi vendndodhjen strategjike të Kosovës dhe mjedisin miqësor ndaj biznesit si mundësi të shkëlqyera për bashkëpunim dhe zgjerim.

Rreth 3 mijë pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare të UBT-së: Përmbillet suksesshëm edicioni i 13-të

Në fjalimin e tij përmbyllës, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, e vlerësoi konferencën si një sukses të jashtëzakonshëm, duke theksuar angazhimin e të gjithë pjesëmarrësve në avancimin e dijes dhe inovacionit. Ai nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimin e përvojave që ndihmojnë në zhvillimin e fushave të studimit

Konferenca Ndërkombëtare e UBT-së për Biznes, Teknologji dhe Inovacion, e cila u zhvillua për tre ditë me radhë, përfundoi zyrtarisht, duke mbledhur rreth 3,000 akademikë, hulumtues dhe studentë nga dhjetëra vende të botës. Ky edicion shërbeu si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e njohurive dhe ideve në fusha të ndryshme të shkencës, biznesit dhe teknologjisë.

Në fjalimin e tij përmbyllës, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, e vlerësoi konferencën si një sukses të jashtëzakonshëm, duke theksuar angazhimin e të gjithë pjesëmarrësve në avancimin e dijes dhe inovacionit.



Ai nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimin e përvojave që ndihmojnë në zhvillimin e fushave të studimit.

Rektori Hajrizi falënderoi veçanërisht organizatorët dhe kontribuesit, duke përmendur se ky edicion ka sjellë rreth 24 fusha studimi,

gjithashtu theksoi se ky event ka promovuar inovacionin dhe ka ofruar mundësi të reja bashkëpunimi mes hulumtuesve.

Ceremonia e mbylljes përfshiu fjalime dhe vlerësime nga disa nga folësit kryesorë të konferencës, vendor dhe ndërkombëtarë të cilët ndanë përshtypje pozitive për nivelin e lartë të angazhimit dhe profesionalizmit. Ata nënvizuan rëndësinë e shkëmbimit të ideve dhe rezultateve kërkimore, si dhe potencialin e këtij eventi për të kontribuar në përparimin e shkencës dhe teknologjisë.

Konferenca ofroi gjithashtu mundësi për rrjetëzim dhe ndihmoi në kri-

jimin e lidhjeve të reja mes akademikëve dhe profesionistëve, duke e bërë një ngjarje të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të hulumtimeve dhe inovacioneve.

Me këtë, UBT konfirmoi angazhimin e saj për të vazhduar me këtë traditë dhe për të ofruar një platformë të fuqishme për zhvillimin e gjeneratave të ardhshme të shkencëtarëve dhe liderëve. Konferenca Ndërkombëtare e UBT-së do të vazhdojë të jetë një pikë e rëndësishme e takimit për ata që kërkojnë të kontribuojnë në avancimin e njohurive dhe praktikave në biznes, teknologji dhe inovacion.

UBT zyrtarizon projektin Erasmus + Jean Monnet - Një hap i rëndësishëm drejt integrimit evropian të Kosovës



Në UBT u mbajt takimi i parë për zyrtarizimin e projektit të Bashkimit Evropian Erasmus + Jean Monnet, i cili ka si qëllim të kontribuojë në përparimin e integrimit evropian të Kosovës.

Projekti, i titulluar "AKIL-BE" (Advancing Kosovo's Integration into the EU through Learning about the EU), ka si synim të forcojë kuptimin dhe ndërgjegjësimin mbi Bashkimin Evropian në Kosovë, duke theksuar rolin kyç të edukimit dhe kërkimit në këtë proces.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e këtij projekti për zhvillimin e njohurive mbi Bashkimin Evropian në vend.

"Me një diversitet prej 150 profileve të ndryshme, projekti ka potencialin të reflektojë nevojat dhe aspiratat e shoqërisë kosovare, duke ofruar një qendër të rëndësishme për mësim dhe zhvillim profesional. Ky është një hap i rëndësishëm në përpjekjet për të forcuar lidhjet midis Kosovës dhe Bashkimit Evropian, duke e bërë këtë kohë të përshtatshme për të rin-

jtë dhe profesionistët e ardhshëm në vend," tha Rektori Hajrizi.

Manjolla Zaçellari, koordinatore e projektit, vlerësoi përfshirjen në këtë iniciativë dhe theksoi se UBT është vendi i duhur për të promovuar studimet evropiane. "Ky projekt është i hapur për të gjithë të interesuarit e të gjitha drejtimeve, që kanë interes në zhvillimin dhe avancimin e nxënies mbi integrimin evropian," theksoi ajo.

Objektivat kryesorë të projektit përfshijnë promovimin e studimeve evropiane dhe përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies për të arritur një publik të gjerë. Një aspekt thelbësor është përgatitja e qytetarëve të Kosovës për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, duke theksuar rëndësinë e njohjes së institucioneve evropiane dhe të tregut të brendshëm.

Vizita në Washington DC

Ligjëratë nga shkencëtari i shquar Pier Paolo Piccaluga në UBT



Fakulteti i Shkencave Mjekësore në UBT mirëpriti Prof. Dr. Pier Paolo Piccaluga, i cili mbajti një ligjëratë tematike për studentët e këtij fakulteti. Pritjen e organizoi Prof. Dr. Fitim Alidema, dekan i shkencave mjekësore në UBT, ndërsa në këtë ngjarje ishin të pranishëm edhe Dr. Adriatik Berisha dhe Prof. Dr. Fisnik Laha.

Ligjëratat u fokusuan në tematika të rëndësishme si mjekësia, patologjia dhe onkologjia, me një theks të veçantë në integrimin e inteligjencës artificiale në këto fusha. Prof. Dr. Piccaluga, MD, Ph.D., është profesor i asociuar i patologjisë në Departamentin e Mjekësisë Eksperimentale, Diagnostikuese dhe Mjekësisë Speciale në Shkollën e Mjekësisë të Universitetit të Bolonjës, si dhe njëkohësisht shërben si mjek ekzekutiv në Biobankën e Kërkimeve në Spitalin IRCCS S. Orsola-Malpighi.

Me një karrierë të pasur akademike

dhe profesionale, në vitin 2018, Prof. Dr. Piccaluga u emërua profesor në Universitetin Queen Mary në Londër dhe në Universitetin e Bujqësisë dhe Teknologjisë Jomo Kenyatta në Nairobi, Kenia.

Ai ka publikuar në revista prestigjioze ndërkombëtare si Nature Medicine, Journal of Clinical Investigation, Journal of Experimental Medicine, Journal of Clinical Oncology, Blood, Lancet Oncology dhe Lancet Infectious Diseases.

Për më tepër, Dr. Piccaluga është renditur si një nga shkencëtarët më të shquar italianë nga VIA-Academy, duke dëshmuar kështu për kontributin e tij të rëndësishëm në fushën e mjekësisë dhe kërkimeve shkencore. Ligjëratat e tij sollin një debat të frytshëm mbi rolin e teknologjisë moderne në avancimin e shëndetësisë dhe përmirësimin e kujdesit ndaj pacientëve.

Hapësira e mundësive: Panairi i kompanive austriake në UBT

Rreth 20 kompani austriake shpallorën mundësi të shumta për studentët e UBT-së në Panairin e organizuar në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së në Lipjan. Kjo ngjarje ishte e fokusuar në krijimin e lidhjeve midis kompanive ndërkombëtare dhe studentëve, duke ofruar një platformë të rëndësishme për të diplomuarit e nivelit Bachelor dhe Master, si dhe për ata që janë në prag të diplomimit, për

të eksploruar mundësi të reja karriere dhe të zhvillojnë intervista pune me përfaqësuesit e kompanive.

Në këtë panair, studentët patën mundësinë të aplikojnë për një gamë të gjerë pozicionesh pune, nga punësimi sezonal deri te kontratat e rregullta të punës, në sektorë të ndryshëm që përfshijnë teknologjinë, inxhinierinë, menaxhimin dhe ekonominë. Kjo ngjarje u karakterizua nga një

pjesëmarrje e gjerë dhe përkushtim i kompanive austriake për të gjetur talente të reja dhe për të mbështetur zhvillimin profesional të studentëve kosovarë.

Ky panair ishte një hap i rëndësishëm drejt përfundimit të lidhjeve të bashkëpunimit midis UBT-së dhe kompanive austriake, duke krijuar rrugë të reja për karrierë dhe zhvillim profesional për studentët tanë.

Me një ceremoni madhështore

Diplomuan studentët e gjeneratës së 21-të të UBT-së

Me një organizim madhështor, UBT shënoi ceremoninë e gradimit të studentëve të gjeneratës së njëzetë e një, duke i dhuruar Kosovës profesionistë dhe ekspertë që do të kontribuojnë në fusha të ndryshme të jetës.

Të lumtur dhe të entuziazmuar për arritjen e tyre profesionale, studentët përmbyllën suksesshëm një cikël të rëndësishëm jetësor në drejtimet në nivelin bachelor dhe master të programeve.

I gëzuar dhe krenar për gjithë këtë arritje të tyre, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka përgëzuar secilin student për angazhimin dhe përkushtimin për të kryer një cikël të rëndësishëm të jetës së tyre, siç janë studimet akademike.

"Në UBT, ju keni qenë pjesë e një komuniteti që beson në fuqinë e dijes dhe në rëndësinë e shërbimit ndaj shoqërisë. Ju keni qenë të rrethuar



nga njerëz që kanë ndarë me ju përvojat e tyre, që kanë ndihmuar në formësimin e mendimeve tuaja dhe që kanë qenë krah jush në çdo hap të rrugës. Tani, është radha juaj të përdorni atë që keni mësuar për të bërë një ndikim pozitiv në botë. Si am-

basadorë të UBT-së, ju keni një përgjegjësi të veçantë për të përfaqësuar vlerat dhe standardet tona kudo që të shkoni", u shpreh Rektori Hajrizi.

Ceremonia e gradimit nuk kishte se si të mos konkretizohej ndryshe pa betimin e studentit, të cilin e ud-

hëhoqën, studentet Poema Doli dhe Arbëreshë Fazliu, ndërsa betimin e hipokratit, Rrezjona Reçica, duke bërë kështu që njëzëri studentët të betohen për t'i shërbyer shkencës, edukimit, e vendit, si dhe me vetëdije dhe vullnet të plotë të bëhen pjesë

kontribut dhënëse në ndërtimin e shtetit dhe prosperimin e shoqërisë sonë.

Ceremonia u përcoll me disa pika të zgjedhura muzikore nga studentët e Fakultetit Muzikë Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhimi, Meriton Heta, Diana Mehmetaj, Vjollca Osmani dhe Anjeza Gashi, teksa kulmoi me momentin shumë madhështor dhe më të rëndësishëm për secilin student, por edhe për UBT-në si institucion i arimit të lartë, për hedhjen e kapelave, si simbol i përfundimit të një periudhe plot përkushtim dhe sakrificë dedikuar dijes dhe avancimit akademik.

Gjenerata e 21-të e UBT-së është tashmë gati për të përballuar sfidat e së ardhmes, të pajisur me dije të thellë, aftësi të pakrahasueshme dhe një vizion të qartë për të ndërtuar një Kosovë më të mirë.



Ligjërata mbi procesin e rekrutimit me ekspertin gjerman Guenter Schrom në UBT



Në ambientet e UBT-së në Prishtinë, u mbajt një ligjëratë e veçantë në kuadër të lëndës "Sjellja Organizative dhe Liderhipi", e cila u drejtua nga studenti i vitit të dytë në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, në bashkëpunim me profesorin Engelbert Zefaj.

Ligjërata u realizua nga eksperti i njohur gjerman, Guenter Schrom, i angazhuar në Kosovë përmes projektit "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Reformat në Menaxhimin e Financave Publike", financuar nga Bashkimi Evropian dhe organizata gjermane

GIZ. Tematika e ligjërates ishte "Kupitimi dhe aplikimi i standardeve të vendeve të zhvilluara për rekrutimin e punonjësve në kompani private dhe në organizata publike".

Ligjëruesi Schrom, ilustroi rëndësinë e standardeve të avancuara në procesin e rekrutimit, duke sjellë si shembull të fundit procesin e rekrutimit brenda Doganave të Kosovës dhe rolin kyç të mbështetësve të këtij projekti.

Gjatë prezantimit, ligjëruesi theksoi kriteret thelbësore që duhet të aplikohen për të identifikuar kandidatët e duhur për pozita në sektorin privat

dhe atë publik. Ai theksoi standardet dhe teknikat e nevojshme për një përzgjedhje efektive, duke i inkurajuar studentët që të përgatiten seriozisht për sfidat e procesit të rekrutimit pas përfundimit të studimeve.

Interesimi i studentëve ishte i lartë, të cilët e vlerësuan ligjëraten si të dobishme dhe të rëndësishme për të ardhmen e tyre profesionale. Ata shprehën se, për shkak të moshës së tyre, nuk kishin pasur ende përvojë në procedurat e rekrutimit, por ligjëratat premtuese premtoi se do t'i merrnin seriozisht këshillat e dhëna nga eksperti, me qëllim që të përgatiten më mirë për mundësitë e punësimit në të ardhmen.

Kjo ngjarje ofron një mundësi të shkëlqyer për studentët, duke i pajisur ata me njohuri praktike dhe këshilla që do t'u shërbejnë gjatë karrierës së tyre.

UBT rozë në tetor

Në UBT u mbajt një ngjarje e veçantë kushtuar Tetor Rozë, muaj ky për ndërgjegjësimin ndaj Kancerit të Gjirit. Kjo ngjarje përveç që kishte një karakter informativ dhe ndërgjegjësuës, kishte si qëllim të nxisë ndërveprim dhe veprime konkrete për shëndetin e grave dhe vajzave në Kosovë.

Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, profesorëve, dekanëve, si dhe studentëve të UBT-së, u zhvilluan diskutime të rëndësishme për rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe kujdesit të vazhdueshëm ndaj shëndetit. Ekspertët mjekësorë theksuan se diagnostikimi i hershëm mund të shpëtojë jetë dhe nxitën gratë dhe vajzat që të bëjnë kontrolle të rregullta dhe të informohen për mënyrat e parandalimit dhe trajtimit të kan-

cerit të gjirit.

Në fjalimet e tyre, përfaqësuesit e UBT-së dhe të fuarit shprehën angazhimin e tyre për të mbështetur fushata të tilla dhe për të ofruar platforma informuese për shëndetin publik. Ata u bënë thirrje grave dhe vajzave që t'i kushtojnë vëmendje të shtuar shëndetit të tyre, duke mos e neglizhuar kontrollin e rregullt mjekësor. Kjo iniciativë në UBT është një vazhdimësi e përkushtimit të institucionit për ngritjen e vetëdijes në çështje shëndetësore dhe për të kontribuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve në Kosovë. Kjo ngjarje përmbylli me një mesazh të qartë: Kujdesi ndaj shëndetit është përgjegjësi e çdo gruaje dhe vajze, dhe bashkë mund të luftojmë për një shoqëri më të shëndetshme dhe të informuar.

Kampionet me Liderin



UBT priti me krenari kampionet olimpikë, duke shënuar një moment të rëndësishëm për institucionin. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka mirëpritur medalistët olimpikë në xhudo, Distria Krasniqi, Laura Fazliu dhe trajnerët, Driton Kuka dhe Majlinda Kelmendi, në Qytetin e Mençur të UBT-së, në Lipjan.


Rektori Hajrizi përgëzoi ekipin e Kosovës për arritjet e tyre të jashtëzakonshme në xhudo, duke nënvizuar angazhimin e UBT-së për të prom-

ovuar ekselencën në performancë dhe sport, si dhe për të rritur bashkëpunimin ndërmjet kampionëve dhe liderit në arsim.

Rektori Hajrizi inkurajoi të gjithë studentët që të ndjekin shembujt e këtyre kampionëve, të cilët kanë treguar se me punë të palodhur dhe përkushtim çdo qëllim mund të arrihet.

Trajneri Driton Kuka njoftoi vazhdimin e bashkëpunimit të fuqishëm me UBT-në, i njohur si universiteti kampion i performancës!

Përfundon me sukses edicioni i trembëdhjetë i "Global UBT Fest 2024"



Festivali tradicional i dijes dhe shkencës "Global UBT Fest 2024" ka përmblytur edicionin e trembëdhjetë me sukses, duke realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara për këtë vit. Gjatë 31 ditëve të korrikut, 30 shkollat verore mblodhën studentë, profesorë, ekspertë dhe profesionistë nga Kosova, rajoni dhe bota, për të organizuar debate dhe ligjërata tematike mbi çështje specifike. Qëllimi kryesor ishte avancimi dhe përfitimi i njo-

hurive të reja për pjesëmarrësit dhe studentët në fushat e tyre të studimit. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e festivalit si një platformë për ndarjen e dijes dhe inspirimin e të rinjve drejt pasioneve të tyre për dijen dhe shkencën. Ai gjithashtu vlerësoi angazhimin dhe profesionalizmin e pjesëmarrësve, duke i cilësuar këtë eksperiencë si jashtëzakonisht të vlefshme për të gjithë.

"Ky festival përfshiu një gamë të gjerë aktivitetesh, nga prezantime të akademikëve dhe punëtori kreative, deri te sesione për ndarjen e ideve dhe njohurive. Gjalb UBT Fest 2024 ka qenë një platformë e jashtëzakonshme për promovimin e dijes dhe shkencës, duke i mundësuar pjesëmarrësve të eksplorojnë ide të reja dhe të zhvillojnë pasionet e tyre. Angazhimi dhe kontributi i çdo pjesëmarrësi e kanë bërë këtë edicion të veçantë dhe të suksesshëm", deklaroi Rektori Hajrizi. Ky festival jo vetëm që mblodhi pjesëmarrës nga Kosova dhe rajoni, por edhe nga bota, duke u ofruar atyre një mundësi unike për të zgjeruar dijen dhe eksploruar aspekte të ndryshme të profesionit të tyre. Pjesëmarrja aktive dhe shkëmbimi i përvojave dhe ideve e bënë këtë ngjarje një nga më të suksesshmet në fushën e dijes dhe shkencës në Kosovë dhe Evropë.

UBT dhe Idromeccanica Lucchini bashkojnë forcat për zhvillimin e agrikulturës së mençur në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi vizitoi kompaninë e njohur italiane Idromeccanica Lucchini, dhe me këtë rast ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me udhëheqësit e kësaj kompanie, mar-

rëveshje kjo e cila parasheh krijimin e një platforme të përbashkët për përkrahjen e agrikulturës moderne në Kosovë dhe në Ballkanin Perëndimor.

Bashkëpunimi do të përfshijë shumë

komponentë të agrikulturës moderne, sikurse: serrat, serrat vertikale, sisteme të ujitjes, ndriçimit, mbrojtjes, përdorimin e teknologjive moderne robotike, Internet of Things (IoT), inteligjencës artificiale, si dhe teknologjinë e dronëve.

Ky bashkëpunim strategjik mes UBT-së dhe Idromeccanica Lucchini do të sjellë përfitime të mëdha për zhvillimin e Kosovës, duke hapur rrugë për projekte të rëndësishme në agrikulturë dhe sektorë të tjerë. UBT, me infrastrukturën e saj moderne dhe inovative në bujqësi dhe teknologji ushqimore, së bashku me Idromeccanica Lucchini, do të krijojë një qendër lidere në rajon dhe me impakt të madh.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Artit Bashkëkohor - ARKIV



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Sislej Xhafa nga Instituti i Artit Bashkë-

kohor - ARKIV.

Kjo marrëveshje, e cila është konsideruar si një hap strategjik dhe inovativ, synon të thellojë bashkëpunimin akademik dhe artistik mes dy institucioneve, duke krijuar mundësi të reja dhe dinamike për studentët dhe stafin e UBT-së në fushën e artit bashkëkohor.

Kjo marrëveshje do të lejojë studentët e UBT-së të marrin pjesë në programe shkëmbimi, punëtori dhe projekte kërkimore të përbashkëta me ARKIV. Ata do të kenë mundësinë të punojnë me artistë të njohur ndërkombëtarë dhe të marrin pjesë në ekspozita dhe instalacione artistike.

UBT forcon partneritetin ndërkombëtar me Vector Robotics nga Italia



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe udhëheqësi i Vector Robotics nga Italia, Andrea Beggio, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për zgjerimin dhe avancimin e teknologjisë së dronëve në Ballkanin

Perëndimor.

Qëllimi kryesor i këtij bashkëpunimi është përmirësimi i kapaciteteve teknologjike dhe infrastrukturës për përdorimin e dronëve në sektorë të ndryshëm, përfshirë mbikëqyrjen, sigurimin dhe menaxhimin e resurseve. Duke u fokusuar në avancimin e teknologjisë dhe aplikimeve të saj, kjo marrëveshje do të përmirësojë efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve në Ballkanin Perëndimor, si dhe të kontribuojë në rritjen e inovacionit dhe konkurrencës në këtë sektor.

Gjatë qëndrimit të tij në Itali, Rektori Hajrizi ka zhvilluar takime me partner të rëndësishëm nga Evropa dhe rajoni duke përfshirë Rektorin e Universitetit të Salentos, Prof. Fabio Pollice.

UBT dhe Universiteti Çanakkale Onsekiz Mart nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



UBT dhe Universiteti Çanakkale Onsekiz Mart nga Turqia kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, e cila synon të forcojë

lidhjet akademike dhe hulumtuese midis dy institucioneve të njohura.

Fushat kryesore të bashkëpunimit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik, duke krijuar mundësi të reja për mobilitet ndërkombëtar dhe zhvillim profesional.

Bashkëpunimin në hulumtime shkencore, për të avancuar në fusha të ndryshme akademike dhe për të kontribuar në inovacionin shkencor.

Organizimin e programeve të përbashkëta trajnimit dhe seminareve, për të nxitur zhvillimin e aftësive dhe ndarjen e njohurive.

Pjesëmarrjen e ndërsjellë në aktivitete akademike dhe shkencore, duke

përfshirë ligjëratat dhe punimet kërkimore të përbashkëta.

Zbatimi i marrëveshjes: Të dy universitetet janë të angazhuara për të mbështetur vizitat e stafit akademik dhe kërkuesve, duke ofruar lehtësi logjistike dhe mundësi për të mbajtur ligjëratat ose për të zhvilluar projekte kërkimore. Kjo marrëveshje pritet të forcojë kapacitetet akademike dhe të rrisë ndikimin shkencor të të dy institucioneve.

Ky bashkëpunim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt zgjerimit të lidhjeve ndërkombëtare dhe përmirësimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë dhe Turqi.

UBT ftohet tani edhe në Afrikë për të ngritur kapacitetet akademike dhe profesionale



UBT, përpos aktiviteteve të tij në Kosovë, në Ballkanin Perëndimor, në Evropë, Britani dhe Azi, tani do të kontribuojë edhe në kontinentin e Afrikës, në forcimin e sistemeve arsimore dhe duke mbështetur


kërkesat e shteteve afrikane për zhvillim dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe akademike të brezave të rinj.

UBT sapo ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, përmes së

cilës do të ofrojë një gamë të gjerë programesh në fushën e edukimit, përfshirë edhe krijimin e programeve në fushat si Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, si dhe zhvillimin e Instituteve të specializuara për hulumtime dhe avancim akademik.

Modeli unik e inovativ i UBT-së i ndërtuar në Kosovë dhe për zhvillimin e Kosovës, tani po gjen zbatim edhe në vendet e tjera dhe ka një vlerësim të lartë botëror, duke u konsideruar një prej modeleve që ofron zgjidhje për të zvogëluar diferencën në mes të kërkesave të tregut të punës dhe ofertës me kompetenca adekuate nga njerëzimi, gjë të cilën sistemet klasike të edukimit nuk po mund të arrijnë.

UBT forcon partneritetin ndërkombëtar me Vector Robotics nga Italia



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe udhëheqësi i Vector Robotics nga Italia, Andrea Beggio, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për zgjerimin dhe avancimin e teknologjisë së dronëve në Ballkanin Perëndimor.

Qëllimi kryesor i këtij bashkëpunimi është përmirësimi i kapaciteteve teknologjike dhe infrastrukturës për përdorimin e dronëve në sektorë të ndryshëm, përfshirë mbikëqyrjen, sigurimin dhe menaxhimin e resurseve. Duke u fokusuar në avancimin e teknologjisë dhe aplikimeve të saj, kjo marrëveshje do të përmirësojë efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve në Ballkanin Perëndimor, si dhe të kontribuojë në rritjen e inovacionit dhe konkurrencës në këtë sektor.

Gjatë qëndrimit të tij në Itali, Rektori Hajrizi ka zhvilluar takime me partner të rëndësishëm nga Evropa dhe rajoni duke përfshirë Rektorin e Universitetit të Salentos, Prof. Fabio Pollice.

Marrëveshje Erasmus+ mes UBT-së dhe Universitetit të Rijekës në Kroaci

UBT dhe Universiteti i Rijekës, Fakulteti i Ndërtimtarisë, kanë arritur një marrëveshje të re bashkëpunimi në kuadër të programit Erasmus+ KA 171, Programme - Inter-Institutional Agreement Key Action 1. Kjo marrëveshje përfshin shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve mes Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturës në UBT dhe Fakultetit të Ndërtimtarisë në Universitetin e Rijekës. Ky bashkëpunim i thelluar mes dy institucioneve shënon një hap të rëndësishëm në përmirësimin e mundësive akademike

dhe profesionale për studentët dhe stafin, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së arsimit dhe shkëmbimin e eksperiencave ndërkombëtare. Për disa vite me radhë, këto dy institucione kanë aplikuar së bashku në programin Erasmus+, dhe këtë vit janë përzgjedhur për të përfutur nga ky program, i cili do të mbështesë një staf akademik dhe dy studentë në shkëmbimin e tyre. Kjo iniciativë jo vetëm që promovon partneritetin, por edhe fuqizon rolin e arsimit të lartë në krijimin e mundësive të reja për zhvillimin akademik dhe profesional.

Fakulteti Juridik i UBT-së nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Gjykatën Themelore në Prizren



Fakulteti Juridik i UBT-së ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Gjykatën Themelore në Prizren. Marrëveshja u nënshkrua nga Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond

Hajrizi dhe nga Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren Shpresa Emra. Sipas kësaj marrëveshjeje, studentët e Fakultetit Juridik do të kenë mundësinë të ndjekin praktikën në

Gjykatë për një periudhë deri në 6 muaj. Ky bashkëpunim ka për qëllim të ofrojë studentëve përvojë praktike dhe njohuri të vlefshme në fushën e drejtësisë.

Përveç praktikës studentore, marrëveshja parashikon dhe aktivitete të tjera të përbashkëta, përfshirë organizimin e konferencave, punëtorive dhe trajnimeve. Rektori i UBT-së ka ofruar mbështetje për Gjykatën në ofrimin e trajnimeve për stafin e saj dhe në organizimin e aktiviteteve të ndryshme të përbashkëta.

Ky bashkëpunim do të kontribuojë në zhvillimin profesional të studentëve dhe në forcimin e lidhjeve midis institucioneve arsimore dhe gjyqësore.

UBT dhe Universiteti Sakarya nga Turqia do të themelojnë një Technopark të ri në Kosovë



UBT dhe Universiteti i Sakarya nga Turqia kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për themelimin e një teknoparku të avancuar, i cili do të pozicionohet në kampusin e UBT-së në Prizren.

Ky projekt përbën një hap të rëndësishëm në zhvillimin e infrastrukturës për inovacion dhe teknologji në rajon, duke krijuar mundësi të reja për ndërmarrësi dhe zhvillim teknologjik.

Technoparku do të ofrojë një hapësirë moderne dhe të pajisur mirë për start-up-et dhe kompanitë teknologjike, si dhe mundësi për kërkime dhe zhvillime shkencore. Kjo qendër e re do të kontribuojë në forcimin e lidhjeve ndërkombëtare dhe do të krijojë një mjedis të favorshëm për ndërmarrësit dhe studiuesit, duke nxitur rritjen e ekonomisë dhe zhvillimin e teknologjisë në Kosovë dhe rajon.

Marrëveshja e arritur do të mundësojë që UBT dhe Universiteti i Sakarya të bashkëpunojnë ngushtë në projekte të ndryshme kërkimore dhe zhvillimore, si dhe në ofrimin e mundësive për trajnime dhe shkëmbime akademike. Ky partneritet do të ndihmojë në ngritjen e kapaciteteve të shkencëtarëve dhe sipërmarrësve të rinj, duke kontribuar në krijimin e një ekosistemi inovativ dhe të qëndrueshëm në Kosovë.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Prizrenit



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje synon zhvillimin dhe implementimin e projekteve të përbashkëta për zhvillim ekonomik, urban dhe industrial të Komunës së Prizrenit, si dhe aktivitete të tjera me interes të përbashkët. Në këtë projekt të rëndësishëm janë të përfshirë gjithashtu GIZ dhe ITP, duke sjellë një bashkëpunim të gjerë dhe të diversifi-

kuar. UBT do të ofrojë bursa studimi për të gjithë studentët e Komunës së Prizrenit që do të përcaktohen me vendim të veçantë, duke kontribuar kështu në edukimin cilësor të rinisë së Prizrenit.

Kjo marrëveshje përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përparimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Komunës së Prizrenit, duke krijuar mundësi të reja për të rinjtë dhe për komunitetin në përgjithësi.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë italiane të hekurudhave Generale Costruzioni Ferrovie

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturës në UBT ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë italiane të hekurudhave Generale Costruzioni Ferrovie nga Roma në Itali.

Kjo marrëveshje është rezultat i angazhimeve të shumta dhe ka krijuar një bashkëpunim të ndërsjellë që ofron mundësi praktike për studentët tanë. Gjithashtu, është një mundësi e jashtëzakonshme për palën italiane, e cila ka marrë përsipër udhëheqjen e rehabilitimit të hekurudhës kosovare.



Rëndësia e marrëveshjes:

Generale Costruzioni Ferrovie është një kompani me bazë në Romë dhe projekte në mbarë botën, duke përfshirë Francën, Gjermaninë, Kanadanë, Amerikën dhe më shumë.

Hekurudha është një mjet kryesor transporti për njerëzit dhe mallrat, dhe kjo marrëveshje do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së hekurudhave në Kosovë dhe ndërlihdjen e tyre me Evropën.

Kjo marrëveshje nuk do të ishte e mundur pa përkrahjen e bashkëpunëtorëve të të dy palëve.

Tashmë, stafi i Ndërtimtarisë dhe studentët e UBT-së, së bashku me stafin e kompanisë Generale Costruzioni Ferrovie, mund të shkëmbejnë eksperiencat e tyre dhe të kontribuojnë në përmirësimin e hekurudhave në Kosovë. Kjo do të ndihmojë në shtimin e cilësisë dhe të bërit pjesë e rrugëve të transportit të njerëzve dhe mallrave në Evropë.

UBT nënshkruan memorandum bashkëpunimi me "ISCTE Executive Education" të Portugalisë



Në kuadër të Forumit të Parë të Biznesit Kosovë-Portugali, UBT dhe "ISCTE Executive Education" nga Portugalia kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, duke krijuar mundësi të reja në fushën e arsimit, kërkimit dhe trajnimeve. Ky memorandum synon të forcojë dhe të zgjerojë bashkëpunimin ekzistues kulturor dhe arsimor ndërmjet dy institucioneve.

Në ceremoninë e nënshkrimit, të

mbajtur në ambientet e Forumit të Parë të Biznesit Kosovë-Portugali, të pranishëm ishin përfaqësues të lartë nga të dy institucionet, si dhe pjesëmarrës të tjerë të rëndësishëm nga sektori akademik dhe biznesi. Marrëveshja e bashkëpunimit u nënshkrua nga rektori i UBT-së Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe drejtori për zgjerimin global në "ISCTE Executive Education", Rui Vinhas da Silva.

Ky memorandum bashkëpunimi

parashikon zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, organizimin e konferencave dhe seminareve shkencore, shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve, si dhe ofrimin e programeve të trajnimeve të avancuara. Marrëveshja përfshin gjithashtu mundësinë e krijimit të programeve të përbashkëta të studimeve dhe përfshirjen në rrjete ndërkombëtare të kërkimit dhe inovacionit.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, shprehu entuziazmin e tij për këtë bashkëpunim, duke theksuar se kjo marrëveshje do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së arsimit dhe kërkimit shkencor në UBT, si dhe në zgjerimin e horizonteve për studentët dhe stafin akademik. Ai vuri në dukje rëndësinë e bashkëpunimeve ndërkombëtare në epokën e globalizimit dhe sfidave komplekse. Ky bashkëpunim është një hap i rëndësishëm përpara në përpjekjet e UBT-së për të forcuar lidhjet e saj ndërkombëtare dhe për të ofruar një arsim cilësor dhe të integruar me standardet globale.

UBT vazhdon të zgjerojë bashkëpunimin me bashkitë e Shqipërisë, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi edhe me Bashkinë e Kukësit



UBT ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë e Kukësit. Kjo marrëveshje siguron programe të përbashkëta bashkëpunimi në zhvillimin dhe implementimin e programeve për zhvillim ekonomik, urban dhe industrial të Bashkisë Kukës dhe aktiviteteve të tjera në interes të përbashkët.

Bashkëpunimi mes UBT-së dhe Bashkisë së Kukësit parasheh zhvillimin e qëndrueshëm lokal duke përfshirë strategji, plane dhe projekte zhvillimore, urbane dhe sektorë të ndryshëm të jetës, përkrahjen e

të rinjve në ngritjen e kapaciteteve profesionale, në punësim, ndërmarrësi dhe aktivitete të tjera inovative, organizimin e përbashkët të eventeve me interes për komunitetin, përgatitjen dhe pjesëmarrjen e përbashkët në projekte zhvillimore në kontekst lokal, rajonal, evropian dhe ndërkombëtar.

Kjo marrëveshje përforcon përpjekjet e UBT-së për të kontribuar në zhvillimin e komuniteteve lokale dhe për të krijuar mundësi të reja për të rinjtë dhe profesionistët në rajonin e Kukësit.

UBT vazhdon rritjen e partneriteteve akademike e shkencore: Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin "KirikKale" nga Turqia

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin "KirikKale" nga Turqia. Kjo marrëveshje është nënshkruar si rezultat i gatishmërisë së dy palëve për projekte të përbashkëta kërkimore e akademike, si dhe gatishmërisë së të dy institucioneve për shkëmbimin e përvojave të tyre më të mira shkencore dhe teknologjike.

Kjo marrëveshje u ka hapur rrugë



stafit dhe studentëve të të dyja universiteteve të jenë pjesë e programeve të shkëmbimeve, duke krijuar kështu mundësi të reja për zhvillimin e tyre akademik, profesional dhe kulturor.

Rektori Hajrizi ka theksuar rëndësinë e shkëmbimeve ndërkombëtare për pasurimin e përvojës së studentëve dhe për përmirësimin e cilësisë së arsimit në të dy institucionet. Ai nënvizoi se marrëveshja

do të sjellë përfitime të ndërsjella, duke hapur rrugë për projekte të përbashkëta kërkimore, forume dhe konferenca.

Universiteti "KirikKale" është i njohur për infrastrukturën e avancuar kërkimore, sidomos në shkencat sociale dhe ato mjekësore. Ky bashkëpunim pritet të forcojë lidhjet akademike midis Kosovës dhe Turqisë, duke kontribuar në zhvillimin e arsimit të lartë në të dy vendet.

Studentët e UBT-së fitojnë çmimin prestigjioz në konkursin e arkitekturës Frozen Music nga Titan Sharrcem

Ardon Beqa dhe Malika Lohaj, studentët e Fakultetit të Arkitekturës në UBT, janë shpallur fitues të Çmimit të Parë në konkursin ndërkombëtar të dizajnit të arkitekturës "Titan Sharrcem Frozen Music", duke u dalluar për vizionin dhe krijimtarinë e tyre novatore.

Konkursi ishte i hapur për pjesëmarrje nga studentët të institucioneve të ndryshme, dhe shumë studentë të UBT-së konkurruan me projekte të shkëlqyera. Megjithatë, Ardoni dhe Malika triumfuan me projektin e tyre të veçantë, duke fituar çmimin e parë prej 5,000 €.

"Fitorja jonë është rezultat i përkushtimit dhe mësimdhënies cilësore që kemi marrë në UBT", u shprehën fituesit. "Jemi mirënjohës për mbështetjen e stafit akademik dhe



mundësinë për të treguar potencialin tonë në një platformë ndërkombëtare".

Juria ndërkombëtare dhe interdisciplinare, e udhëhequr nga Titan

Sharrcem, përfshinte personalitete të njohura të fushës, duke përfshirë Prorektorin e UBT-së dhe Dekanin e Fakultetit të Arkitekturës, Prof. Dr. Binak Beqaj. Ky kombinim ekspertësh garanoi një vlerësim profesional dhe objektiv të projekteve pjesëmarrëse.

Ky sukses i jashtëzakonshëm i Ardorit dhe Malikës jo vetëm që përfaqëson një arritje të tyre personale, por dëshmon edhe një herë nivelin e lartë të përgatitjes profesionale në UBT, duke e vendosur universitetin në krye të institucioneve që promovojnë arkitekturën bashkëkohore dhe inovacionin.

Fitorja e tyre është një frymëzim për brezat e rinj të arkitektëve që synojnë të ndërtojnë të ardhmen me guxim dhe krijimtari.

Studentja e Sistemeve të Informacionit, Vlera Ibrahim fiton bursë në Universitetin e Grazit në Austri



Vlera Ibrahim, studente e Fakultetit Sisteme të Informacionit në UBT, ka fituar bursë në Universitetin e

Grazit në Austri. Gjatë shkëmbimit studentor, Vlera ka ndjekur me përkushtim leksionet dhe ka përfutur nga njohjet me studentë nga vende të ndryshme, duke pasuruar përvojën e saj akademike dhe personale. Përveç kësaj, ajo ka qenë në gjendje të udhëtojë dhe të eksplorojë kulturën dhe peizazhet e bukura të Austrisë, duke zgjeruar kështu perspektivën e saj ndërkombëtare.

Ky shkëmbim studentor jo vetëm që i ka ofruar mundësi të reja akademike dhe profesionale, por gjithashtu i ka ndihmuar të krijojë lidhje të reja dhe të ndërtojë një rrjet të gjerë kontakti në fushën e Sistemeve të Informacionit.

Studentët e UBT-së përfundojnë me sukses praktikën profesionale në Coca-Cola HBC Kosova




Pas një periudhe të përkushtuar dhe të mbushur me mësim të vlefshme, studentët e UBT-së, kanë përfunduar me sukses praktikën profesionale në Coca-Cola HBC Kosova.

Gjatë kësaj praktike, Melisa, Rinesa, Rroni, Milaimi, Dijari, Elsa, Brilanti, Orgesa, Hamza dhe Oresti, kanë përfutur njohuri të reja, eksperiencë të jashtëzakonshme dhe kanë zhvilluar aftësi të rëndësishme që do t'i

ndihmojnë në karrierën e tyre të ardhshme.

Ky sukses është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë mes UBT-së dhe Coca-Cola HBC Kosova, një partneritet që vazhdon t'u ofrojë studentëve mundësi të shkëlqyera për t'u përgatitur për sfidat e tregut të punës dhe për të fituar njohuri praktike në një prej kompanive më të njohura ndërkombëtare.

Ish-studenti i UBT-së, Aridon Lakna, themelues dhe pronar i kompanisë "Papyrus Group"



Ish-studenti i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Aridon Lakna, menjëherë pas studimeve ka krijuar kompaninë e tij "Papyrus Group", që ofron shërbime të avancuara në projektimin, mbikëqyrjen dhe enterierin në

Kosovë.

Kompania e tij ka për qëllim të sjellë një qasje të re në fushën e arkitekturës duke përdorur praktika bashkëkohore dhe teknologji të qëndrueshme. Kompania synon të krijojë projekte inovative dhe funksionale, duke e çuar industrinë e arkitekturës në një nivel të ri.

Për Aridonin, e gjithë kjo arritje është një reflektim i përgatitjes dhe edukatës që mori gjatë studimeve në UBT. Si një student i angazhuar, ai ka përfutur nga njohuritë e thelluara, praktikën e avancuara dhe mbështetjen e vazhdueshme nga stafi i UBT-së, të cilat kanë luajtur një rol kyç në formimin e tij profesional dhe janë bazë për suksesin e tij aktual.

"Arsimi është baza e çdo suksesi. Ajo që kam mësuar në UBT më ka dhënë mundësinë të ndërtoj diçka të veçantë dhe të qëndrueshme, si Papyrus Group, një hap në të ardhmen e arkitekturës", tha Aridon Lakna.

Aridoni inkurajon studentët e tanishëm që të besojnë në potencialin e tyre dhe të shohin arritjet e ish-studentëve si një dëshmi të mundësive që edukimi i ofron. Ai gjithashtu shpreh mirënjohjen për mbështetjen e UBT-së dhe nënvizon rëndësinë e formimit akademik në realizimin e synimeve profesionale.

Rrugëtimi i Aridon Laknës dhe kompanisë së tij, është një dëshmi e suksesit që mund të arrihet kur edukimi, përkushtimi dhe pasioni bashkohen.

Ish-studentja e UBT-së, Era Ibrahim pjesë e ekipit të radiologjisë në Ordinancën Gjenezis

Era Ibrahim, ish-studente e Fakultetit Teknik i Radiologjisë në UBT, ka ndjekur me sukses një karrierë të shkëlqyer në fushën e radiologjisë. Pas përfundimit të studimeve, ajo u punësua si teknike e radiologjisë në Ordinancën Gjenezis, një institucion shëndetësor i njohur në Ferizaj për ofrimin e shërbimeve mjekësore të cilësisë së lartë dhe përkushtimin e veçantë ndaj pacientëve.

Në pozitën e saj, Era ka kontribuar në mënyrë të jashtëzakonshme në ekipin e radiologjisë, duke realizuar procedura të avancuara dhe duke ofruar mbështetje të rëndësishme për mjekët dhe pacientët. Gjatë studimeve në UBT, ajo shquhej për angazhimin e saj të jashtëzakonshëm



dhe përkushtimin ndaj fushës së radiologjisë. Ajo gjithashtu tregoi aftësi të jashtëzakonshme për të aplikuar teorinë në praktikë, duke kontribuar

aktivisht në projekte dhe aktivitete praktike që pasqyronin nivelin e lartë të mësimdhënies në UBT.

"Studimet në UBT ishin një hap i rëndësishëm në formimin tim profesional. Gjatë kohës në UBT, kam mësuar jo vetëm njohuri teknike të avancuara, por edhe vlera të rëndësishme si puna në grup, përkushtimi dhe etikë profesionale. UBT më ofroi mundësinë të zhvillohem dhe të përgatitem për sfidat e karrierës time", tha Era Ibrahim.

Era vazhdon të investojë në zhvillimin e aftësive të saj profesionale, duke u angazhuar gjithmonë për të përmirësuar shërbimet që ofron dhe për të siguruar kujdesin më të mirë për pacientët.

Verona Hasani, studente e Dizajnit të Integruar në UBT vazhdoi studimet Master në Romë të Italisë



Verona është një tjetër studente e UBT-së, që me përkushtim dhe profesionalizëm ka vijuar studimet Master në Romë të Italisë, duke reflektuar përkushtimin e UBT-së për të nxjerrë në pah talentet që përqafojnë tregun global. Nga Kosova në Itali, një histori tjetër suksesi sikurse e Verona Hasanit, e cila nisi studimet bachelor

në UBT, dhe me një talent të jashtëzakonshëm dhe profesionalizëm gjatë viteve të saj në UBT, u dallua për krijimet e saj kreative ndaj dizajnit.

Pas përfundimit të studimeve në UBT, Verona vendosi të ndjekë ëndrrat e saj edhe më tej. Ajo u pranua në Rome Business School në Itali, ku po vazhdon studimet Master në programin Global Master in Fashion and Luxury Management.

Suksesi i Veronës Hasanit është një dëshmi e përkushtimit të UBT-së për të përgatitur profesionistë të aftë për tregun global. Ajo është një shembull frymëzues për të gjithë studentët e rinj që ndjekin pasionet e tyre në fushën e dizajnit dhe menaxhimit të modës.

Projekti i studentëve të UBT-së fiton vendin e parë në asamblenë rinore S!NERGY

Asambleja Rinore S!NERGY, një ngjarje e rëndësishme e organizuar nga IAYSP EUME, u mbajt nga 24 deri më 27 tetor në Budapest, Hungari. Ky event ofroi një platformë për të rinjtë nga e gjithë Europa dhe Lindja e Mesme për të prezantuar iniciativat e tyre dhe për të ndarë përvoja të çmuara.

Në fjalën e saj përshëndetëse, Prof. Dr. Denis Çelçima, dekania e Fakultetit të Psikologjisë në UBT, theksoi mbështetjen e fortë për nisimat që fokusohen tek të rinjtë dhe përpjekjet për ndërkombëtarizim. Dekania përcolli urimet e Rektorit Prof. Dr. Edmond Hajrizi, duke theksuar rëndësinë e angazhimit të UBT-së në zhvillimin e projekteve rinore dhe në ndihmën e tyre për të arritur qëllime ambicioze.

Ejona Icka, drejtoresha ekzekutive e



YSP Balkan, foli për bashkëpunimin frutdhënës me UBT, duke e cilësuar këtë partneritet si një ndikim pozitiv në zhvillimin e projekteve rinore. Ajo theksoi se ky bashkëpunim ka krijuar mundësi për rinjtë të angazhohen në iniciativa që adresojnë çështje të

rëndësishme sociale dhe zhvillimore. Në këtë asamble, studentët e UBT-së paraqitën tre projekte të shkëlqyera, duke e bërë kështu të qartë përfaqësimin dinjitoz të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Njëri nga këta projekte, i realizuar nga studentët Blend

Reselica, Klea Vezaj, Gjergj Rexhaj dhe Vlera Krelani, u shpall fitues i vendit të parë. Ky projekt u vlerësua si më inspiruesi, duke adresuar në mënyrë efektive disa nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs). Bogdan Pammer, presidenti i IAYSP EUME, theksoi se kontributet e YSP Balkan dhe UBT kanë ndihmuar në krijimin e një platforme ndërkombëtare, ku të rinjtë e talentuar mund të angazhohen në proceset formuese dhe ndërtuese të vendeve të tyre, duke adresuar me efikasitet sfidat që i përballin.

Ky sukses u shoqërua me urime të shumta për studentët e UBT-së për arritjet e tyre të jashtëzakonshme, dhe një falënderim të veçantë për YSP Balkan për mbështetjen e vazhdueshme dhe për punën e palodhur të realizuar deri tani.

Ballkani Perëndimor ishte i përfaqësuar me dinjitet, me 14 pjesëmarrës nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, duke demonstruar unitet dhe forcë rajonale. YSP Balkan shprehu mirënjohje për institucionet mbështetëse si UBT, Shkolla e Mesme UBT dhe Universiteti i Tetovës, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në avancimin e iniciativave rinore.

Me fillimin e nëntorit, YSP Balkan është e ngazëllyer për të nisur vitin e tretë të projekteve, trajnimeve dhe aktiviteteve në Ballkan. Këtë vit, organizata mirëpret partnerë dhe institucione të reja, të cilët janë të gatshëm të mbështesin iniciativat dhe programet me fokus të rinia. Kjo është një periudhë premtuese për të rinjtë, që do të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit.

Studentët triumfojnë me ide për transformim digjital: Tri fitore nga UBT në Garën Ndërkombëtare të Projektit Elegants



Studentët e UBT-së kanë arritur një sukses të jashtëzakonshëm në garën ndërkombëtare “Elegants – Call for Business Idea in Digital Transformation”, duke fituar tri çmimet kryesore në këtë konkurrencë prestigjioze, ku përballë tyre ishin studentë nga Italia, Greqia, Shqipëria dhe Mali i Zi. Përmes ideve të tyre inovative dhe potencialit të lartë për transformim

digjital, studentët e UBT-së u dalluan nga grupet e tjera, duke fituar vlerësimin më të lartë nga juria ndërkombëtare.

Vendi i parë i takoi ekipit të përbërë nga Adea Berisha, Rina Rushiti, Rona Rushiti dhe Adea Bajraktari.

Vendi i dytë u arrit nga Adea Piperku, Lorena Gashi, Elona Hyseni dhe Drin Avdiaj.

Vendi i tretë u fitua nga Gem Krasniqi, Rijad Halili dhe Fjolla Muçiqi. Gjatë vizitës së tyre në Romë, ku u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve, studentët patën jo vetëm mundësinë të marrin shpërblimet e tyre, por gjithashtu të vizitojnë parrin ndërkombëtar “Rome Maker Faire – The European Edition”. Ky aktivitet i njohur i ofroi atyre një përvojë unike për të parë zhvillimet më të fundit në fushën e teknologjisë dhe transformimit digjital.

Ky sukses shënon një arritje të rëndësishme për UBT, duke promovuar aftësitë dhe kreativitetin e të rinjve nga Kosova në një arenë ndërkombëtare dhe duke dëshmuar përkushtimin e institucionit dhe të mentorëve profesorëve, Bekim Marmullaku dhe Besnik Skenderi, për të përgatitur liderët e ardhshëm në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.

Studenti i Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturës në UBT, Arbër Halili fiton bursë për të vazhduar studimet në Universitetin e Bolonjës në Itali



Studenti i UBT-së, Arbër Halili, ka arritur një sukses të rëndësishëm në karrierën e tij akademike duke fituar bursë dhe duke u pranuar për të vazhduar studimet në Universitetin e Bolonjës në Itali. Kjo është një mundësi e shkëlqyer që i ofron Arbërit mundësinë të avancojë në

fushën e tij të studimeve në një nga universitetet më prestigjioze të Evropës.

Arbëri ka qenë një student i dalluar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, një program që është i vetmi në Kosovë i vlerësuar pozitivisht nga organizata ndërkombëtare për cilësinë e tij të lartë akademike dhe përgatitjen profesionale. Përkushtimi dhe punë e palodhur e Arbërit janë reflektuar në rezultatet e tij të shkëlqyera dhe në përpjekjet e tij për të arritur më të mirën në çdo hap të studimeve të tij.

Përveç suksesit në Universitetin e Bolonjës, Arbëri ka fituar gjithashtu një bursë për studime në Universitetin e Mynihut në Gjermani.

Në një ceremoni të veçantë, shpërndahen certifikatat për studentët e UBT-së në kuadër të “Let’s Talk About European Union”

Në një ceremoni të veçantë të organizuar nga Ambasada e Finlandës, u shpërndanë certifikatat për kursin gjashtë-mujor “Let’s Talk About European Union”. Ambasadori i Finlandës, Matti Nissinen, ndau certifikatat për studentët e Fakultetit të Shkencave Politike, Psikologjisë dhe Juridikut në UBT. Në ceremoninë e zhvilluar ishin të pranishëm: Dekania e Fakultetit të Shkencave Politike, Hajdi Xhixha, Dekania e Fakultetit të Psikologjisë, Denis Celcima, dhe Dekani i Fakultetit të Juridikut, Ahmet Maloku. Gjatë fjalës së tij, Ambasadori Nissinen vlerësoi përkushtimin e

studentëve dhe rëndësinë e njohurive të fituara për Bashkimin Evropian. Ai gjithashtu njoftoi se do të ketë mundësi për një edicion të tretë në vitin e ardhshëm akademik, duke lënë të hapur mundësinë për vazhdimin e këtij bashkëpunimi të frytshëm ndërmjet Ambasadës së Finlandës dhe UBT-së.

Kjo ceremoni shënoi një moment të rëndësishëm për studentët dhe stafin akademik, duke theksuar rëndësinë e edukimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e studimeve evropiane.

Njomza Krasniqi, studentja e UBT-së, punësohet si asistente për fëmijët me nevoja të veçanta



Studentja e Psikologjisë në UBT, Njomza Krasniqi, ka bërë një hap të rëndësishëm në karrierën e saj profesionale, duke u punësuar si asistente për fëmijët me nevoja të veçanta, ku ajo po ndihmon në ofrimin e mbështetjes dhe kujdesit të veçantë për këtë grup fëmijësh.

Kjo përvojë e re po i mundëson Njomzës një thellim të njohurive dhe aftësive praktike në profesionin e saj, duke i dhënë gjithashtu një perspektivë të gjerë mbi sfidat dhe përkushtimin që kërkon puna me fëmijët me nevoja të veçanta.

E mbështetur dhe e udhëhequr nga Prof. Violeta Zefi, Njomza po përfiton nga ky udhëzim profesional, që po e ndihmon të forcojë aftësitë e saj praktike dhe të fitojë besimin e nevojshëm për të arritur sukses në karrierën e saj si psikologe.

Duke vlerësuar rëndësinë e kësaj përvoje, Njomza thekson se UBT ka luajtur një rol vendimtar në rrugëtimin e saj, duke i ofruar një mjedis të ngrohtë dhe frymëzues, ku ka ndjerë mbështetje të vazhdueshme nga profesorët dhe stafi akademik.

“UBT dhe profesorët e Fakultetit të Psikologjisë më kanë ofruar një mje-

dis frymëzues dhe përkrahës për të zhvilluar aftësitë e mia në këtë fushë të ndjeshme. Sfidat dhe arritjet gjatë këtij udhëtimi në UBT më kanë bërë të rritem dhe të zhvillohem si individ dhe si profesioniste. Eksperiencia ime në UBT do të mbetet gjithmonë një kapitull i rëndësishëm në jetën time dhe një bazë e fortë për të vazhduar përpara në karrierën time si psikologe,” ka thënë Krasniqi, duke nënvizuar vlerën e pakrahueshme që ka për të ky rol në krijimin e bazës për karrierën e saj të ardhshme.

Kjo arritje për Njomzën jo vetëm që përfaqëson një sukses personal, por gjithashtu dëshmon për mundësitë e shumta që UBT ofron për studentët e saj, duke i përgatitur ata me aftësitë dhe eksperiencën e nevojshme për t'u bërë profesionistë të suksesshëm në tregun e punës.

Diploma e UBT-së mundëson sukses ndërkombëtar: Arxhenda Lipovica angazhohet si hulumtuese dhe asistente në Politecnico di Milano



Diploma e njohur ndërkombëtarisht e UBT-së i mundësoi ish-studentes së Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Arxhenda Lipovica, të sigurojë punë jashtë vendit, duke fituar përvojë praktike

përgjatë studimeve të saj master në Politecnico di Milano. Aktualisht, ajo punon si hulumtuese dhe asistente në universitet, duke kontribuar në projektin SMART dhe duke u fokusuar në kërkimin për proceset e vendimmarrjes së qëndrueshme.

Arxhenda thekson rëndësinë e mbështetjes dhe udhëzimeve të stafit akademik të UBT-së në formësimin e saj profesional.

“Të studiosh në UBT, do të thotë të përfitosh përvojat më të mira profesionale e jetësore. Si institucion më ofroi mundësi të panumërta, madje edhe diploma e UBT-së më është njohur në arenën ndërkombëtare, saktësisht nga Universiteti “Politecnico di Milano”, universiteti në të cilin kam vazhduar studimet”, thek-

soi Arxhenda. Përveç angazhimeve si hulumtuese dhe asistente, Arxhenda punon edhe si arkitekte freelancer në projekte të ndryshme arkitekturore. Ajo është e përkushtuar të përdorë njohuritë dhe përvojën e saj për të kontribuar në zhvillimet akademike dhe profesionale, duke sjellë përfitime të mëdha për komunitetin dhe vendin e saj.

Rrugëtimi i Arxhenda Lipovicës është një dëshmi e fortë e potencialit të madh që ofron UBT dhe një shembull frymëzues për të gjithë studentët dhe profesionistët e rinj. Arxhenda vazhdon të përpiqet për përsosmëri dhe të japë kontributin e saj për zhvillim të vendit tonë, duke dëshmuar se ëndrrat mund të realizohen me përkushtim dhe punë të palodhur.

Studentet e UBT-së zënë vendin e parë në Basketboll 3x3 në Ligën Universitare



Në kuadër të Ligës Universitare, studentet e UBT-së kanë treguar një performancë të jashtëzakonshme në garat e organizuara nga Federata e Sportit Universitar, duke fituar vendin e parë në kategorinë e Basketbollit 3x3. Ky sukses i rëndësishëm është një dëshmi e përkushtimit dhe punës së palodhur të ekipit, si dhe mbështetjes së fuqishme nga UBT dhe stafi akademik. Garat u zhvilluan në një atmosferë konkurruese dhe emocionuese, ku ekipet universitare nga e gjithë vendi konkurruan për vendet e para.

Studentet e UBT-së, me një strategji të mirëplanifikuar dhe një lojë të shkëlqyer, arritën të mposhtin të gjitha kundërshtarët, duke fituar kështu titullin e kampionit.

Ky rezultat i shkëlqyer reflekton jo vetëm aftësitë e larta sportive të studenteve të UBT-së, por edhe përkushtimin e tyre ndaj sportit dhe përgatitjen e vazhdueshme. Ekipi është trajnuar intensivisht për muaj me radhë, duke demonstruar një shpirt të vërtetë ekipi dhe një disiplinë të fortë.

Studentja e Shkencave Politike, Dea Preniqi, ka vazhduar studimet Master në Universitetin e Salzburgut në Austri




Dea Preniqi, njëra nga studentet e Shkencave Politike në UBT, ka vazhduar studimet Master në Universitetin e Salzburgut në Austri.

Ajo, përveç ndjekjes së leksioneve dhe njohjes me studentë nga vende të tjera, ka përfituar nga një eksperiencë e pasur akademike dhe kulturore. Dea ka udhëtuar dhe ka zgjeruar perspektivën e saj ndërkombëtare, duke marrë pjesë në aktivitete të ndryshme dhe duke u angazhuar në projekte të rëndësishme.

Studio Shkenca Politike në UBT dhe përfito nga mundësi për shkëmbim studentor në vende të ndryshme të Evropës.

Fortesa Gashi, studente e UBT-së, zhvillon aplikacion për personat me shikim të dëmtuar përmes programit Erasmus+



Fortesa Gashi, studente e shkencave kompjuterike dhe inxhinierisë në UBT, është një shembull frymëzues i suksesit akademik dhe përkushtimit ndaj inovacionit teknologjik.

Në kuadër të studimeve të saj master, Fortesa zgjodhi një temë me një ndikim të thellë shoqëror: zhvillimin dhe analizën e një aplikacioni për një kategori të veçantë të nxënësve në rajon, atë të personave të verbër dhe me shikim të dëmtuar.

Përmes mbështetjes së UBT-së dhe mundësisë së ofruar nga programi Erasmus+, Fortesa pati mundësinë të ndjekë një semestër në Universitetin e Sapienzës në Itali. Pikërisht aty ajo arriti të zhvillojë aplikacionin, duke u bazuar në standardet më të fundit teknologjike dhe duke siguruar që ky projekt të ishte i përshtatshëm për

nevojat e përdoruesve të saj të shtuar. Fortesa shprehet se ky projekt ka qenë një mundësi e jashtëzakonshme për të, jo vetëm për zhvillimin profesional dhe akademik, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e jetës së nxënësve me nevoja të veçanta në rajon. Kjo arritje është një dëshmi e qartë e përkushtimit të UBT-së për të mbështetur inovacionin dhe zhvillimin e aftësive të studentëve të saj përmes projekteve ndërkombëtare si Erasmus+, duke mundësuar që idetë të bëhen realitet.

Ish-studentja e UBT-së, Anila Shala do të vazhdojë studimet master në University of Padova në Itali



UBT ka luajtur një rol të rëndësishëm në hapjen e dyerve për studentët drejt universiteteve të njohura ndërkombëtare. Një shembull

i këtij suksesi është Anila Shala, ish-studente e Fakultetit të Psikologjisë, e cila është pranuar për të vazhduar studimet master me bursë në University of Padova në Itali.

Anila përfundoi studimet bachelor në UBT, ku fitoi njohuri dhe aftësi të rëndësishme për karrierën e saj të ardhshme në psikologji. Ajo thotë se koha e kaluar në UBT ka qenë një përvojë e pasur dhe inspiruese, që i dha motiv për të ndjekur ëndrrat e saj në një universitet ndërkombëtar prestigjioz.

“Ka qenë një privilegj i madh që të ndjek studimet akademike në UBT. Gjatë tri viteve kam pasur mundësinë të përfitoj njohuri të reja dhe aftësi të nevojshme për t’u për-

gatitur për studimet e mëtejshme në psikologji. Është fakt se UBT bën diferencën nga institucionet e tjera të arsimit të lartë. Performanca që tregon UBT brenda vendit dhe në arenën ndërkombëtare më ka nxitur që të bëj këtë zgjedhje,” ka potencuar ajo.

UBT, përmes bashkëpunimeve të saj me institucione edukative dhe arsimore në Evropë dhe Amerikë, ka për qëllim të sjellë në Kosovë praktikë jo vetëm që u japin mundësi studentëve si Anila që të ndjekin ëndrrat e tyre, por gjithashtu kontribuojnë në zhvillimin e talentit të rinisë kosovare dhe përparimin e vendit.

Studentja e UBT-së, Yllka Suliqi, pjesë e ekipit në Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës



Yllka Suliqi, studente e Fakultetit të Juridikut në UBT, ka arritur një sukses të rëndësishëm duke u angazhuar si pjesë e ekipit në Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani. Ky angazhim është një mundësi e shkëlqyer për të aplikuar njohuritë dhe aftësitë e saj juridike në një nivel të lartë dhe për të kontribuar në menaxhimin dhe zhvillimin e politikave dhe projekteve të rëndësishme për vendin.

Në këtë pozicion të rëndësishëm, ajo ka treguar se ka mësuar shumë gjatë kësaj periudhe, duke fituar njohuri të vlefshme për proceset dhe mekanizmat që ndikojnë në funksionimin e qeverisë dhe në bashkëpun-

imin ndërmjet departamenteve dhe zyrave ligjore. Eksperiencia e saj në këtë rol ka qenë një mundësi e shkëlqyer për të parë nga afër se si funksionojnë proceset e politikave dhe si ndodhin bashkëpunimet e rëndësishme për të arritur qëllime të përbashkëta.

Yllka nuk është e vetmja studente e UBT-së që është angazhuar në institucione publike. Shumë studentë të tjerë të UBT-së janë punësuar në institucione të ngjashme, duke kontribuar në fushat përkatëse të studimit dhe duke fituar eksperiencë të vlefshme në përgatitjen për karrierën profesionale.

Studenti i UBT-së, Arbër Bajgora, pjesëmarrës në Kongresin ISC në Medical University of Graz në Austri

Arbër Bajgora, student i vitit të gjashtë në UBT, në drejtimin e Stomatologjisë, arriti një sukses të lartë me temën e tij të punuar nën mentorimin e Prof. Dr. Genc Demjaha. Tema e tij mbante titullin “Përdorimi i implanteve në protezën e veshit” dhe u vlerësua lartë nga kolegët dhe ekspertët e fushës.

Kjo arritje është një dëshmi e punës së palodhur, përkushtimit dhe standardeve të larta të përsosmërisë akademike që ofrohet në UBT. Suksesi i Arbërit është shumë i rëndësishëm brenda komunitetit akademik dhe sjell krenari për të gjithë ne.

Kongresi ISC mirëpret çdo vit mbi 200 studentë të fushave mjekësore nga qytetet universitare të Austrisë dhe vende të ndryshme të botës. Suksesi i Arbërit Bajgorës jo vetëm që sjell krenari për të, por gjithashtu frymë-



zon kolegët, studentët dhe anëtarët e fakultetit që të vazhdojnë rrugëtimin e tyre drejt përsosmërisë akademike. Edhe këtë vit, për të dytën herë radhazi, profesori Genc Demjaha është i ftuar në kongres si Profesor Chair dhe vlerësues i punimeve akademike në sesionin e Stomatologjisë të këtij kongresi, të moderuar nga Anastasi-

ya Stakhanska. Ky sukses i studentit Arbër Bajgorës është një dëshmi e qartë e punës së tij të palodhur dhe përkushtimit ndaj shkencës dhe stomatologjisë, duke kontribuar në avancimin e kësaj fushe dhe duke frymëzuar të gjithë komunitetin akademik të UBT-së për arritje të reja dhe më të larta.

Fat Tarku, nga student i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT tanimë po vazhdon studimet Master në Universitetin e Padoves në Itali



Fat Tarku, student i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, tashmë ka përfunduar suksesshëm vitin e parë të studimeve në Nivelin Master në programin Food and Health në Universitetin e Padoves në Itali.

Gjatë këtij viti, Fati ka ndjekur me përkushtim leksionet dhe ka mar-

rë pjesë në projekte kërkimore të rëndësishme, duke fituar njohuri të thella dhe praktike në fushën e tij. Përveç përparimit akademik, ai ka krijuar lidhje të vlefshme me profesorë dhe studentë nga mbarë bota, duke zgjeruar rrjetin e tij profesional.

Kjo eksperiencë jo vetëm që i ka hapur dyer të reja në karrierën e tij, por gjithashtu i ka ofruar mundësinë për të jetuar dhe mësuar në një nga qytetet më historike dhe kulturore të Italisë.

Studio edhe ti në UBT dhe përfito nga mundësitë e shumta për të vazhduar studimet në një universitet prestigjioz ndërkombëtar. UBT ka mbi 500 marrëveshje bashkëpunimi me universitete në mbarë botën, duke u mundësuar studentëve shkëmbim të përvojave dhe njohurive.

Studenti i Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturës në UBT, Armir Avdyli punësohet si menaxher i cilësisë dhe i prodhimit në Rroni Fer



Armir Avdyli, një student i suksesshëm i programit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastruk-

turës në UBT, është një shembull i historive të shumta të suksesit të studentëve në këtë fushë inovative dhe të vetme në Kosovë.

Pas përfundimit të studimeve, Armiri është angazhuar si menaxher i cilësisë dhe menaxher i prodhimit në Rroni Fer. Kjo përvojë i ka dhënë atij mundësinë të zbatojë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve në UBT.

Armiri ka ndarë përvojën e tij të jashtëzakonshme si student në UBT, ku studioi në një program të strukturuar mirë që kombinoonte teorinë dhe praktikën. Ai ka theksuar se studimi në fushën e Ndërtimtarisë në UBT ka qenë një përvojë shumë e vlefshme dhe

frytdhënëse. Programi akademik e ka përgatitur atë për sfidat e industrisë me një edukim të thellë dhe të përditësuar.

Armiri ka vlerësuar përkushtimin dhe përvojën e stafit akademik në UBT, të cilët ishin gjithmonë të gatshëm të ndihmonin studentët dhe të ndanin njohuritë e tyre.

Një arritje e veçantë për Armirin ka qenë certifikimi i produktit të rrjetave të salduara të klasës B500A nga Instituti i Ndërtimit të Kroacisë dhe Gjermanisë për herë të parë në Kosovë. Kjo arritje e veçantë nënvizon kontributin e tij të rëndësishëm në industrinë e ndërtimtarisë.

Kontributi i Drenusha Krasniqit në Neuro-Oftalmologji: Një Udhëtim nga Prishtina në Harvard

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, mirëpriti Drenusha Krasniqin, asistenten e lartë të hulumtimit në Departamentin e Neuro-Oftalmologjisë në Shkollën Mjekësore të Harvardit, në kuadër të Akademisë së Shkencave Mjekësore në UBT.

Ajo ofroi një përmbledhje të detajuar të udhëtimit akademik dhe klinik të saj, duke ndarë përvojat e saj si studente ndërkombëtare dhe hulumtuese në fazat e hershme të karrierës.

Gjatë kësaj ligjërata, ajo ndau një formë të verbërisë të nervit optik (NAION) dhe hulumtimet e fundit rreth prejardhjes dhe trajtimit të saj. Drenushë Krasniqi është e an-

gazhuar aktivisht në hulumtime translacionale dhe klinike, me fokus në teknikat e avancuara të imazherisë për vizualizimin 3D dhe 2D të nervit optik të njeriut. Me origjinë nga Prishtina, ajo ndoqi arsimimin e saj të mëtejshëm në Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Aktualisht, puna e saj si Asistente e Lartë e Hulumtimit në Departamentin e Neuro-Oftalmologjisë në Shkollën Mjekësore të Harvardit, përfshin kryesisht përdorimin e teknikave të ndryshme të imazherisë për vizualizimin 3D dhe 2D të nervit optik të njeriut për të kuptuar çrregullime të ndryshme që lidhen me të.


Ish-studenti i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturës në UBT po ndjek studimet master në universitetin më prestigjioz në Turqi

Erlind Krusha, ish-student i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturës në UBT pasi përfundoi me sukses studimet e tij në UBT, Erlindi fitoi bursën prestigjioze “Türkiye Scholarships” duke vazhduar studimet master në qytetin Eskişehir të Turqisë. Aty, ai u specializua në drejtimin e strukturës (konstruktive) në fushën e menaxhimit të ndërtimit.

“Studimet në UBT më kanë ofruar një themel të fortë akademik dhe profesional, duke më ndihmuar të zhvilloj aftësi të rëndësishme dhe të përgatitem për sfidat e ardhshme në fushën e ndërtimit dhe menaxhimit të ndërtimit”, tha ish-studenti Erlind Krusha. Gjatë periudhës së tij të studimeve

master, Erlindi tregoi përkushtim të madh dhe arriti rezultate të shkëlqyera. Me përfundimin e studimeve, ai ka punuar në disa projekte të rëndësishme, duke kontribuar në vizatimin e detajeve të ndryshme strukturore. Përvoja e tij në fushën e menaxhimit të ndërtimit dhe aftësitë e tij teknike e kanë bërë atë një profesionist të kërkuar në industrinë e ndërtimit.

Erlind Krusha është një shembull frymëzues për të gjithë studentët e UBT-së dhe të rinjtë që synojnë të arrijnë sukses në fushën e ndërtimit dhe infrastrukturës. Mbështetja dhe udhëzimet e marra gjatë studimeve të tij në UBT kanë luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e tij profesional dhe akademik.



Studentët e UBT-së përfaqësojnë me sukses Kosovën në konkursin e arkitekturës në Barcelonë



Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, nën mentorimin e Prof. Dr. Mimoza Sylejmani dhe Prof. Dr. Lulzim Beqiri, kanë fituar vëmendjen e botës së arkitekturës duke u shpallur si një nga vendet më të suksesshme në konkursin vjetor të Young Talented Architects (YTA) në Barcelonë. Beniila Marevci, Hazbi Kryeziu, Altin Gojani, Dren Nishliu, Diana Deda, Anita Nika, dhe Edita Shukriu janë pjesë e ekipit triumfues

që përfaqësoi Kosovën me krenari në këtë konkurs prestigjioz. Me projekte tërheqëse dhe inovative, studentët kosovarë treguan potencial të jashtëzakonshëm dhe njohuri të thella në fushën e arkitekturës. Në një konkurs me përfaqësues nga 27 shtete të ndryshme, ata u dalluan për aftësitë e tyre dhe për kontributin kyç në zgjidhjen e sfidave të paraqitura. Ky sukses i paparë do të ndikojë në frymëzimin e të rinjve të Kosovës dhe në ngritjen e tyre akademike dhe profesionale. Përveçse paraqitjes tejet profesionale në skenën ndërkombëtare, ata po ndryshojnë stereotipet dhe po promovojnë potencialin e vendit tonë në skenën botërore. Përmes kësaj përvoje të jashtëzakonshme, studentët treguan vlerën e arsimit të lartë në Kosovë dhe po bëjnë thirrje për më shumë investime dhe përkrahje për të rinjtë që ndërtojnë një të ardhme të ndritur për vendin tonë.

Historia e suksesit të studentes nga drejtimi Media dhe Komunikim në UBT, Rinete Makolli - tashmë menaxhere e marketingut në "Agimi Company"




Rinete Makolli, studente në nivelin master në Media dhe Komunikim në UBT, është një shembull frymëzues i suksesit dhe arritjeve në botën e komunikimit dhe marketingut. Ajo tash e një kohë është duke punuar në pozitën Head of Market-

në "Agimi Company"

ing në Kompaninë vendore "Agimi Company", duke e çuar përvojën e saj në një nivel të lartë drejt udhëheqjes. Në këtë rol, Makolli ka pasur përgjegjësi në krijimin dhe zbatimin e strategjive të marketingut për të rritur prezencën dhe ndikimin e kompanisë në treg, duke përfshirë zhvillimin e kampanjave të personalizuara, përdorimin e teknologjisë inovative, dhe ndërtimin e një ekipe të përkushtuar të marketingut. Rineta thotë se studimet e në drejtimin Media dhe Komunikim në UBT kanë shërbyer si një rrugë udhëzuese që e kanë ndihmuar në ndërtimin e një bazë të fortë të dijeve dhe aftësive profesionale. "Përmajtja e programit studimor ka përfshirë edhe aktivitetet jashtëkurrikulare dhe konferenca tematike, duke më lejuar të pasurojë dijen dhe perspektivat e mia.

Gjithsesi, studimet për profilizim në profesion kanë shërbyer si stimulim në pasionin dhe kërkesën për përsosmëri në fushën që kam zgjedhur. Eksperiencia ime gjatë studimeve ka qenë një udhëtim frymëzues dhe mbresëlënës, duke përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e mia në mënyrë të njëjtë dhe duke më bërë të ndihem e përgatitur për sfidat e tregut të punës dhe zhvillimet e ardhshme profesionale", ka thënë Makolli. Gjatë studimeve Rineta ka punuar dhe është angazhuar edhe në StudioModerna në rolin e Marketing Production Specialist. Sikurse Rineta, edhe shumë studentë të tjerë të drejtimin Media dhe Komunikim, kanë gjetur dhe janë pjesë e kompanive mediatike, dhe të tjera, duke dëshmuar vlerat cilësore dhe inovative të këtij drejtimi në UBT.

Studentja Lorika Syla e punësuar si infermiere, falë sukseseve të treguara gjatë studimeve në UBT



Lorika Syla, një shembull i vërtetë i përkushtimit dhe suksesit në fushën e shëndetit, ka përfunduar studimet për Infermeri në UBT, ajo tani po vijon suksesshëm studimet e nivelit master në Fakultetin Shëndet Publik

dhe Menaxhim, në UBT. Tashmë Lorika Syla është pjesë e ekipit në një ordinance private në qytetin e Ferizajt, një institucion shëndetësor i njohur për cilësinë dhe kujdesin e tyre ndaj pacientëve. Me përkushtim të palodhur dhe pasion për kujdesin shëndetësor, Lorika ka fituar respektin e kolegëve dhe pacientëve të saj. Ajo është një burim frymëzimi për studentët e tjerë që duan të ndjekin rrugën e suksesit në fushën e infermerisë. Suksesi i Lorikës nuk është vetëm shembull i aftësive të saj akademike, por edhe i një përkushtimi të vazhdueshëm për të avancuar dhe kontribuar në shëndetin e komunitetit. Ajo tregoi se është kënaqësi me qenë afër pacientëve që kanë nevo-

jë për përkujdesjen e saj. "Studimet në UBT ishin një udhëtim i pasur me sfida dhe mundësi, duke gjetur vlera të reja dhe njohuri. Zgjedha UBT për ambientin e tij inovativ dhe fokusin e tij në përgatitjen e studentëve për sfidat e botës reale. Për mua, UBT ka ofruar një kombinim të shkëlqimit akademik dhe mundësive për zhvillim personal dhe profesional", tregoi studentja Lorika Syla. Programi Shëndet Publik dhe Menaxhim në nivelin master në UBT, ka një staf të kualifikuar që angazhohen për zhvillimin dhe nxjerrjen e kuadrove të reja profesionale në fushën e shëndetit publik dhe menaxhimit, të cilët do të kontribuonin në të ardhmen në përmirësimin dhe avancimin e kushteve në këtë fushë.

Studentja e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, Djellona Ukaj punësohet në Qumështoren "Sharri"



Studentja e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, Djellona Ukaj është punësuar në Qumështoren "Sharri", ku punon në laboratorin e analizave fiziko-kimike të qumështit dhe aplikon njohuritë e fituara në UBT, duke kontribuar në sigurinë dhe kualitetin e ushqimeve që konsumojmë. Studimet në UBT e kanë përgatitur për sfidat dhe mundësitë në fushën e shkencave të ushqimit dhe bioteknologjisë. Ajo është e kënaqur me përzgjedhjen e UBT-së për studime.

"Përvoja ime në drejtimin e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT ka qenë një rrugëtim frytdhënës plot zhvillim dhe arritje. Gjatë kësaj periudhe, kam përqendruar studimet në njohuritë themelore të shkencave të ushqimit dhe bioteknologjisë, duke marrë pjesë në projekte dhe laboratorë që kanë pasur një ndikim të madh në zhvillimin tim profesional. Sot, përdor këto njohuri në punën time në një laborator analizash fiziko-kimike të qumështit, duke punuar drejt diplomimit dhe ndërkohë kontribuar në fushën që më apasionon", ka thënë Ukaj. Studimet në Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT i kanë shërbyer si një platformë e shkëlqyer për zhvillimin e njohurive dhe aftësive në botën e shkencave, si dhe i kanë ofruar një perspektivë të gjerë dhe sfiduese për të ndikuar pozitivisht në zhvillimin e kësaj fushe. Tani ajo punon me pasion në një laborator analizash.

Studentët e UBT-së në Urën e Re të Kukësit



Ura është simbol i lidhjes, i bashkimit, ashtu sikurse kjo e Kukësit, e cila lidh brigjet e Drinit me Rrugën e Kombit, dhe me këtë rast studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastruktura, të shoqëruar nga profesorë, kanë vizituar Urën e Re të Kukësit. Studentët e UBT-së, të shoqëruar nga profesorët: Driton Kryeziu, Arsim Rapuca, Arbër Muçaj dhe Naser Morina, u mirëpritën nga projektuesi kryesor i Urës Ing. Giorgio Rizzo, Spartak Tumani, Ceo i Albanian Highëay Concession, Besmir Ismaili H&S, Ing. Marco Spezzotto dhe Ing. Arian Hoxha. Projektuesi në detaje shpjegoi para studentëve për materialet e konstruksionit të Urës, zgjedhjen e formës së strukturës, zgjedhjen e mbështetësve, parametrat sezizmik, analizën e presionit të erës, metodën e fondimit, si dhe metodën e zhvendosjes së Urës nga kantieri i ndërtimit në lokacionin e projektuar.

Metodologjia e zhvendosjes së strukturës së Urës ishte njëra nga pikat më interesante dhe më sfiduese e projektit ku projektuesi sqaroi në detaje dhe i arsyetoi metodat e përdorura duke pasur parasysh të gjitha vështirësitë qoftë nga terreni e qoftë edhe nga niveli i ujit të liqenit. Ura e Madhe e Kukësit mbi lumin Drin është projektuar nga inxhinieri italian Giorgio Rizzo. Ka një gjatësi totale prej 310 metra, ndërsa harku metalik ka një bazë prej 270 metra, një lartësi prej 56 metra dhe peshon rreth 5000 ton. Studentët e UBT-së, patën rastin të njihen prej së afërmi me punimet në këtë Urë, dhe të marrin njohuri të reja për ndërtimet e tilla. Kjo vizitë ishte mjaft e frytshme për studentët nga aspekti praktik i njohjes së procedurave të projektimit, ndërtimit si dhe metodologjive të transportit dhe montimit në lokacionin përkatës.

Studentja e Mekatronikës në UBT, Agnesa Sopaj po vazhdon aktivitetet në kuadër të shkëmbimit studentor në Anhalt University of Applied Sciences në Köthen të Gjermanisë



Thuaji "Hallo" Agnesa Sopaj, studente e Inxhinierisë Mekatronike në UBT, e cila është në kuadër të shkëmbimit studentor në drejtimin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Anhalt University of Applied Sciences në Köthen të Gjermanisë. Përveç ndjekjes së leksioneve, ajo ka qenë në gjendje të udhëtojë duke zgjeruar perspektivën e saj ndërkombëtare. Shikoni disa nga fotografitë e saj përgjatë këtij udhëtimi akademik të shkëlqyer!

Diellza Muzliaj, ish-studente e Fakultetit Juridik në UBT zhvilloi ligjëratë të suksesshme mbi dhunën në familje



Diellza Muzliaj, një ish-studente e Fakultetit Juridik në UBT, e cila aktualisht punon në Zyren e Prokurorit të Shtetit, ka mbajtur një ligjëratë të suksesshme në kuadër të lëndës "E Drejta Familjare-Trashëgimtare". Ligjëratat e saj u zhvilluan në formën e një debati, duke përfshirë studentët në diskutimin e çështjes së dhunës në familje. Diellza Muzliaj tregoi një nivel të lartë të ekspertizës dhe një qasje të zgjuar në trajtimin e kësaj çësht-

je të ndjeshme. Pjesëmarrësit u inkurajuan të kontribuonin aktivisht në debat, duke sjellë mendime dhe analiza të thella mbi sfidat dhe zgjidhjet në lidhje me dhunën në familje. Debati u karakterizua nga një atmosferë e hapur dhe konstruktive, ku pjesëmarrësit u inkurajuan të ndanin përvojat personale dhe perspektivat e tyre mbi këtë çështje të rëndësishme shoqërore.

Mijëra vajza dhe gra zgjedhin UBT-në për zhvillim profesional në sektorin e teknologjisë informative

Zhvillimi i programeve të ndryshme të studimit, me theks në ato të teknologjisë informative, ka ngjallur një interesim shumë të madh të vajzave dhe grave për të studiuar në fushat e inxhinierisë kompjuterike, sistemeve të informacionit e me-naxhimit të mekatronikës, si dhe në Shkollën e Mesme e Teknologjisë Informative dhe Elektroteknike.

UBT ka promovuar vazhdimisht vlerat që vajzat dhe gratë kanë në shoqëri edhe në profesione ku zakonisht numri i tyre është i vogël. Për këtë, me kalimin e viteve në UBT numri i studenteve që kanë studiuar dhe janë duke i vazhduar studimet në sektorin e ICT-së është rritur dukshëm, duke shkuar numri i përgjithshëm i tyre në mbi 2500 studente femra që kanë zgjedhur për të vazhduar rrugëtimin e tyre akademik në këtë fushë.

Tashmë ekosistemi i UBT-së, i cili përfshin edhe Gjimnazin TIK, u jep mundësi vajzave të bëhen pjesë që nga shkollimi i mesëm i lartë dhe të vazhdojnë edhe në nivelet më të larta bachelor dhe master në drejtimet e TIK-ut. UBT është kthyer në vendin ideal për zhvillimin e tyre akademik, profesional dhe personal. Në Ditën Ndërkombëtare të Vaj-



zave në ICT, UBT ashtu siç ka vepuar edhe më herët, vazhdon të promovojë vlerat e gjinisë femërore në këtë fushë, duke ditur aftësitë dhe shkathhtësitë që ato kanë në teknologjitë informative, kësaj duke iu ofruar edhe kushte moderne infrastrukturore për zhvillimin e tyre në karrierë.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka thënë se numri i vajzave që po zgjedhin këtë fushë është në rritje e sipër dhe se UBT vazhdon të

jetë i përkushtuar në mbështetjen e tyre në këtë drejtim, duke iu ofruar mundësi për zhvillim jo vetëm për tregun vendor por edhe për atë global. Gjithashtu, Shkolla e Mesme e Teknologjisë Informative dhe Elektroteknike në UBT është vendi ideal për zhvillimin e vajzave në ICT.

“Çfarë na motivon dhe na bën krenar në të njëjtën kohë, është fakti se numri i studenteve që zgjedhin për të studiuar në sektorin e ICT-së

është në rritje të vazhdueshme. UBT është institucioni që i mbështetë vajzat të cilat zgjedhin për të studiuar në këtë sektor, me bursa studimi e me mundësi të tjera që ua lehtësojnë studimet, sepse UBT beson në shkathhtësitë e tyre dhe se vizioni ynë është që ato do të jenë inovatorët e së ardhmes dhe përfaqësueset e Kosovës në arenën ndërkombëtare për teknologji dhe inovacion”, ka thënë Rektori Hajrizi.

Në këtë sektor, shumë vajza dhe gra

tashmë të diplomuara, e disa edhe që janë duke i vazhduar studimet, veçse janë ambientuar në tregun e punës, kanë biznese personale, udhëheqin kompani lidere, janë pjesë e stafit të UBT-së, po vazhdojnë studimet jashtë vendit duke marrë praktika të njohura ndërkombëtare, si dhe janë pjesë e institucioneve vendore e ndërkombëtare.

Fakulteti Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, është shkolla më e madhe e teknologjisë në vend, që ofron kushte moderne dhe profesionistët më të mirë që ka vendi nga kjo fushë, duke u pasuar nga Fakulteti Sistemet e Informacionit dhe Fakulteti Menaxhim i Mekatronikës, që për çdo vit pranojnë qindra studente femra në këto programe studimi.

UBT përveçse i kushton një vëmendje të veçantë Ditës Ndërkombëtare të Vajzave në ICT, përmes kampanjave promovuese, aktiviteteve të ndryshme, diskutimeve me qytetarë dhe studentë, si dhe kategori të ndryshme të shoqërisë, vazhdimisht bën thirrje që vajzat dhe gratë të angazhohen dhe të vazhdojnë karrierën e tyre profesionale në këtë sektor pa marrë parasysh sfidave që mund të hasin.

Studenti i UBT-së, Lirim Hyseni po vazhdon të zhvillojë karrierën e tij profesionale duke punuar si Front End Developer në kompaninë Solutions




Studenti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Lirim Hyseni është duke vazhduar suksesshëm të zhvillojë karrierën e tij duke punuar si Front End Developer në kompaninë Innovative Solutions në Kosovë, me seli në Belgjikë.

Lirimi ka thënë se përvoja e tij në UBT ka qenë me sfida të shumta, por ka qenë një fazë e rëndësishme për zhvillimin e tij profesional. Ai vlerëson nivelin e lartë të cilësisë së mësimdhënies dhe resurseve të ofruara nga UBT, duke theksuar se kjo i ka lejuar të fitojë njohuri thelbësore në fushën e shkencave kompjuterike dhe inxhinierisë.

“Studimet në UBT ishin mjaft sfiduese dhe një eksperiencë shumë e mirë për hapat e para në karrierë si zhvillues softueri. Zgjedhja për të filluar studimet në UBT ishte për shkak të reputacionit në treg dhe programeve inovative në fushën e programimit, si një ndër liderët në vendin tonë”, ka thënë Hyseni.

Rruga e Suksesit për Nezir Spancën: Nga UBT në Master në Universitetin e Shtutgartit dhe punë në Kompaninë “Stadtwerke Tübingen”



Programi i Inxhinierisë së Energjisë në UBT i dha një kuptim gjithëpërfshirës të parimeve themelore të prodhimit, shpërndarjes dhe përdorimit të energjisë,

me fokus të veçantë në fushën e energjisë elektrike, ish-studentit Nezir Spanca, i cili po vazhdon studimet Master në Universitetin e Shtutgartit, në Fakultetin e “Inxhinierisë Elektrike” me specializim në fushën e “Furnizim i Qëndrueshëm me Energji Elektrike”.

Krahas studimeve Neziri është i punësuar me kohë të pjesshme në kompaninë “Stadtwerke Tübingen”, e cila bën shpërndarjen e energjisë elektrike në regjionin ku jeton. Ai është në departamentin e zhvillimit strategjik.

“Edukimi dhe përvojat që kam fituar gjatë kohës sime në UBT kanë qenë thelbësore në formësimin e rrugëtimin tim profesional dhe në përgatitjen time për sfidat

dhe mundësitë që kam përpara”, ka thënë Spanca. Ai veçanërisht vlerëson rëndësinë e tyre në një mjedis akademik të përballueshëm si Gjermania, ku aftësitë analitike janë thelbësore për zgjidhjen e sfidave në fushën e inxhinierisë.

“Por, një gjë që do të dëshiroja të cekja me doemos është se, aftësitë analitike që kam zhvilluar në UBT kanë qenë të paçmueshme në ndjekjen time të arsimit të lartë, veçanërisht në një mjedis akademik konkurrues si Gjermania, e cila është e njohur për theksin në aftësitë analitike dhe përdorimin e këtyre aftësive për zgjidhjen e problemeve në fushën e inxhinierisë”, është shprehur Spanca.

Studenti Dion Bardhi krijon biznesin ‘Partners in Diet’ për shëndetin dhe mirëqenien



Studenti Dion Bardhi, i cili po ndjek nivelin master në Fakultetin e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, ka shndërruar pasionin për ushqimin dhe mirëqenien në një biznes të suksesshëm, duke themeluar “Partners in Diet”. Biznesi, i cili është në funksion që dy vite tashmë, ofron shërbime të ndryshme me fokus në shëndet-

tin dhe mirëqenien e individëve. Bardhi shpreh se inspirimi për këtë iniciativë vjen nga përvoja e tij akademike në UBT, ku ai ka fituar njohuri në fushën e ushqimit dhe nutricionit.

Bardhi ka theksuar rëndësinë e studimeve akademike, duke e vlerësuar UBT-në si një institucion që prodhon profesionistë të suksesshëm dhe të përkushtuar. Ai thekson se mungesa e vetëdijesimit në fushën e nutricionit në vendin tonë e bën iniciativën e tij më të rëndësishme se kurrë.

Me qëllimin e tij për të sjellë ndryshime pozitive në komunitetin e tij dhe për të kontribuar në mirëqenien e individëve, Bardhi tregon se “Partners in Diet” është një frymë e re dhe e nevojshme për vendin tonë.

Qëllimi i programit Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT është që nëpërmjet një edukimi të mirë planifikuar dhe aplikimit praktik e shkencor, t’u ofrojë studentëve përvojat më bashkëkohore në fushën e shkencës dhe teknologjisë së ushqimit.

Studentja e Arkitekturës në UBT, Merita Shabani ka përfunduar suksesshëm shkëmbimin studentor në Dessau DIA Hochschule Anhalt në Gjermani



Merita Shabani, studente e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, ka përfunduar suksesshëm shkëmbimin studentor në Dessau DIA Hochschule Anhalt në Gjermani.

Ajo përveç ndjekjes së leksioneve, njohjes me studentë nga vende të tjera dhe përfitimit të eksperiencave studentore, ka qenë në gjendje të udhëtojë duke zgjeruar perspektivën e saj ndërkombëtare. Shikoni disa nga fotografitë e saj përgjatë këtij udhëtimi akademik të shkëlqyer!

Studentja e Fakultetit të Radiologjisë, Endrita Berisha punësohet në klinikën “Imperium”



Fakulteti i Radiologjisë në UBT po nxjerr vazhdimisht kadro profesionale të cilët gjejnë lehtësisht qasje në tregun e punës. Kjo është një dëshmi e suksesit të programit dhe angazhimit të studentëve në zhvillimin e tyre profesional.

Studentja e Fakultetit të Radiologjisë, Endrita Berisha, pas përfundimit të studimeve ka bërë një hap të rëndësishëm drejt karrierës së saj profesionale duke u përfshirë në ekipin e klinikës “Imperium”. Përvoja e saj e pasur dhe aftësitë e zhvilluara në këtë fushë e kanë bërë atë një anëtare të çmuar të

ekipit në këtë klinikë. Endrita tregon se përzgjedhja e institucionit të duhur për të ndjekur një karrierë të suksesshme është një hap i rëndësishëm në rrugën drejt suksesit profesional. Ajo thotë se UBT ka qenë mundësia më e mirë për ngritjen e saj profesionale.

“Duke kërkuar për një institucion të arsimit të lartë sa më të përshatshëm për shkollimin tim në nivelin bachelor në drejtimin e infermierisë, mora shumë informata përmes rrjeteve sociale dhe rrethit tim shoqëror në lidhje me UBT-në, dhe bazuar në këtë pashë se ky institucion i përgjigjej edhe kërkesave të mia për shkollim të lartë”, ka thënë ajo.

Fokusi i Fakultetit të Radiologjisë në përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës është një aspekt i rëndësishëm për arritjen e suksesit. Mundësia për të përfshirë praktikën dhe përvojën e fushës në programet e studimit ndihmon studentët të zhvillojnë njohuri dhe aftësi konkrete, të cilat janë të nevojshme në mjediset e punës reale.

Studentja e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Arneida Muçiqi një histori e veçantë suksesi

Arneida Muçiqi, një nga studentet e programit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, vazhdon të angazhohet dhe të ketë suksese në skenën ndërkombëtare të arkitekturës. Pas përfundimit të studimeve në UBT, ajo është angazhuar në projekte të dizajnit të brendshëm nga Amerika, si pjesë e Ciao Bertos. Arneida ka sjellë një kontribut të jashtëzakonshëm në projekte për kompani prestigjioze si Eco Clean



and Energy, Organizata SpaceSyn-taKs dhe Organizata ShPRK. Përvoja e saj e pasur përfshin fitimin e çmimeve në garat e ndryshme të arkitekturës, duke e bërë atë një shembull të dalluar në botën e arkitekturës moderne. Arneida është gjithashtu aktive si vullnetare në Foss4g, Chwb dhe Kosovo Architecture Foundation, duke treguar përkushtimin e saj ndaj komunitetit dhe fushës së

arkitekturës. Historia e saj është një frymëzim për studentët tjerë të UBT-së dhe dëshmon cilësinë e lartë të arsimit që ofron ky institucion. Ajo ka treguar përkushtimin e UBT-së ndaj ofrimit të një arsimit cilësor dhe ndihmën në formimin e liderëve të ardhshëm në fushën e arkitekturës. “Zgjedha UBT-në për shkak të reputacionit të tij të mirë në fushën e arkitekturës dhe angazhimit ndaj

zhvillimit profesional të studentëve. Kisha dëgjuar shumë për programin e tyre inovativ dhe për qëndrimin e tyre ndaj projekteve praktike, çka më bëri ta shikoj atë si një zgjedhje të shkëlqyeshme për studimet e mia në arkitekturë”, ka thënë Muçiqi. UBT vazhdon të ketë për fokus suksesin e studentëve të tij, duke ndihmuar ata të shpërfaqen në skenën ndërkombëtare dhe të gjejnë mundësi të shkëlqyera profesionale.

Në UBT hapet laborator i madh i Inteligjencës Artificiale



Përmes Qendrës Inovative në UBT Dukagjini është hapur Laboratori më i madh i Inteligjencës Artificiale, ku UBT ka investuar në 2 SUPER kompjuterë që shërbejnë për testimet në fushën e Inteligjencës Artificiale dhe ata do të përdoren nga studentët, stafi dhe industria për testimin e modeleve, algoritmeve dhe manipulimin me BiG Data. Industritë amerikane kanë shprehur interesim në bashkëpunimin mes stafit, studentëve që të bashkëpunojnë në projekte inovative në fushën e AI. Në kuadër të takimit mes stafit dhe studentëve të UBT-së dhe përfaqë-

suesve të kompanisë amerikane XpotentL Data, Tom Johnstone, Matt Arellano dhe Drilon Jaha, janë prezantuar disa projekte që janë realizuar në kuadër të temave të diplomës në nivelet bachelor, master dhe doktoratë. Kompania që vizitoi Laboratorin e Inteligjencës Artificiale pati shansin të shikojë projektet që studentët kanë bërë dhe u impresionuan me punën e tyre dhe në të njëjtën kohë u bindën se në UBT ka potencial për bashkëpunim në marrjen e kuadrove të reja, testimin e produkteve të tyre në laboratorët e UBT-së.

UBT organizoi Hackathon-in e quajtur Smart City Solutions në Festivalin e Shkathtësive Digjitale në Prizren



Në kuadër të eventit “Digital Skills Festival” që u organizua në ITP, UBT ka organizuar Hackathon-in e quajtur Smart City Solutions. Në këtë hackathon morën pjesë ekipet nga UBT, si dhe nga universitetet e tjera. Ekipet që morën pjesë në Smart City Solutions nga UBT janë: Milot Morina; Arianita Gashi; Gent Jusufi. Rilind Simnica; Loresa Gosha; Adea

Piperku; Elona Hyseni; Drin Avdiu. Elsa Morina; Yllnora Gashi; Mjellma Purellku. Përveç këtyre, kombinime të studentëve të UBT dhe institucioneve të tjera morën pjesë në garën e hackathonit të organizuar nga UBT: Dhurim Çitaku; Diar Haxhimemeti; Erzen Çitaku. Lirim Ymeri; Altin Pajaziti; Blendi Limani; Denis Shala; Alma Hoxha. Donjeta Ramadani;

Olti Krasniqi; Jona Mehmeti; Rita Mehmeti. Bleron Jashanica; Ali Mollli; Admir Hoxha; Erza Zeka. Studentët e UBT-së gjithashtu morën pjesë në hackathon-at e organizuara nga organizatorët e tjerë: Hackathon-i: Securing the Digital World: Dhurim Arllati; Lis Pruthi; Abian Morina; Sead Duraki. Hackathon-i: IoT for Green Transition: Rrezon Krasniqi; Dea Sejdiu; Anesa Haskuka; Enes Paçarizi. Në pjesën e jurisë, pjesëmarrësit ishin: Greta Ahma – Hack for Green; Elton Boshnjaku – IoT Smart Agriculture; Agim Zuzaku – Smart City Solutions; Behar Haxhismajli – Datathon; Elita Hajrizi – IoT for Green Transition; Vehbi Sofiu – AI for Green; Naim Llumnica – Young Innovators. Për garën Smart City Solution organizimi ishte nën mbikëqyrjen e Departamentit për Produkte dhe Zhvillime Profesionale, me drejtues Besnik Skenderi dhe Albiona Musa.

Filmi me regji dhe skenar të ish-studentit të UBT-së, Durim Klaiqi, i përzgjedhur nga 7 festivale ndërkombëtare



Filmi eksperimental i metrazhit të shkurtër “reMemBer2.human” (fanta-shkencë) me regji dhe skenar të ish-studentit të Fakultetit Dizajn i Integruar në UBT, Durim Klaiqi, është përzgjedhur nga 7 festivale të filmit, kryesisht në Evropë, dy prej të cilave edhe kanë ndarë çmime

për këtë film. Filmi kryesisht ka për qëllim eksplorimin dhe eksperimentimin me inteligjencë artificiale gjeneruese dhe sistemet kuantike në aspekt konceptual. Sipas ish-studentit Klaiqi vitet e studimeve në UBT kishte lëndë të ndryshme prej të cilat ka mësuar për artin dhe lidhjen e tij me dizajnin dhe shoqërinë në përgjithësi. “Përgjatë 3 viteve të studimit në UBT kishte lëndë të ndryshme si: Artet e Bukura, Fenomenologji e Artit, Teknikat e vizualizimit, Dizajn Studio e shumë të tjera, të cilat më kanë mësuar për artin dhe lidhjen e tij me dizajnin dhe shoqërinë në përgjithësi. Disa nga aktivitetet dhe detyrat që kanë qenë pjesë e studimeve kanë zgjeruar njohuritë tona, sidomos në fushën e eksperiment-

timit – gjë që është e rëndësishme për të gjetur stilin dhe gjuhën tonë komunikuese në krijimet tona”, ka thënë Klaiqi. Ai tutje ka thënë se “profesorët të cilët kanë ndarë dijen dhe përvojat e tyre kanë qenë ndihmesë e madhe për të kuptuar potencialin dhe ndikimin e krijimeve tona artistike”. Aktualisht Durim Klaiqi është partner në pozitën “Theme Designer” për kompaninë Samsung në sektorin e Galaxy Themes (disa raste pozita shënohet edhe si Samsung Themes Partner). Galaxy Themes është një shërbim që ofrohet në telefonat Samsung që mundëson personalizimin e pajisjes Android, përmes dizajneve të ndryshme të User Interface-it.

Studenti Dren Ibrahim ka përfunduar një praktikë gjashtë mujore të inxhinierisë softuerike në GMV GmbH në Gjermani



“Gjatë viteve të studimit në UBT kam pasur mundësinë të eksploroj gjerësisht fushën e shkencave kompjuterike, e cila më dha një ide më të mirë se çka më pëlqen më shumë si specializim”, është shprehur student Dren Ibrahim, i cili sapo ka përfunduar me sukses një praktikë gjashtë

mujore të inxhinierisë softuerike në GMV GmbH, Gjermani, në kuadër të bursës së Internship Programme of German Business. Përvoja atje ishte e veçantë sepse iu ofrua mundësia të punojë në softuere të satelitëve të agjensioneve hapësinore si European Space Agency ESA dhe EUMETSAT. Puna e Drenit përfshinte mirëmbajtjen e Mission Control Systems të disa satelitëve ku herë pas here shfaqen gabime të cilat zgjidhen nga inxhinierët e softuerit. Përveç kësaj, Dreni, si shumë studentë të tjerë ka mundur të eksplorojë vende të ndryshme dhe të zgjerojë perspektivën e tij ndërkombëtare!

Studentët e Fakultetit Shkencat të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, target i industrive ushqimore në Kosovë



Studentja e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, Argjenda Thaqi, ka filluar punën pranë Industrisë Ushqimore “Gastronomix”, si përgjegjëse për Kontrollin e Cilësisë së Ushqimit, duke filluar nga lënda e parë, monitoron dhe kontrollon cilësinë e procesit të prodhimit deri te produkti final. Studentja Argjenda Thashi, është

shumë e kënaqur me përvojën e arritur në UBT dhe mbështetjen e stafit akademik pranë Fakultetit Shkencat të Ushqimit dhe Bioteknologji. Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologji vazhdon bashkëpunimin me qindra kompani, apo industri prodhuese dhe përpunuese të sektorëve të ndryshëm në Kosovë dhe më gjerë.

Studenti i Inxhinierisë së Ndërtimit në UBT, Fatbardh Jakupi po punon si menaxher i projekteve në fushën e infrastrukturës rrugore në Kompaninë Bageri Group



Fatbardh Jakupi, një student i suksesshëm i UBT-së, tani është pjesë e kompanisë Bageri Group dhe drejton rolin e menaxherit të projekteve

në fushën e infrastrukturës rrugore. Fatbardhi tregon se studimet e tij në UBT ishin një nga eksperiencat më frytdhënëse që ka përjetuar. Duke përfshirë programin e tij Master në Inxhinieri të Ndërtimit dhe Infrastrukturës, ai ka përfituar një ndërlidhje të thellë midis njohurive teorike dhe praktikës profesionale në fushën e ndërtimit. “Studimet në UBT ishin një ndër eksperiencat e mia më të mira që i kam kaluar. Studimi në programin Master Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturës, më ofroi një ndërlidhje të njohurive në fushën e ndërtimit të infrastrukturës. Lidhja e teorisë dhe praktikës i bëri më të

veçanta nivelin e studimeve. Përveç ligjëratave që i zhvillonim me profesorë, përvoja ime nga Bachelor-i u bë urë lidhëse dhe më forcuese në ngritjen time profesionale”, është shprehur Jakupi. Pas kryerjes së programit Master, Fatbardhi u bashkua me kompaninë Bageri Group, ku aktualisht ka rolin e përgjegjësit në Autostradën Prishtinë – Podujevë. Suksesi i tij në karrierë është një dëshmi e qartë e lidhjes së ngushtë midis arsimit të tij në UBT dhe arritjeve të tij profesionale në fushën e infrastrukturës rrugore.

Studentja e Psikologjisë në UBT, Leona Aliu po punon si terapiste në klinikën EMOS



Eksperiencia akademike e studentes së Psikologjisë në UBT, Leona Aliu, ka shërbyer si frymëzim për të vazhduar drejt avancimit të saj profesional, por edhe për të kontribuar në zhvillimin e kësaj fushe. Leona është punësuar si terapiste në Klinikën EMOS, nga e cila ka arritur deri tani të kuptojë sfidat dhe ne-

ojat e fëmijëve me autizëm dhe kjo i ka dhënë asaj një perspektivë të re dhe të pasur për fushën e psikologjisë terapeutike.

Ajo ka vlerësuar se në UBT ka gjetur një mjedis frymëzues dhe përkrahës për të zhvilluar aftësitë e saj në këtë fushë.

“UBT më ka ofruar një mjedis frymëzues dhe përkrahës për të zhvilluar aftësitë e mia në këtë fushë të ndjeshme. Sfidat dhe arritjet gjatë këtij udhëtimi në UBT më kanë bërë të rritem dhe të zhvillohem si individ dhe si profesioniste. Eksperiencia ime në UBT do të mbetet gjithmonë një kapitull i rëndësishëm në jetën time dhe një bazë e fortë për të vazhduar përpara në karrierën time si psikologe”, ka thënë Aliu.

Studenti i UBT-së, Bernard Kastrati ka krijuar një platformë unike Kërkomjeshtë.com, synon të krijojë një lidhje efikase dhe të lehtësojë bashkëpunimin në fushën e shërbimeve



Studenti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Bernard Kastrati ka arritur të krijojë një platformë unike, sikurse Kërkomjeshtë.com, e cila do të shërbejë si një urë lidhëse në mes kompanive dhe klientëve, duke siguruar qasje më efikase për gjetjen dhe ofrimin e shërbimeve.


Përmes aplikacionit Kërkomjeshtë.com, njerëzit do të kenë më të lehtë të shohin informacione rreth kompanive të ndryshme, vlerësime nga klientët e mëparshëm, të regjistruhen nëse janë individë të vetëpunësuar me një shërbim për të ofruar, si dhe kërkimin e punës jashtë vendit, përkatësisht në Evropë.

Klientët gjithashtu kanë mundësi të postojnë kërkesa për të gjetur mjeshtrë të kualifikuar për projektet e tyre. Kërkomjeshtë synon të krijojë një lidhje efikase dhe të lehtësojë bashkëpunimin në fushën e shërbimeve. Sipas Bernardit, UBT-ja i ka ofruar një mjedis të përshtatshëm akademik, të cilin e karakterizon stafi i dedikuar dhe programet e veçanta. “Sa i përket programit, kam patur fatin të përfshihem në disa projekte dhe kurse që kanë kontribuar në përmirësimin e njohurive dhe aftësive të mia në fushën time të studimit. Profesorët dhe mentorët kanë qenë gjithmonë të gatshëm për të ndihmuar dhe udhëzuar, duke krijuar një ambient stimulues për mësim dhe zhvillim personal”, ka thënë Kastrati.

krijojë një lidhje efikase dhe të lehtësojë bashkëpunimin në fushën e shërbimeve.

Sipas Bernardit, UBT-ja i ka ofruar një mjedis të përshtatshëm akademik, të cilin e karakterizon stafi i dedikuar dhe programet e veçanta. “Sa i përket programit, kam patur fatin të përfshihem në disa projekte dhe kurse që kanë kontribuar në përmirësimin e njohurive dhe aftësive të mia në fushën time të studimit. Profesorët dhe mentorët kanë qenë gjithmonë të gatshëm për të ndihmuar dhe udhëzuar, duke krijuar një ambient stimulues për mësim dhe zhvillim personal”, ka thënë Kastrati.

Studenti i UBT-së, Leotrim Januzaj po punon si ndihmës inxhinier dhe në realizimin e projekteve në kompaninë gjermane Ch. Trost GmbH në Berlin



Studenti i Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura në UBT, Leotrim Janu-

zaj po punon si ndihmës inxhinier në kompaninë gjermane Ch. Trost GmbH në Berlin, dhe me këtë rast ai është angazhuar edhe në realizimin e projekteve të kësaj kompanie.

Leotrimi ka thënë se në këtë aspekt e kanë ndihmuar angazhimi i stafit akademik dhe mbështetja e tyre, duke avancuar në njohuritë rreth fushës së ndërtimit dhe inxhinierisë.

Gjatë këtyre viteve të studimeve dhe fal angazhimit të profesorëve kam arritur që të përfitoj përvojë dhe dije, ku tani qe tre vite jam pjesë e

një kompanie gjermane Ch. Trost GmbH me seli në Berlin dhe Dettlingen (Stuttgart). Punën që e bëj është hibride, shumicën e bëj nga Kosova, por në momente të caktuara udhëtoj edhe për në Gjermani”, ka thënë Januzaj.

Studentët e Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit (Ndërtimtari) dhe Infrastruktura në UBT arrijnë të demonstrojnë dhe aplikojnë njohuritë e fituara dhe t'i zërthejnë ato në terma praktik dhe të matshëm përmes punës planifikuese, projektuese dhe realizuese në lëminë e ndërtimit.

Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim, Florinda Kelmendi punësohet në portalin Kallxo.com



Studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Florinda Kelmendi është punësuar në Rrjetin e Ballkanit për Gazetari Hulumtuese (BIRN), në cilësinë e gazetares hulumtuese në portalin Kallxo.com. Studimet për Florindën në Media dhe Komunikim ishin ndër eksperiencat më të mira. Ajo ka thënë se ky

program studimi i ka ofruar asaj një ngjyrim të njohurive që lidheshin me fushën e medias.

“Studimet në UBT ishin një ndër eksperiencat më të mira që kam kaluar. Programi “Media dhe Komunikim” të ofronte një ngjyrim të njohurive që lidheshin me fushën e medias. Gërshetimi në mes teorisë dhe praktikës i bënte të veçanta studimet. Përveç ligjëratave që i zhvillonim me profesorë, artikujt tanë botoheshin në portalin UBT News e zëri ynë dëgjohej në Radio Campus”, ka thënë Kelmendi.

Shumica e studentëve të Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, apo rreth 98% e tyre, tashmë janë të punësuar në mediat vendore dhe ndërkombëtare, ku raportojnë dhe përcjellin ngjarje, si dhe hulumtojnë dhe verifikojnë lajme për raste specifike.

Studenti i UBT-së, Flakron Kabashi punësohet si teknolog i ushqimit në Gjermani

Studenti i Fakultetit Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, Flakron Kabashi është punësuar si teknolog i ushqimit në kompaninë “Pfalzgraf Konditorei GmbH”, në Gjermani.

Sipas Kabashit, kushtet e mira infrastrukurore dhe programi i veçantë i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, i kanë ndihmuar që të avancojë njohuritë e tij rreth kësaj fushe.

“UBT-në zgjedha për shkak të kushteve shumë të mira të studimit,



e sidomos atyre laboratorike. Pastaj ndërldhjes së teorisë me praktikat e shumta në kompani vendore dhe rajonale dhe normalisht ligjërimet

cilësore të përafërta me universitetet më të mira botërore, pa haruar të cekë edhe inovacionin dhe teknologjinë që nuk kanë munguar asnjëherë në UBT”, ka thënë Kabashi.

Qëllimi i programit Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT është që nëpërmjet një edukimi të mirë planifikuar dhe aplikimit praktik e shkencor, t'u ofrojë studentëve përvojat më bashkëkohore në fushën e shkencës dhe teknologjisë së ushqimit.

Katedra e Kirurgjisë Orale në UBT vazhdon me suksese në realizimin e operacioneve




Katedra e Kirurgjisë Orale në UBT vazhdon të shënojë suksese me intervenimet kirurgjike. Një operacion Impaction d 48 u realizua me sukses nga asistentët e kirurgjisë orale së bashku me studentët e vitit të katërt nga Dega Stomatologji në UBT.

Ekipi i kirurgëve oralë dhe asis-

tentëve që realizuan operacionin: Dr. Spec. Agron Dushi; Dr. Spec. Vullnet Fazliu; Instrum. Lendita Hyseni.

Zgjedhja e ekipit më të mirë dhe angazhimi në përmirësimin e aftësive profesionale të studentëve është një nga synimet kryesore të Fakultetit të Stomatologjisë në UBT.

Ish-studenti i UBT-së, Butrint Mujku, tashmë një nutricionist i suksesshëm mbajti një ligjëratë tematike me studentët e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë



Studentët e drejtitimit Nutricion, dega në Prizren realizuan një ligjëratë tematike me ish-studentin e UBT-së,

Butrint Mujku, i cili zhvilloi temën “Si të veprojmë pas mbarimit të studimeve dhe të jemi në hap me kohën”. Gjatë prezantimit studentët mësuuan të hartojnë një dietë cilësore duke ndjekur disa hapa që çojnë në rezultatet e duhura dhe të pritshme. Ata bashkëbiseduan me Mujkun edhe se si të njohin literaturën që i ndihmon në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të tyre, kur përballesh me raste konkrete

në punën si nutricionist. Gjithashtu njëra nga temat e folura gjatë ligjëratës ishte edhe dietat të cilat duhet shmangur, duke u njohur me termin ‘FAD – DIETS’ dhe mënyrën se si funksionojnë dietat apo edhe se përse dështojnë dietat.

Në fund të ligjëratës, Butrinti tregoi edhe disa këshilla profesionale se si të jenë të suksesshëm në profesionin e nutricionistit.

Studentët e UBT-së triumfojnë në disa kategori në Festivalin e Shkathtësive Digjitale në ITP



Ekipi i UBT-së, i përbërë nga studentët Milot Morina, Arianita Gashi dhe Gent Jusufi, ka zënë vendin e parë

në Hakathonin e Smart City Solution. Vendin e parë e arritën edhe studentët Gerta Ahma, Klea Kasapollit, Anila

Mati dhe Zana Shala, në kategorinë AI For Green.

Në kategorinë Securing the Digital World, vendi i tretë i takoi ekipit të studentëve të UBT-së, Dhurim Arllati, Lis Pruthi, Abian Morina dhe Sead Duraki.

UBT gjithashtu u shpall fitues në garën Hack for Green, duke zënë vendin e dytë dhe të tretin, ndërsa në garën IoT for Green Transition, UBT zuri vendin e tretë.

Studentja e Shkencave Politike në UBT, Dea Berisha punësohet në Portalin UBTnews



Studentja e Fakultetit Shkenca Politike në UBT, Dea Berisha pas suksesit të treguar në studime është punësuar në Portalin UBTnews, ku është angazhuar si gazetare dhe përcjell ngjarjet e ditës, të vendit, rajonit dhe botës.

Dea ka thënë se UBT ndërthurë pjesën teorike me atë praktike, dhe me këtë rast asaj iu është ofruar mundësi e praktikës edhe më herët në mediumin UBTnews.

“UBT ka qenë mundësia ime që më ka ngritur lart në botën e gazetarisë, ku çdo ngjarje është një hap drejt njohurive të reja dhe një rrugë e pasqyruar drejt ndikimit pozitiv në shoqëri. UBT është jo vetëm një institucion arsimor, por një aventurë e paharrueshme e zhvillimit personal dhe profesional”, ka thënë Berisha.

Në një ceremoni solemne ndahen bursat studentore nga Fondacioni "UBT Jim Xhema"

Në një organizim të veçantë, Fondacioni "UBT Jim Xhema" ka ndarë bursa për studentët më të dalluar të UBT-së. Ky fondacion, i themeluar për të mbështetur ekselencën akademike dhe për të krijuar mundësi të reja për studentët shqiptarë, shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të edukimit dhe zhvillimit shoqëror.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin figura të njohura nga fusha e arsimit, politikës dhe biznesit, përfshirë Kryetarin e Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, Kryetarin e Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Diasporë, Naim Dedushaj, përfaqësues të familjes Xhema, Dr. Skënder Osmani dhe personalitete të tjera të njohura nga fusha e arsimit dhe biznesit.

Përfituesit e bursave ishin studentët e të gjitha trojeve shqiptare, nga Medvegja, Bujanoci, Presheva, Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

Diana Ibishi, Aurela Kamberi, Erlinda Zeneli, Valëza Rukovci, Eljesa Aliu, Sihana Hafuzi, Ediol Dragoti, Bledi Ramadani, Flora Çadraku, Jona Maliqi, Berni Guze, Arif Emiri, Dzenis Kanacevic dhe Arbresha Temaj ishin emrat e studentëve që u vlerësuan ekselentë për të marrë këtë bursë.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, gjatë fjalës së tij në ceremoninë e ndarjes së bursave nga Fondacioni "UBT Jim Xhema", theksoi rëndësinë e kësaj iniciative dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të Jim Xhemës për të rinjtë dhe arsimimin. Ai vuri në dukje se kjo nisim është shumë më tepër sesa dhënie e bursave, duke e konsideruar si një mundësi për të ndryshuar të ardhmen e Kosovës dhe për të siguruar mbështetje për studentët që janë të dedikuar për të ndërtuar një shoqëri më të zhvilluar.



"Fondacioni 'UBT Jim Xhema' është një model që dëshmon se investimi në arsim nuk është thjesht një ndihmë për individët, por një bazë e fuqishme për të ndryshuar shoqërinë në tërësi", tha Rektori Hajrizi, duke shtuar se ky akt është një shtysë për të rinjtë dhe një hap përpara në ndihmën që ata mund të ofrojnë për zhvillimin e vendit. Rektori gjithashtu e përmendi kontributin e jashtëzakonshëm të Jim Xhemës në avancimin e arsimit dhe kulturës, duke theksuar se ky është një investim që ka një ndikim të thellë dhe të gjatë. Ai theksoi: "Ky akt fisnikërie është vetëm një pjesë e përkushtimit të vazhdueshëm të z. Xhema, i cili ka investuar pa u lodhur në fushat e arsimit, kulturës dhe avancimit profesional të të rinjve. Një shembull i gjallë i këtij përkushtimi është emërtimi i një objekti në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së me emrin e tij". Kjo tregon jo

vetëm mirënjohjen e institucioneve për këtë figurë të shquar, por edhe një testament të qëndrueshmërisë së angazhimit të tij për të rinjtë. Në fund të fjalës së tij, Rektori Hajrizi iu drejtua studentëve duke i inkurajuar ata që të shfrytëzojnë mundësitë që u ofrohen, duke u bërë gjithashtu një forcë për ndryshim në shoqërinë e Kosovës. "Ju jeni dëshmia e gjallë se përkushtimi, ambicia dhe puna e palodhur shpërblehen. Sot nuk është vetëm një mundësi për të përparuar, por edhe një përgjegjësi për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të mirë, përmes dijes dhe inovacionit", tha ai, duke theksuar rolin e rëndësishëm që kanë studentët në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për të gjithë. Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, gjatë fjalës së tij në këtë ngjarje solemne, theksoi rëndësinë e përkushtimit të Jim Xhemës për arsimin dhe rininë

shqiptare. Ai e cilësoi këtë iniciativë si një akt që tejkalon dhënie e bursave, duke përshkruar atë si një ndihmesë të madhe për të ardhmen e Kosovës.

"Sot nuk jemi thjesht këtu për ta shënuar një akt bamirësie. Sot, jemi dëshmitarë të një gjesti që ndërthur historinë me të ardhmen", tha ai, duke theksuar se ky është një hap përpara në ndihmën për zhvillimin e Kosovës. Kryetari Rama e përshkroi Jim Xhemën si një hero të padiskutueshëm, një figurë kyçe që ka ndihmuar në avancimin e çështjes shqiptare, veçanërisht gjatë periudhës më të vështirë të vitet '90, duke i dhënë zë dhe mbështetje Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Ai gjithashtu e theksoi se ky investim është një nxitje për të rinjtë që të punojnë për një të ardhme më të mirë dhe të ndihmojnë në ndërtimin e një shoqërie më të zhvilluar. "Zoti Xhema po investon në ju,

sepse ai beson në ju. Ai beson se dija juaj, puna juaj, dhe pasioni juaj mund ta formësojnë një të ardhme më të mirë për Kosovën dhe përtej saj", theksoi Kryetari Rama. Ai e përfundoi fjalimin duke iu drejtuar studentëve për të kujtuar rëndësinë e këtij momenti, duke i inkurajuar që të shfrytëzojnë mundësinë që iu ofrohet për të kontribuar në zhvillimin e vendit.

Flora Çadraku, një nga studentët që fitoi bursën, u shpreh me mirënjohje dhe pasion: "Për mua, kjo bursë është një motivim i madh, një arsye për të punuar edhe më shumë. Është dëshmi që kur dikush beson tek ti, ti mund të arrish më shumë seç ke menduar".


Ajo theksoi rëndësinë e mundësive që iu ofruan dhe angazhimin e saj për të përfaqësuar me sukses vlerat e Fondacionit "UBT Jim Xhema" dhe UBT-së, duke premtuar se puna dhe përkushtimi i saj do të jenë një pasqyrë e denjë e besimit që u dha. Në fund të ceremonisë, studentët përfitues u shprehën të emocionuar dhe falënderues për mbështetjen që kanë marrë. Fondacioni "UBT Jim Xhema" synon të vazhdojë rrugën e tij për të fuqizuar gjeneratat e reja dhe për të ndërtuar ura bashkëpunimi mes komuniteteve dhe brezave. Kjo iniciativë e UBT-së përforcon edhe një herë rolin e institucionit si një platformë që promovon ekselencën dhe fuqizon brezat e ardhshëm për të kapërcyer çdo kufi drejt suksesit.

Javës së Artit dhe Dizajnit

Java e Artit dhe Dizajnit në UBT është një ngjarje që do të karakterizohet nga ekspozita, punëtori, muzikë, art dhe diskutime për fushën e artit dhe kulturës në përgjithësi.

Ky aktivitet organizohet nga Fakulteti i Artit dhe Dizajnit në UBT, me një varg departamentesh përfshirë Dizajn i Integruar, Art dhe Mediat Digjitale, Aktrim dhe Muz-

ikë Moderne, Prodhim Digjital dhe Menaxhim dhe ka për qëllim kultivimin dhe mbështetjen e krijimit të një rrjeti të gjërë lokal dhe global të krijuesve në fushën e artit.



Doli nga shtypi libri "Tranzicioni i medies në Kosovë" i profesorit të UBT-së, Safet Zejnullahu



Profesori i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Safet Zejnullahu, ka botuar librin e tij të titulluar "Tranzicioni i medies në Kosovë". Ky libër është i dedikuar studentëve të gazetarisë, gazetarëve hulumtues dhe redaktorëve të profesionalizuar. Sipas autorit, ky libër është një finalizim i një procesi të gjatë hulumtues në një fushë që nuk është hulumtuar shumë në Kosovë. Ai thekson se ky është një studim që synon të ofrojë një pasqyrë të hollësishme për funksionimin e medias në Kosovë në periudha të ndryshme historike. "Jam përpjekur të sjell para publikut

të dhëna për funksionimin e medias në Kosovë, duke nisur nga periudha e sistemit totalitar, funksionimi në kushte pushtimi e aparteidi, në kohë lufte, si dhe në rrethanat e ringritjes së sistemit mediatik pas luftës", tha profesori Zejnullahu. Ky libër është ndër të parët që hulumton në detaje zhvillimin dhe tranzicionin e medias në Kosovë. Siç thekson autori, ky tranzicion është unik dhe sui generis për shumë aspekte, duke ofruar një analizë të thelluar mbi sfidat dhe transformimet e mediatike në Kosovë pas periudhës së luftës.



DEPARTMENT FOR PROFESSIONAL PRODUCTS AND SERVICES

WHAT ARE WE OFFERING?

- Trainings
- Certifications
- Professional Education
- Business Consulting

TRAININGS

- IT Trainings
- Soft Skills Trainings
- Language Trainings

QUALITY AUSTRIA

qualityaustria Succeed with Quality SOCIAL ACCOUNTABILITY (CSR)	qualityaustria Succeed with Quality EXCELLENCE (EFQM)
qualityaustria Succeed with Quality HEALTH, SOCIAL SERVICES & HEALTH TOURISM	qualityaustria Succeed with Quality OCCUPATIONAL HEALTH & SAFETY
qualityaustria Succeed with Quality CONSTRUCTION	qualityaustria Succeed with Quality PUBLIC ADMINISTRATION
qualityaustria Succeed with Quality FOOD SAFETY	qualityaustria Succeed with Quality OCCUPATIONAL HEALTH & SAFETY
qualityaustria Succeed with Quality ENVIRONMENT & ENERGY	qualityaustria Succeed with Quality AUTOMOTIVE
qualityaustria Succeed with Quality INTEGRATED MANAGEMENT SYSTEM	qualityaustria Succeed with Quality QUALITY
qualityaustria Succeed with Quality CUSTOMIZED PRODUCTS FOR SPECIAL INDUSTRIES	qualityaustria Succeed with Quality MEDICAL DEVICES

MICROSOFT CERTIFICATIONS

Aviable Certifications

Azure Fundamentals (AZ-900)	Microsoft 365 Fundamentals (MS-900)	Microsoft Azure AI Fundamentals (AI-900)	Microsoft Azure Data Fundamentals (DP-900)	Microsoft Power Platform Fundamentals (PL-900)	Microsoft Dynamics 365 Fundamentals CRM (MB-910)	Microsoft Dynamics 365 Fundamentals ERP (MB-920)	Microsoft Security, Compliance, and Identity Fundamentals (SC-900)
-----------------------------	-------------------------------------	--	--	--	--	--	--

PROFESSIONAL TRAININGS

BAZAT E PROGRAMIMIT NE C#	JAVA PROGRAMMING	PYTHON FUNDAMENTALS	UJHQMË (DASHUR)	AUTODESK INVENTOR	UJHËGJATJE E KRIEVE VIRTUALE DHE PUNA NË DISTANCE	INTELIGJENCIA ARTIFICIALE, MACHINE LEARNING	FULL STACK DEVELOPMENT .NET CORE & REACTJS	INTERNET MARKETING & E-MARKETING
FULL STACK DEVELOPMENT (JAVA SPRING BOOT & ANGULARJS)	AUGMENTED AND VIRTUAL REALITY	MIRROJËJA E TË DHËNAVE NË EUROPE (IGDR)	MENASHIMI I BURIMEVE NJËZËRORE	ARC GIS - ARCMAP	DIGITAL MARKETING	SPSS STATISTICAL PACKAGE FOR SOCIAL SCIENCES	ORACLE DATABASE 11G	ORACLE DATABASE 11G
ZYRTAR PËR SHITJE	MARËHËNE ME PUBLIKUN	BAZAT E SIGURISË SE INFORMACIONIT	METODAT STATISTIKOHE PËR VENDIMARRJE NË BIZNES	KOMUNIKIM I LIDERËVE	MEDIA DIGITALE DHE SOCIALE	ADMINISTRATOR I NGJERTSIVE TË BANIMIT NË BASHKËPËRITJE	FËRRILIMI I RAPORTEVE	MENASHIMI I PROJEKTEVE
SHIKATHËSITË E NEGOCIMIT	E-DEVERISA	SIËLLA ME BASHKËPËRITORE TË VEÇTËRE	MENASHIMI I FINANCAVE PËR JOFINANCIË	SHIKATHËSITË E INTERVISTIMIT	GIS FOR SOCIETY	AUTOCAD CIVIL 3D		

IC3 Certifications

IC3 DIGITAL LITERACY

Digital Literacy is the foundation of employability in today's digital economy.

IC3 is a globally recognized certification that validates an individual's digital skills and knowledge. It is a requirement for many jobs and is a key indicator of digital literacy.

IC3 is recognized by:

- infuIT
- Swift
- Adobe Certified Professional
- Microsoft
- Project Management Institute
- ESB
- AUTODESK

CISCO Trainings and Certifications

Cisco Certified Support Technician NETWORKING EXAM	Cisco Certified Support Technician CYBERSECURITY EXAM
<ul style="list-style-type: none"> Network Support Technician IT Support Technician Help Desk Technician IT Support Specialist 	<ul style="list-style-type: none"> Cybersecurity Technician Junior Cybersecurity Analyst Help Desk Support Security Operations Analyst
<ol style="list-style-type: none"> Cisco Certified Support Technician Networking Cisco Certified Network Associate (CCNA) Certification Cisco Professional Certifications 	<ol style="list-style-type: none"> Cisco Certified Support Technician Cybersecurity Cisco Certified CyberOps Associate Cisco Professional Certifications

CERTIFICATIONS

qualityaustria Succeed with Quality	CompTIA	IPC International Professional Evaluation & Certification	psi	ETS	CERTIPORT
Pearson VUE	CISCO	Azure Microsoft Azure Fundamentals	PeopleCert	EC-COUNCIL ACADEMIA PARTNER	

FOREIGN LANGUAGES

DO YOU SPEAK DEUTCH?	DO YOU SPEAK FRENCH?
DO YOU SPEAK TURKISH?	DO YOU SPEAK SPANISH?
DO YOU SPEAK ITALIAN?	

IPMA

IPMA Level D Certified Project Management

IPMA Level A Certified Projects Director

IPMA Level B Certified Senior Project Manager

IPMA Level C Certified Project Manager

CERTIPORT

Microsoft CERTIFIED EDUCATOR	Microsoft OFFICE SPECIALIST	Microsoft TECHNOLOGY ASSOCIATE
IC3	intuit QuickBooks	AUTODESK Certified User
AUTODESK Certified Professional	ESB Entrepreneurship and Small Business	EU-Council Associate

CompTIA

CompTIA Network+	CompTIA Cloud+
CompTIA Security+	CompTIA PenTest+
CompTIA CySA+	CompTIA Project+
CompTIA Linux+	CompTIA Server+
CompTIA CASP+	CompTIA Cloud Essentials

PROFESSIONAL SCHOOLS

Tani më UBT ofron edhe Shkollën Profesionale e cila është akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për organizimin dhe mbajtjen e mësimi për pesë (13) profile profesionale si mëposhtëm:

1. Gjuha Angleze
2. T1 dhe Komunikim, niveli 3 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (nuk e kemi vazhduar me kërkesën tone)
3. Asistent Administrativ, niveli 3 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
4. Zhvillues i Aplikacioneve, niveli 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
5. Administrator i Sistemit dhe rrjetit Kompjuterik, niveli 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
6. Gjuha Gjermane
7. Instalues Elektrik në banesa civile, niveli 3 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
8. Shitja dhe kujdesi ndaj klientit, niveli 3 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
9. Teknik i laboratorit mjekësor niveli 3 dhe 4 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
10. Teknik i farmaciae niveli 3 dhe 4 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
11. Bashkëpunëtor profesional i infermierisë niveli 3 dhe 4 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
12. Asistent Dentar niveli 3 dhe 4 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
13. Teknologji Informative dhe Elektronike
14. Teknik i Optikës / Opticien

UBT Projects

- Regional Challenge Found
- GIZ Digital Boot Camp
- Employment Agency of Republic of Kosovo
- Austrian Development Agency
- EON Reality USA
- Ministry of Education
- Korca Innovation and Technology HUB
- Kosovo Municipalities, Gjiilan, Viti, Istog and Vushtrri
- UNDP Kosovo
- Infosoft

CENTERS

Center for Statistics, Data Processing and Forecasting
Center for Modelling and Simulation
Center for Software Development and Innovation
Center for Incubation and Start Ups
Center for Arts, Multimedia and Culture
Career Center
Center for Cyber Security and Privacy
Center for Professional Development and Lifelong Learning – Executive Academy
Center for Technology Transfer, IPR and Innovation
Center for Knowledge Management and Library

CENTERS

Center of Enterprise Resources Planning – UBT SAP University Alliance
INSPIRE – Center for Social Innovation – UNICEF
Center for Leadership
Center for Resilience and Sustainable Development
Governance Innovation Center (GIC)
The Student Counselling Centre
Social Innovation Center

UBT Institutes

IEME Institute for Enterprise Management and Engineering
RIED Institute of Research Innovation and Entrepreneurship Development
IDEAA Institute of Development of Education and Academic Affairs
IFL Institute of Foreign Languages and Intercultural Competence
Institute of Politics and International Relations
Institute of Life Sciences and Innovation
Institute of Medicine Sciences and Innovation
Institute of Rule of Law and Justices
Institute of Media and Communication
Institute for Urban Studies and Spatial Planning